# RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

## MBI

## PËRPUTHSHMËRINË E VEPRIMTARISË SË MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE KOMISIONIT SHTETËROR TË RINDËRTIMIT

**TETOR 2021**

**Përmbajtja** **faqe**


**I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** ........ 3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit ........ 3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve ........ 3
3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit ........ 5
**II. HYRJA** ........ 9
1. Objekti i auditimit ........ 9
2. Qëllimi i auditimit ........ 9
3. Identifikimi i çështjes: ........ 10
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: ........ 10
5. Përgjegjësitë e audituesve: ........ 10
6. Kriteret e vlerësimit ........ 11
7. Standardet e auditimit ........ 11
8. Metodat e auditimit ........ 11
9. Dokumentimi i auditimit ........ 12
**III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT** ........ 13
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim ........ 13
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT ........ 15
2.1 Mbi veprimtarinë dhe shkallën e zbatimit të kompetencave të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, të përcaktuara në VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò. ........ 15
2.2 Mbi veprimtarinë e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, referuar VKM-së nr. 878, datë 24.12.2019 ñPër përbërjen, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò. ........ 39
**IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET** ........ 80
**V. ANEKSE** ........ 86

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

KLSH në periudhën nga data 11.05.2021 deri me datë 30.07.2021, kreu auditimin në subjektet Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Komisionin Shtetëror të Rindërtimit për periudhën e aktivitetit nga data 10.01.2020 deri më 30.04.2021, duke u përqendruar kryesisht në shkallën e zbatimit të kompetencave të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, të përcaktuara në VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò i ndryshuar; si dhe në veprimtarinë e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, referuar VKM-së nr. 878, datë 24.12.2019 ñPër përbërjen, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò.
Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e konkluzioneve të auditimit.
Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.
Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë institucionale me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kritereve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si intervistime, raporte dhe informacione, verifikime etj.
Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve publike, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies.
Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej dy drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

## 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

| NR. | PËRMBLEDHJE E GJETJES | REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR | RËNDËSIA | REKOMANDIMI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nuk demonstrohet dokumentacion në lidhje me veprimtarinë e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin mbi ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarisë ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara.<br>Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, kreu II, pika 1, germa ñaò. | 16-20 | E lartë | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të plotësuar me dokumentacion aktivitetet mbi ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarisë ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara. |
| 2 | Ministrit të Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar të jenë përgatitur dhe propozuar | 27-28 | E lartë | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | projekte, të përgjithshme e të veçanta, që të ishin pjesë e programeve të procesit të rindërtimit, si dhe nuk ka të dokumentuar kërkesa për mbështetje të specializuar njerëzore.<br>Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, kreu II, pika 2, germa ñbò. | | | kabinetin e tij për të vepruar në kohë në lidhje me përgatitjen dhe propozimin e projekteve, të përgjithshme e të veçanta, që të jenë pjesë e programeve të procesit të rindërtimit, si dhe kërkesë për mbështetje të specializuar njerëzore. |
| 3 | Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar informacione për mënyrën e përdorimit dhe eficiencën e arritur për çdo donacion apo mbështetje të ofruar nga organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit.<br>Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, kreu II, pika 2, germa ñçò. | 28-29 | E lartë | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të informuar për mënyrën e përdorimit dhe eficiencën e arritur për çdo donacion apo mbështetje të ofruar nga organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit. |
| 4 | Ministrit i Shtetit për Rindërtimin në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Ministrave: - nuk ka të dokumentuar aktivitetin për koordinimin, drejtimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 dhe për pasojë mungon një plan i tillë | 32-34 | E lartë | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të marrë masat e nevojshme për koordinimin, drejtimin dhe ndjekjen e veprimtarisë për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19, duke i paraprirë me krijimin dhe drejtimin e grupeve të punës dhe organizimin e veprimtarive për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar, me evidentimin e burimeve të brendshme, njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore; detajimin e nevojave për përballimin e situatës ekonomike dhe më pas thirrjen për raportim të strukturave të cilat kanë lidhje me situatën ekonomike, si dhe sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive në funksion të realizimit të planit të përballimit të situatës ekonomike. |
| 5 | Nga auditimi, nuk rezulton i dokumentuar hartimi dhe miratimi i Programit të përgjithshëm të rindërtimit nga KSHR, dhe më pas përcjellja e tij për miratim në KM, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 të Kreut III të VKM nr. 878 datë 24.12.2019 dhe germën ñaò të pikës 4, të nenit 14 të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019. | 46-50 | E lartë | KSHR të marrë masat e nevojshme për hartimin, miratimin dhe përcjelljen për miratim në KM të Programit të përgjithshëm të rindërtimit, si dhe dokumentimin e këtij procesi, me qëllim rritje e efektivitetit të përdorimit të fondeve të tërmetit të nëntorit 2019 |
| 6 | Sekretariati i KSHR nuk përcolli informacion mbi kontributet në natyrë, por e drejtoi grupin e auditimit për marrjen e këtij informacioni në AKMC, si institucioni përgjegjës për marrjen në dorëzim të kontributeve në natyrë.<br>Sa më sipër, nuk sigurohet transparencë mbi kontributet në natyre, në kundërshtim me pikën 1, kreu III, të VKM nr. 878, datë 24.12.2019, si dhe është vepruar në kundërshtim edhe me ligjin nr.154/2014 ñPër organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 26, pika 1 dhe 2. | 63-67 | E lartë | KSHR të kërkojë nga AKMC-së, informacion mbi kontributet në natyrë, dhe në rast të marrjes në dorëzim nga kjo e fundit të sende apo materiale ndërtimore, punë apo shërbime në funksion të procesit të rindërtimit, ato të publikohen në faqen e rindërtimit, me qëllim sigurimin e transparencës mbi procesin e rindërtimit, si dhe të përfshijë në raportet e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | monitorimit që përgatit për KM-në edhe informacione mbi kontributet në natyrë, me qëllim raportimin e plotë të vijimësisë së procesit të rindërtimit. |
| 7 | Në dosjet e praktikave të audituara është konstatuar se, në shumicën e rasteve, njësitë e qeverisjes vendore dhe autoritetet përgjegjëse kanë paraqitur pranë KSHR akt-ekspertiza të thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit, në tejkalim të kompetencave të caktuara në VKM nr.26, datë 15.1.2020 ñPër kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuaraò, e cila i jep Institutit të Ndërtimit tagrin për të kryer akt-inspektime dhe akt-vlerësime paraprake, si dhe oponencën teknike mbi akt-ekspertizat e thelluara. | 74-75 | E lartë | Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, të kërkojë nga Sekretariati Teknik që të gjitha praktikat që shoqërojnë vendim-marrjen të jenë të strukturuara dhe të miratuara sipas përgjegjësive institucionale, me qëllim që të sigurohet funksionim normal në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. |

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Nga auditimi i veprimtarisë së Ministrit të Shtetit për Rindërtimin (MSHR), gjatë periudhës nga data 10.01.2020 deri më 30.04.2021, mbi nivelin e ndjekjes dhe zbatimit të detyrave të përcaktuara për këtë strukturë në VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, arrihet në konkluzionin se:

*- Veprimtaria e MSHR-së për ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit ka shfaqur mangësi në drejtim të dokumentimit të saj;*

*- Mungon në mënyrë të dokumentuar evidentimi i burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore, dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre;*

*- Ndjekja e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose kanë mbetur të pastrehë nuk është dokumentuar plotësisht;*

*- Ndjekja e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për strukturat e posaçme, të ngritura me ligj apo vendim, për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti është karakterizuar nga rutina e përditshme, pa e dokumentuar atë plotësisht;*

*- Informacionet mbi mënyrën e përdorimit dhe eficiencën e arritur për çdo donacion apo mbështetje të ofruar nga organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë etj., janë të pa plota;*

*- Ushtrimi i kompetencave të veta në lidhje me raportimin dhe ngarkimin me detyra të strukturave të mbrojtjes civile; krijimin e grupeve të punës dhe organizmin e veprimtarive për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit; bashkërendimin e punës me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit për përballimin e pasojave dhe zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit është kryer në mungesë të dokumentimit të kësaj veprimtarie.*

Nga auditimi i veprimtarisë së Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, gjatë periudhës nga data 10.01.2020 deri më 30.04.2021, mbi nivelin e ndjekjes dhe zbatimit të detyrave të përcaktuara për këtë strukturë në VKM nr. 228, datë 18.3.2020 ñPër një shtesë në Vendimin nr.11, datë 10.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtiminò, lidhur me periudhën COVID-19 arrihet në konkluzionin se:

*- Aktivitetet për koordinimin, drejtimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 janë fragmentare e të pa dokumentuara dhe për pasojë mungon një plan i tillë i mirëfilltë;*
*- Dokumentimi i burimeve të brendshme, njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore ka shfaqur mangësi në evidentim;*
*- Veprimtaria për koordinimin dhe drejtimin e strukturave e të njësive, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave, për zbatimin e planit të përballimit të situatës ekonomike, të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 rezulton e pa dokumentuar plotësisht;*
*- Detajimi e nevojave për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 ka qenë i shpërndarë midis ministrive dhe institucioneve, por i pa dokumentuar nga ana e MSHR;*
*- Veprimtaria për koordinimin dhe drejtimin e punës, si dhe rekomandimin e institucioneve për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim në Këshillin e Ministrave të projekt-akteve, ligjore e nënligjore, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19, rezulton se nuk është kërkuar nga ana e këtyre institucioneve;*
*- Thirrjet për raportim të strukturave të cilat kanë lidhje me situatën ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 kanë shfaqur mangësi evidentimi të dokumentuar;*
*- Krijimi dhe drejtimin e grupeve të punës dhe organizimin e veprimtarive për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19 ka qenë i fragmentuar dhe i pa dokumentuar plotësisht;*
*- Janë shfaqur mangësi dokumentimi i veprimtarisë për bashkërendimin me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive në funksion të realizimit të planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;*
*- Marrëveshjet për furnizimin e vaksinave, nuk kanë qenë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH, duke pamundësuar shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre, dhe në këtë kuadër të aktivitetit të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin në cilësinë e ministrit përgjegjës të fushës.*

Struktura tjetër, me një rol kyç në procesin e rindërtimit, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit (KSHR), e përcaktuar kjo në VKM nr. 878, datë 24.12.2019 ñPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò konkludohet se:
*- Nuk ka hartuar, miratuar dhe përcjellë për miratim Programin e përgjithshëm të rindërtimit, dokument mbi të cilin do të mbështetej procesi i rindërtimit. Mungesa e këtij dokumenti të miratuar nga KSHR dhe KM, përmban riskun e cenimit të efektivitetit, eficiencës, dhe ekonomicitet të procesit të rindërtimit, si rezultat se vendimmarrja nuk është mbështetur mbi një planifikim të mirëfilltë, por është kryer rast pas rasti;*
*- Nga ana tjetër, mungesa e monitorimit të mirëfilltë dhe periodik të procesit të rindërtimit nga KSHR, si dhe mungesa e raporteve (nga KSHR) për KM-në, nuk ofron siguri mbi performancën e procesit të rindërtimit, përmban riskun e mos marrjes në kohë të masave të nevojshme për përmirësim, si dhe nuk siguron transparencë mbi rezultatet e masave të ndërmarra deri më tani për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti i nëntorit 2019;*
*- Sekretariati Teknik i Komisionit Shtetëror të Rindërtimit gjatë veprimtarisë së tij për marrjen e vendimeve, nuk rezulton të ketë dokumentacion vërtetues për kryerjen e njoftimit dhe dërgimit të materialeve, procesverbalet e mbajtura nuk pasqyrojnë votën kundër, vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve të KSHR nuk janë nënshkruar të gjithë anëtarët etj.;*

*- Në dosjet e analizuara nga grupi i auditimit, lidhur me vendimmarrjet e KSHR-së për procesin e rindërtimit rezultoi se në shumicën e rasteve, akt-ekspertiza e thelluara të objekteve të dëmtuara nga tërmeti janë kryera nga Instituti i Ndërtimit, në tejkalim të kompetencave të caktuara në VKM nr.26, datë 15.1.2020, sipas të cilës Instituti i Ndërtimit ka tagrin për të kryer akt-inspektime dhe akt-vlerësime paraprake, si dhe oponencën teknike mbi akt-ekspertizat e thelluara. Gjithashtu rezultoi se, janë pranuar, miratuar me Vendim të KSHR dhe dërguar për miratim tek KM dy projekte, jo në respektim të procedurave të përcaktuara për përfitimin nga grantet e rindërtimit: projekti për rindërtimin e Urës së Tapizës me fondin e propozuar në vlerën 151,539,896 lekë pa TVSH, dhe projekti për rindërtimin e QSHAMT me fondin e propozuar prej 275 milion lekë, pasi kërkesat për realizimin e këtyre projekteve nuk janë mbështetur në akt-ekspertiza apo projekt preventiv punimesh.*

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjekteve të audituara:**
Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.
Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së tyre në përputhje më aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative përkatëse.
Struktura drejtuese e njësive publike duhet të jenë të përgjegjshëm dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se e kryejnë veprimtarinë e tyre në pajtim me kriteret ligjore e normative.
Koncepti i përputhshmërisë (pajtueshmërisë) merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur kërkesa për performancë në sektorin publik është gjithnjë në rritje, dhe marrja e sigurisë referuar përputhshmërisë me ligjet dhe rregullat, konsiderohet si një dimension jetik i përgjegjshmërisë dhe transparencës në qeverisje.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:**
Është përgjegjësi e audituesve të KLSH për të shprehur konkluzionin mbi çështjet e trajtuara në këtë auditim përputhshmërie: dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord.
Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në respektimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodit të etikes me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e konkluzioneve.
Audituesit e KLSH kanë planifikuar dhe kryer auditimin me qëllim që të vlerësohet nëse veprimtaria, aktiviteti, informacioni etj., në të gjitha aspektet janë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore, nënligjore e rregullatore dhe janë kryer në pajtim me kompetencat e personave përgjegjës.
Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH marrin evidenca të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim.
Gjithashtu, audituesit e KLSH kanë përzgjedhur dhe përdorur metoda të përshtatshme për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave që plotësojnë kriteret e përcaktuara për këtë auditim, si dhe janë siguruar se teknikat e përdorura janë të mjaftueshme e të arsyeshme për të evidentuar parregullsitë në veprimtarinë e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Komisionit Shtetëror të rindërtimit. Në zgjedhjen e metodave dhe procedurave, është marrë në konsideratë veçoria e subjekteve që auditohen, si dhe cilësia e evidencave dhe dëshmive.
Audituesit e KLSH janë përgjegjës për cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit deri në këtë fazë, me synim marrjen e

sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se Raporti Përfundimtar i auditimit dhe konkluzionet e auditimit janë të përshtatshme.
Nëpërmjet këtij auditimi përputhshmërie, KLSH luan një rol të rëndësishëm për të garantuar në se parimet e transparencës, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë, aplikohen dhe përmbushen nga ana e institucioneve publike.
Ky auditim përputhshmërie promovon përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

# II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 529/2 prot., datë 25.05.2021, të ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 11.05.2021 deri me datë 30.07.2021, në subjektet Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Komisionin Shtetëror të Rindërtimit për periudhën e aktivitetit nga data 10.01.2020 deri më 30.04.2021, ñMbi përputhshmërinë e veprimtarisë, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Gj.P., përgjegjës grupi
2. M. K., anëtarë
3. D. P., anëtarë
4. K. F., anëtare

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

### 1. Objekti i auditimit

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse aktiviteti i zhvilluar për periudhën objekt auditimi përputhet me kriteret përkatëse të kuadrit ligjor, nënligjor e rregullator të fushës.

Objektivi i Auditimit është arritja e një konkluzioni nëse aktiviteti i zhvilluar për rindërtimin (pas tërmetit të 26 nëntorit 2019) dhe për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 është në përputhje ose jo me dispozitat ligjore, nënligjore dhe rregullatore përkatëse.

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:

1. Nëpërmjet konkluzioneve të arritura, dhënia e një sigurie të arsyeshme nëse veprimtaria e dhe shkalla e zbatimit të kompetencave të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, është në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò dhe VKM nr. 228, datë 18.3.2020 ñPër një shtesë në Vendimin nr.11, datë 10.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtiminò;

2. Vlerësim mbi shkallën e zbatimit të përgjegjësisë dhe funksioneve nga të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, referuar VKM-së nr. 878, datë 24.12.2019 ñPër përbërjen, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò.

3. Arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Komisionin Shtetëror të Rindërtimit.

### 2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;

- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;
- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

**3. Identifikimi i çështjes:**
Raporti Përfundimtar i Auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për periudhën e aktivitetit nga data 10.01.2020 deri më 30.04.2021 ka identifikuar sipas kritereve të specifike të auditimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e dy fushave në vijim:
- Mbi veprimtarinë dhe shkallën e zbatimit të kompetencave të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, të përcaktuara në VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò i ndryshuar;
- Mbi veprimtarinë e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, referuar VKM-së nr. 878, datë 24.12.2019 ñPër përbërjen, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò.

**4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**
Struktura e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin kanë për detyrë që të përgjigjet për garantimin e funksionimin normal të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Po ashtu, edhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kryen funksionin e sekretariatit teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, në cilësinë e autoritetit shtetëror përgjegjës për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.
Strukturat e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe sekretariati teknik janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për Ministrin e Shtetit për Rindërtimin dhe të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.
Gjithashtu, këto struktura janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elekëtronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

**5. Përgjegjësitë e audituesve:**
Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i zhvilluar dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, i cili shprehet nëpërmjet konkluzioneve të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për arritjen e konkluzioneve.
Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i zhvilluar përputhet, në të gjitha aspektet, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, udhëzime, sqarime, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të veprohet etj.;
- Njëherësh dhe aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, vendimet, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik); si dhe

- Promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese, si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre devijuese të evidentuara.

**6. Kriteret e vlerësimit**

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;
- VKM nr.878, datë 24.12.2019 ñPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit; VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtiminò; VKM nr. nr.228, datë 18.3.2020 ñPër një shtesë në Vendimin nr.11, datë 10.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtiminò.
- Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019, ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò
- Akte të tjera ligjore, nënligjore apo rregullatore që kanë rezultuar të nevojshëm gjatë auditimit.

**7. Standardet e auditimit**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit.

Raporti Përfundimtar i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, si dhe mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 ï 165);
- Ligjin nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400- Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisëò;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- ISSAI 1530 (ISA 530)- Objektivi i audituesit është të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI ñPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisëò;
- si dhe në praktikat më të mira të fushës.

**8. Metodat e auditimit**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, pasi Ministri i Shtetit për Rindërtimin funksionon me kabinet, një staf i ngushtë dhe i vogël këshilltarësh; veprimtaria e të cilit rregullohet sipas përcaktimeve të VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, i ndryshuar, si dhe Komisionit Shtetëror të Rindërtimit i ngarkuar për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të

tjera, në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:
a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:
b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit;
c. *Verifikimi në sistemin elekëtronik* - me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
d. *Të kombinuara,* sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.
Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

**9. Dokumentimi i auditimit**

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe sekretariatit teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to.
Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet dhe më pas shqyrtimin e observacioneve të subjektit dhe të Projektraportit të auditimit, cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar auditimi.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT
### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

*A. Ministri i Shtetit për Rindërtimin* është emëruar z. AA më datë 13 dhjetor 2019 dhe pas rreth një muaj janë përcaktuar fushat e përgjegjësisë (10 janar 2020). Ministri i Shtetit ka në stafin e tij vetëm kabinetin, staf me këshilltarë.
Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019, ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, ka rregulluar funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse[1]. Në autoritetet përgjegjëse për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore është përcaktuar edhe *Ministri përgjegjës në fushën e përgjegjësisë të të cilit, përfshihet përballimi i pasojave nga fatkeqësia natyrore dhe fatkeqësi të tjera.*
Mbi këtë bazë, me VKM nr.11, datë 10.01.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, është përcaktuar fusha e përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, si dhe kompetencat për realizimin e tyre. Sipas kreut të II të këtij Vendimi, *Ministri i Shtetit për Rindërtimin është përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.*
Gjithashtu i janë përcaktuar dhe përgjegjësi të tjera, lidhur me planifikimin dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit; evidentimin e burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore; drejtimin operacional të strukturave dhe të njësive të veçanta, shtetërore dhe publike; ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për ministritë dhe institucionet e tjera, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose që kanë mbetur të pastrehë, si pasojë e tërmetit etj.
Si përfaqësues i Këshillit të Ministrave, kontakton dhe bashkërendon me organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit.
Ministri i Shtetit për Rindërtimin, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, ka një sërë kompetencash si: pjesëmarrjen në mbledhjet e Komitetit të Emergjencave Civile; krijimin e grupeve të punës dhe organizimin e veprimtarisë për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit; drejtimin dhe koordinimin, në nivel qendror, të strukturave operacionale për përballimin e pasojave dhe zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit etj.
Sipas ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, ñPër organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministraveò, neni 3 dhe 4 *Ministri i Shtetit dhe kabineti i tij, janë në strukturë dhe përbërje të Kryeministrisë*, e cila është person juridik, publik, që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe të Ministrit të Shtetit.
Me VKM nr.228, datë 18.3.2020 ñPër një shtesë në Vendimin nr.11, datë 10.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtiminò, Ministri i Shtetit për Rindërtimin është përgjegjës për koordinimin dhe drejtimin e punës, ndërmjet ministrive dhe institucioneve, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19.

[1] Akti normativ nr.9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, neni 1

Nëpërmjet këtij vendimi, i janë ngarkuar përgjegjësi koordinimin, drejtimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19; evidentimin e burimeve financiare të jashtme dhe përcaktimin e mënyrës së përthithjes së tyre, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 dhe propozimin për miratim në Këshillin e Ministrave të akteve përkatëse, për përdorimin e këtyre burimeve; detajimin e nevojave për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 etj.

B. Sipas aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, neni 12, në autoritetet përgjegjëse për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, bën pjesë dhe *Komisioni Shtetëror i Rindërtimit*, i cili krijohet nga Këshilli i Ministrave.
Komisioni Shtetëror i Rindërtimit është organi përgjegjës për propozimin e programit të përgjithshëm të rindërtimit dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve materiale e financiare për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja.[2]
Komisioni Shtetëror i Rindërtimit ka një sërë kompetencash në lidhje me hartimin dhe propozimin në Këshillin e Ministrave të programit të përgjithshëm të rindërtimit; bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, përfshirë dhe donatorët, në përputhje me programin e përgjithshëm të rindërtimit, si dhe me procesin e rindërtimit; sigurimin e informimit të publikut dhe transparencën mbi procesin e rindërtimit etj.
Me VKM nr.878, datë 24.12.2019 ñPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò janë përcaktuar përbërja dhe funksioni, veprimtaria dhe Sekretariati Teknik i Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.
Funksionin e Sekretariatit Teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit e kryen Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC).
Në këtë cilësi, AKMC, krahas detyrave të përcaktuara në aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, i janë ngarkuar dhe përgjegjësi në lidhje me: administrimin e të gjithë dokumentacionit që është objekt shqyrtimi dhe vendimmarrjeje në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit; njoftimi dhe organizimi i mbledhjeve të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit; përgjegjësia për të organizuar, drejtuar dhe bashkërenduar procesin me autoritetet e tjera përgjegjëse, në nivel qendror dhe/ose vendor, me qëllim përgatitjen për shqyrtim dhe miratim të akteve në kompetencë të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit; si dhe përgatitja e projektakteve që miratohen nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, pas shqyrtimit të propozimeve të përcjella nga njësitë zbatuese, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e tjera qendrore apo iniciativave të drejtpërdrejta të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit

[2] [2] Akti normativ nr.9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, neni 14/2

## 2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

### 2.1 Mbi veprimtarinë dhe shkallën e zbatimit të kompetencave të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, të përcaktuara në VKM nr. 11, datë 10.1.2020 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin".

Në zbatim të pikës 1 të Programit të auditimit nr. 529/2 prot., i ndryshuar, datë 25.05.2021 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- PDNA (dokumenti zyrtar i evidentimit dhe vlerësimi i dëmeve e hartuar nga strukturat e specializuara të ekspertëve të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Kombeve të Bashkuara me koordinimin dhe bashkëpunimin e qeverise shqiptare);
- Tabelat për shpërndarjen e fondeve të Rindërtimit 2020;
- VKM nr.11, datë 10.01.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò;
- Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò.
- Prezantime të MSHR me donatorët;
- Marrëveshjet me donatorët;
- Prezantime të MSHR për procesin e Rindërtimit;
- Relacionet për aktet normative për ñMiratimin e tekstit të marrëveshjeve, për vaksinat, periudha e COVID-19ò, si dhe ligjet përkatëse;
- Dokumente dhe informacione të vëna në dispozicion në rrugë elekëtronike nga stafi i Ministrit të Shtetit për Rindërtimin.

**I. Për çështjen e rindërtimit, për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019**

Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019, ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, ka rregulluar funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse[3].

Në autoritetet përgjegjëse për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore është përcaktuar edhe *Ministri përgjegjës në fushën e përgjegjësisë të të cilit, përfshihet përballimi i pasojave nga fatkeqësia natyrore dhe fatkeqësi të tjera*.

Mbi këtë bazë, me VKM nr.11, datë 10.01.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, është përcaktuar fusha e përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, si dhe kompetencat për realizimin e tyre. Sipas kreut të II të këtij Vendimi, ***Ministri i Shtetit për Rindërtimin është përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.***

Referuar nenit 3 dhe 4 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, ñPër organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministraveò, *Ministri i Shtetit dhe kabineti i tij, janë në strukturë dhe përbërje të*

[3] Akti normativ nr.9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, neni 1

*Kryeministrisë*, e cila është person juridik, publik, që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe të Ministrit të Shtetit.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion për secilën çështje të përcaktuar në VKM nr.11, datë 10.01.2020, si dhe ka diskutuar në vijimësi me kabinetin (stafin e këshilltarëve) e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, duke arritur në konstatimet e mëposhtme:

➢ Në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Ministrave, Ministri i Shtetit për Rindërtimin ***ndjek dhe bashkërendon veprimtarinë e ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara*** (kreu i II, pika 1, germa ñaò e VKM nr.11, datë 10.01.2020).

| **1. Titulli i gjetjes:** | Nuk demonstrohet dokumentacion në lidhje me veprimtarinë e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin mbi ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarisë ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara. |
|---|---|
| **Situata** | Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i audituar, konstatohet se më 26 Nëntor 2019 një tërmet me magnitudë 6.3 Richter në thellësi 38 km, ka goditur vendin tonë, epiqendra e të cilit ishte 22 km nga Durrësi dhe 30 km nga Tirana.<br>Sipas të dhënave, nga ky tërmet janë prekur 202,291 persona: 47,263 në mënyrë direkte dhe 155,028 në mënyrë indirekte; 51 raste humbje jete; si dhe është konsideruar zhvendosja e 17,000 personave.<br>Sipas VKM nr. 750, datë 27.12.2019 ñPër shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranëò, i ndryshuar, kanë qenë 11 Bashki në Gjendje të Fatkeqësisë Natyrore. Ndër njësitë vendore më të prekura kanë rezultuar dy bashkitë më të populluara, urbanizuara dhe zhvilluara Tirana dhe Durrësi, si dhe bashkitë Shijak, Krujë, Kamëz, Kavajë, Kurbin dhe Lezhë.<br>Për përballimin e situatës ka pasur një reagimi i menjëhershëm nga ana e qeverisë me zjarrfikës, mbrojtjen civile, urgjencën mjekësore, Forcat e Armatosura dhe Rezervat e Shtetit, me pjesëmarrjen e rreth 7600 persona. Në vijim ka pasur një angazhim të ndërkombëtareve: 541 personel të mbrojtjes civile nga 12 shtete të BE dhe 304 personel të mbrojtjes civile nga 8 shtete të tjera.<br>Me angazhimin e strukturave të specializuara të ekspertëve të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Kombeve të Bashkuara, me koordinimin dhe bashkëpunimin e qeverisë shqiptare është hartuar **Raporti i vlerësimit të dëmit pas fatkeqësisë**, (**Albania Post-Disaster Needs Assessment-PDNA)** i publikuar në shkurt 2020, është në vetvete dokumenti zyrtar i evidentimit dhe vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. PDN është hartuar në zbatim të pikës 4 dhe 5, të nenit 14 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñ*Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore",* dhe përbën ***kornizën bazë të Programit të Rindërtimit.***<br>Gjithashtu, ky Raport vlerësimi, i prezantuar më 12 Shkurt 2020, ka shërbyer si bazë nga autoritetet përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e VKM për planet e masave financiare për përballimin e pasojat e tërmetit të 26 Nëntorit 2019, pra sipas informacionit të sjellë stafi i këshilltarëve e konsideron si Programi i Rindërtimit.<br><br>*Skema nr.1* Strukturat e menaxhimi të situatës pas fatkeqësisë |




*Burimi:* Ministri i Shtetit për Rindërtimin

Një përmbledhje e gjetjeve kryesore të PDNA, sipas sektorëve është si më poshtë vijon:

a) **Arsimi**: Dëmet u raportuan në 321 institucione arsimore në 11 komunat e prekura, që përfaqësojnë 24% të të gjitha institucioneve arsimore. Bashkitë e Tiranës dhe Durrësit kanë pjesën më të lartë të dëmit, përkatësisht me 55% dhe 21%. Vlera totale e dëmeve dhe humbjeve në sektorin e arsimit vlerësohet në 72.35 milion EUR (8.9 miliardë lekë). Nga kjo, vlera e dëmit është 63.59 milion EUR (7.8 miliardë lekë), ndërsa humbjet janë 8.76 milion EUR (1.1 miliard lekë). Nevojat totale për rindërtim dhe rikuperim vlerësohen të jenë 94.83 milion EUR (11.67 miliardë lekë).

b) **Shëndetësia**: 36 institucione shëndetësore (8% e totalit në 11 komuna) pjesërisht ose plotësisht të dëmtuara, ku 22 janë institucione të kujdesit shëndetësor parësor. Kishte dëme në tre spitale rajonale, nëntë njësi (godina) në spitalin universitar, dy spitale komunale, dhjetë qendra shëndetësore dhe 12 poste shëndetësore. Efektet totale vlerësohen në 9.93 milion EUR (1.22 miliardë lekë). Humbjet e raportuara arrijnë në 1.91 milion EUR (235.03 milion Lekë) dhe lidhen kryesisht me shërbimet mjekësore falas gjatë periudhës së urgjencës. Rimëkëmbja që konsideron rehabilitimin e objekteve pjesërisht ose të dëmtuara rëndë, si dhe masat e zvogëlimit të rrezikut dhe rezistencës vlerësohet në 14.54 milion EUR.

c) **Strehimi**: Një total prej 11,490 njësish banimi u kategorizuan si të shkatërruara plotësisht ose të shkatërruara dhe duhet të rindërtohen. Një shtesë prej 83,745 e njësive të banimit u dëmtuan pjesërisht ose lehtë, që kishin nevojë për riparim. Në përgjithësi janë prekur 18% e njësive totale të banimit. Efektet totale vlerësohen në 696.3 milion EUR (85.68 miliardë lekë), ndërsa rikuperimi dhe rindërtimi vlerësohen në 803 milion EUR (99.301 milion lekë) për një periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

d) **Infrastruktura**: Nga dëmi dhe humbja totale në këtë sektor, e cila arrin në 33.42 milion EUR (4.11 miliardë lekë), një e treta ishte në bashkinë e Durrësit. Ndërtesat qeveritare dhe infrastruktura e komunitetit u prekën veçanërisht. Ka patur dëme të shkaktuara në dy argjinaturat e lumenjve, 50 shporta gabion, një digë, 42 ndërtesa komunale, një burg dhe 33 ndërtesa zyrash. Humbjet totale të të gjithë nënsektorëve arrijnë në 3.01 milion EUR (370.4 milion Lekë). Nevojat e përgjithshme për rindërtim dhe rikuperim u vlerësuan në 60.99 milion EUR (7.5

miliardë lekë).

e) **Prodhimi**: Efektet totale të vlerësuara për sektorin janë 150.48 milion EUR. Nën-sektori i Turizmit pësoi më shumë dëm dhe humbje me 90.24 milion EUR (11.1 miliardë lekë), shumica e të cilave është për shkak të humbjeve nga një rënie e pritshme e vizitorëve të huaj midis 2020 dhe 2022. Nën-sektori i Biznesit dhe Punësimit është e dyta më e prekur me 53 milion EUR (6.5 miliardë lekë) dëm dhe humbje, shumica e saj për shkak të dëmit të pësuar nga 714 biznese në prodhim dhe tregti. Në nënsektorin e Trashëgimisë Kulturore, dy muze kombëtar dhe tre muze lokalë u klasifikuan si të pasigurt dhe janë ende të mbyllura për publikun, ndërsa 23 monumente dhe vende shtesë u klasifikuan si me rrezik të lartë dhe 30 monumente të tjera si me rrezik të mesëm. Dëmet në nën-sektorin e Bujqësisë ishin të vogla dhe kishin të bënin me inputet dhe pajisjet bujqësore. Ka pasur gjithashtu dëmtime në argjinaturat dhe stacionet e kullimit të ujit në Durrës dhe Lezhë, si dhe në Institutin për Sigurinë e Ushqimit dhe ndërtesën e Veterinarisë. Nevojat për rikuperim në këtë sektor arrijnë në 51.83 milion EUR (6.4 miliardë lekë), mbi gjysma është në nën-sektorin e Biznesit dhe Punësimit me 27.84 milion EUR (3.4 miliardë lekë), ndjekur nga turizmi me 10.88 milion EUR (1.3 miliardë lekë) .

f) **Dëmet e Mbrojtjes Sociale** nuk raportohen në këtë sektor, pasi përfshihet ose në infrastrukturën e komunitetit ose ndërtesat publike në sektorin e Infrastrukturës. Humbjet kryesisht i referohen qeverisjes, koordinimit dhe menaxhimit të fatkeqësive, si dhe referimeve, këshillimeve psiko-sociale dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror që vlerësohen në 623.5 mijë EUR (76.7 milion lekë), ku 1/3 janë publike dhe 2/3 janë private. Nevojat totale të sektorit vlerësohen në 2.83 milion EUR (348.2 milion lekë).

g) **Mbrojtja Civile dhe Reduktimi i Rrezikut të Fatkeqësive**: 57 ndërtesa nga Ministria e Mbrojtjes janë dëmtuar, një stacion i zjarrfikësve është prishur, dy ndërtesa të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar janë dëmtuar pjesërisht, tetë stacione monitorimi nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) janë dëmtuar lehtë, gjashtë ndërtesa nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit janë dëmtuar gjithashtu lehtë, dhe shtatë ndërtesa shtesë janë dëmtuar pa u riparuar. Dëmet janë vlerësuar në 8.75 milion EUR (1,076 milion lekë) dhe 13.21 milion EUR (1,625 milion Lekë) për humbjet. Nevojat totale për rindërtimin dhe rimëkëmbjen e sektorit janë vlerësuar në 48.25 milion EUR (5.9 miliardë lekë).

***Dëmi dhe humbja:*** Me e-mailin e datës, 21.07.2021, drejtuar Sekretariatit të KSHR, grupi i auditimit kërkoi informacion mbi çfarë përfaqësojnë përkatësisht dëmi dhe humbjet, të përllogaritura në PDNA, si dhe, a ka një përkufizim për këto terma, apo metodologji të përdorur për përllogaritjen e tyre. Me e-mailin e datë 28.07.2021, Sekretariati KSHR përcolli këtë përgjigje, ñ*Sjellim në vëmendje se nuk ka një definicion apo përkufizim eksplicit të parashikuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, në lidhje me termin "dëmi i llogaritur" dhe "humbjet e llogaritura", por për analogji juridike sqarojmë se në ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", i cili është një akt i përafruar edhe me direktivat e BE, për këtë fushë, në pikën 13 të nenin 3 është dhënë definicioni i përkufizimit "Impakti e fatkeqësisë" i cili është efekti total, duke përfshirë efektet negative (p.sh. humbjet ekonomike) dhe efektet pozitive (p.sh. fitimet ekonomike), të një ngjarjeje të rrezikshme ose të një fatkeqësie. Termi përfshin impaktet ekonomike, njerëzore e mjedisore dhe mund të përfshijë vdekje, plagosje, sëmundje e efekte të tjera negative për shëndetin fizik, mendor dhe mirëqenien sociale të njeriut".*

Sipas stafit të këshilltarëve të Ministrit të Shtetit, si pjesë e programit të rindërtimit janë hartuar dhe miratuar deri tani mbi 236 VKM.

*Skema nr.2* Mekanizmi financiar i zbatimit të Programit të Rindërtimit




*Burimi:* Ministri i Shtetit për Rindërtimin

Nga të dhënat e vëna në dispozicion më sipër, konstatohet se kemi të bëjmë më shumë me një aktivitet të nisur para vendosjes së Ministrit të Shtetit (tërmeti është më datë 26.11.2019, Ministri Shtetit për Rindërtimin vendosur më datë 10.01.2020, prezantimi i PDN është më 12.02.2020), **si dhe që nuk ka të bëjë me ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarisë ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara.** Theksojmë se në referencë të Aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, Kreu IV, Neni 18, pika 1, ku përcaktohet se: ñ*Procesi i Rindërtimit është një proces i integruar zhvillimi i përbërë nga disa programe, në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të shëndetit pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, që përcaktohen në këtë nen*ò. Gjithashtu në vijim janë përcaktuar programet: Programi i zhvillimit të objekteve të reja; Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike; Programi i krijimit të fondit të banesave; Programi i granteve të rindërtimit; Programi i masave të rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike, ku secili prej tyre ka disa nënprograme. Pra përcaktimi i programeve dhe i strukturës tyre është realizuar që me datë 16.12.2019 dhe nga ana e stafit nuk janë vënë në dispozicion programe të mirëfillta me nënprogramet e tyre, siç janë përcaktuar në nenin 18 të Aktit normativ nr.9, ***për pasojë nuk demonstrohet dokumentacion në lidhje me veprimtarinë e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin mbi ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarisë ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara.*** Bashkërendimi e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit nuk ka të bëjë me nxjerrjen e vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe as me Raportin e vlerësimit të dëmit pas fatkeqësisë natyrore.

| | |
|---|---|
| **Kriteri:** | - Aktit normativ nr.9 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, Kreu IV, Neni 18, pika 1; |

| | |
|---|---|
| | - VKM nr.11, datë 10.01.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò kreu i II, pika 1, germa ñaò. |
| **Ndikimi:** | Mungesa hartimit dhe miratimit të programeve të procesit të rindërtimit, zgjat periudhën e rehabilitimit, nuk evidenton përgjegjësinë, ul transparencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve për këtë qëllim etj. |
| **Shkaku** | Mungesa e një konceptimi të qartë të çështjes së programeve të procesit të rindërtimit, mungesa e përvojës në menaxhimin e situtatave të tilla, si dhe situata komplekëse në kushtet e emergjencës civile kombëtare. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **1.1 Rekomandimi:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të plotësuar me dokumentacion aktivitetet mbi ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarisë ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara. |

➢ Lidhur me germën b të pikës 1, kreu II, **për planifikimin dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit**:
Në zbatim të aktit normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 ñ*Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore",* Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në rolin e Autoriteteve Përgjegjëse krijojnë, administrojnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave për individët dhe familjet që kanë humbur familjarë dhe/ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe plotësimin e nevojave të tyre nga programet e procesit të rindërtimit. Në kuadër të realizimit të procesit të Rindërtimit, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, sipas problematikave dhe/ose nevojave të evidentuara, kanë dërguar pranë Ministrit të Shtetit për Rindërtimin ose Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, kërkesat e tyre. Në bazë të këtyre kërkesave është bërë planifikimi i shpërndarjes së Fondeve të Rindërtimit, për programet përkatëse duke vijuar me vendimmarrje të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe më tej me Vendimmarrje në Këshillin e Ministrave.
Në vijim zbatimi i programeve dhe nën programeve të rindërtimit është bërë nga Njësitë Zbatuese të caktuara nga Këshilli i Ministrave, sipas parashikimeve të Aktit Normativ Nr 9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave nga fatkeqësitë natyroreò.

*Tabela nr.1* Fondet e buxhetit 2020 sipas programeve

| Programi | Buxheti i shtetit | Donacione nëpërmjet BSH | Total |
|---|---|---|---|
| Programi i zhvillimit të objekteve të reja | 14,148,335,190.32 | 543,670,932.68 | 14,692,006,123.00 |
| Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike | 2,015,001,438.00 | | 2,015,001,438.00 |
| Programi i granteve të rindërtimit | 9,221,905,854.38 | 1,722,766,934.00 | 10,944,672,788.38 |
| Programi i krijimit të fondit të ndërtesave | 46,872,008.00 | | 46,872,008.00 |
| Ngritja e portalit | 19,440,360.00 | | 19,440,360.00 |
| Vlerësim dëmi | 360,000,000.00 | | 360,000,000.00 |
| Gjithsej | 25,811,554,850.70 | 2,266,437,866.68 | 28,077,992,717.38 |

*Burimi:* Ministri i Shtetit për Rindërtimin

*Tabela nr.2* Fondet e buxhetit deri në prill 2021 sipas programeve

| Emërtimi i Programit | Buxheti i shtetit |
|---|---|
| Programi i granteve të rindërtimit | 6,914,246,265.38 |
| Programi i Infrastrukturës Publike | 1,831,932,076 |
| Programi i zhvillimit të objekteve të reja | 8,459,719,478.90 |
| Gjithsej | 17,205,897,820.28 |

*Burimi:* Ministri i Shtetit për Rindërtimin

- Për germën ñcò, të pikës 1 të kreut II të VKM-së **për evidentimin e burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore, dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit**.

| **2. Titulli i gjetjes:** | Stafi i Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, aktivitetin për evidentimin e burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore, dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit, e ka reduktuar thjeshtë dhe vetëm në informacione mbi ecurinë e procesit dhe atë kryesisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat nuk kanë rezultuar në evidenca të burimeve që disponojnë institucionet dhe për pasojë as në përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre. |
|---|---|
| **Situata** | Aktit Normativ Nr. 9 , datë 16.12.2019, ka parashikuar një rol proaktiv të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në lidhje me bashkërendimin, bashkëveprimet me të gjitha autoritetet përgjegjëse për evidentimin e burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, që ato disponojnë, në kuadër të menaxhimit dhe përballimit të pasojave nga fatkeqësitë natyrore. Ministri i Shtetit për rindërtim, ka koordinuar dhe bashkërenduar jo vetëm me NJVV por edhe me te gjitha autoritetet përgjegjëse me qëllim marrjen e masave për përballimin e pasojave nga fatkeqësia natyrore.<br>Referuar aktit normativ nr.9, neni 17, pika 1 dhe 2 e këtij neni për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në zbatim të kompetencave të tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile dhe për planifikimin dhe zhvillimin e territorit: a) administrojnë fondet që transferohen nga Këshilli i Ministrave prej fondit të rindërtimit, përfshi dhe kontributet në natyrë, kur caktohen si njësi zbatuese me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas rregullave e procedurave të parashikuara në këtë akt normativ; b) miratojnë plane të detyruara vendore, planet e detajuara vendore dhe leje të zhvillimit e të ndërtimit, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë akt normativ; c) krijon, administron dhe përditëson bazën e të dhënave për individët dhe familjet që kanë humbur familjarë dhe/ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe plotësimin e nevojave të tyre nga programet e procesit të rindërtimit. 2. Me qëllim mirë menaxhimin e procesit të rindërtimit në nivel lokal, mund të krijohen zyra të posaçme për rindërtimin. Njësia e vetëqeverisjes vendore merr masat përkatëse për të siguruar funksionimin e plotë të zyrës së posaçme, nëpërmjet caktimit të personelit të përshtatshëm për përmbushjen e funksioneve të saj.<br>Nga grupi i auditimit të KLSH-së, u konstatua që koordinimi është bërë më anë të email-eve, në mënyrë të drejtpërdrejtë me bashkitë: Tiranë, Lezhë, Shijak, Vorë, Rrogozhinë, Mirditë, Krujë, Kamëz dhe Durrës. Komunikimi i |

| | |
|---|---|
| | MSHR-së me NJVV kryer me disa nga email-et (komunikimit), vënë në dispozicion janë:<br>**1-** Email-i i datës 25.03.2020, nga Bashkia Tiranë lidhur me informacion rreth ecurisë së procesit të rindërtimit, raportimi në lidhje me fazën e vlerësimit të aplikimeve dhe lista paraprake e përfituesve, raportimin në lidhje me realizimin e detyrave të lëna, problematikat dhe detyrat që kryhen deri në fund të afatit të caktuar. Bashkëlidhur informacion nga Komiteti i Rindërtimit, datë 24.03.2020, lidhur me ecurinë e procesit të rindërtimit, ku në shqyrtim janë 300 dosje DS1-2-3 dhe 240 dosje DS4-5 si dhe procedimi me aplikimet online për shtëpitë e fshatit, të miratuara 30 shtëpi dhe 30 të tjera në proces. Gjithashtu bashkëlidhur Memo drejtuar Ministrit Shtetit për Rindërtim, nga Këshilltarja e tij lidhur me ecurinë e procesit të rindërtimit, raportimin nga NJVV ñPër përballimin e e Pasojave Natyroreò. *U konstatua që Memo drejtuar MSHR është e pa protokolluar*. Bazuar në nenin 13 të ñ*Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", thekson se Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës "në përgjigje" ose "në vijim të shkresës". Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. <u>Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.</u>*<br>**2**-Email-i i datës 28.03.2020, drejtuar Bashkive të prekura nga tërmeti, lidhur me dhënien e informacionit rreth ecurisë së gjithë procesit të rindërtimit raportimi në lidhje me fazën e vlerësimit të aplikimeve dhe lista paraprake e përfituesve, raportimin në lidhje me realizimin e detyrave të lëna, problematikat dhe detyrat që kryhen deri ne fund të afatit të caktuar.<br>**3**-Email-i i datës 02.04.2020 drejtuar Bashkive të prekura nga tërmeti, lidhur me dhënien e informacionit dhe raportimin ditor rreth ecurisë së gjithë procesit të rindërtimit.<br>**4-** Email-i i datës 23.01.2020 drejtuar Bashkisë Kavajë, për propozime për Zonat e Reja për Zhvillim.<br>**5**-Email-i i datës 13.01.2021 drejtuar FSHZH-së, dhe Bashkisë Tiranë lidhur me formatin standard për update periodik për vijimësinë e dhe progresin e rindërtimit.<br>**6**-Email-i i datës 05.02.2020, drejtuar sekretarit të MSHR-së, për takimin me Kryetarët e Bashkive të zonave të prekura, lidhur me: Ecurinë e aplikimeve në portalin ñShtëpia imeò, si dhe raportimin e informacionit nga zyrat e posaçme në lidhje me procesin; Marrja e masave për përgatitjen e siteve të cilat janë shpallur si zona të reja për zhvillim të detyruar; Marrja e masave për përgatitjen e një pjese të dokumentacionit në lidhje me procesin e shpronësimit, me qëllim përshpejtimin e procesit si dhe Bashkëveprimin me njësitë zbatuese, Entin Kombëtar të Banesave ASHK, si dhe çdo organ tjetër në kuadër të procesit të Rindërtimit. |
| **Kriteri:** | - Aktit Normativ Nr 9 , datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò neni 17, pika 1 dhe 2;<br>- VKM nr.11, datë 10.01.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, germa ñcò, e pikës 1 të |

| | |
|---|---|
| | kreut II |
| **Ndikimi:** | Mungesë eficiencës së veprimtarisë së Ministrit të Shtetit për Rindërtimin |
| **Shkaku** | Mungesa e përvojës në trajtimin e situatave të fatkeqësisë natyrore, si dhe situata komplekëse në kushtet e emergjencës civile kombëtare. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **2.1 Rekomandimi:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të plotësuar evidentimin e burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore, dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit. |

➢ Lidhur me germën ñdò dhe ñdhò të VKM-së së sipërpërmendur: **d) ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për ministritë dhe institucionet e tjera, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose që kanë mbetur të pastrehë, si pasojë e tërmetit;**
**dh) ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe të strukturave në varësi të tyre, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose kanë mbetur të pastrehë, si pasojë e tërmetit**:

| | |
|---|---|
| **3. Titulli i gjetjes:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për ministritë dhe institucionet e tjera, si dhe pjesërisht për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose që kanë mbetur të pastrehë, si pasojë e tërmetit. |
| **Situata** | Në zbatim të vendimit të Komisionit Ndërministror të Emergjencave Civile (KNEC) Nr. 8, datë 18.12.2019ñ *Për miratimin e listës së apartamenteve që do t'iu dhurohen familjarëve të viktimave si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019",* Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në rolin e autoriteteve përgjegjëse i janë drejtuar Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, për alokimin e fondit për blerjen e apartamenteve, të cilët do tõu dhurohen familjarëve të viktimave si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019. Sipas kërkesave të bashkive Kamëz dhe Durrës ka pasur dy vendimmarrje të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, nga ku është bërë propozimi për dhurimin e apartamenteve, në Këshillin e Ministrave (bashkëlidhur VKM). I gjithë procesi është koordinuar dhe monitoruar ne mënyrë periodike nga Ministri i Shtetit për Rindërtimin, duke monitoruar zbatimin e detyrave që Akti Normativ Nr. 9 i ka ngarkuar Autoriteteve përgjegjëse, duke filluar që nga trajtimi i shtetasve që kanë mbetur të pastrehë si pasojë e tërmetit të cilët janë akomoduar në: 1-struktura akomoduese hoteliere; 2-akomodim në çadra; për të vazhduar më pas me trajtimin sipas Aktit Normativ Nr. 9 , datë 16.12.2019 me bonuse qiraje.<br>Familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, të mbetura të pastreha pasi banesat ose shtëpitë e banimit individuale të tyre janë klasifikuar si objekt i dëmtuar ose i pabanueshëm, kanë përfituar pagesën e qirasë, në vlerën mesatare të tregut të lirë, pagesë që miratohet me vendim të organeve të njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Për përfitimin e pagesës së qirasë, subjektet përfituese kanë aplikuar pranë njësisë së Vetëqeverisjes Vendore ku kanë vendbanimin. Për të vijuar më pas me marrjen e granteve të rindërtimit, si përfitues i këtij programi. Ndjekja e këtij procesi është bërë nëpërmjet raportimeve periodike elekëtronike që kanë bërë bashkitë dhe Autoritetet Përgjegjëse, për të gjithë këtë proces. |

| | |
|---|---|
| | Bazuar në nenin 17, pika 3 dhe 4 e këtij neni për óNjësitë e Vetëqeverisjes Vendoreö 3. Zyra e posaçme funksionon si njësi ndihmëse dhe menaxhimi operacional për njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe kryen detyra te mëposhtme: a) Lehtëson përgatitjen dhe ndjekjen e procedurave për planifikimin e detyruar vendor, dhënien e lejeve të nevojshme për ndërtimin, rikonstruksionin dhe riparimin, si dhe lëshimin e akteve të përdorimit të ndërtesave, shtëpive individuale private, ndërtesave dhe infrastrukturës publike e kritike, që ndërtohen në kuadër të procesit të rindërtimit. b) Bashkërendon me organe te tjera, në nivel vendor dhe qendror, në funksion të realizimit të procesit të rindërtimit; c) Kryen të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara me këtë akt ose me vendim të organeve të vetëqeverisjes vendore.4. Njësia e vetëqeverisjes vendore bashkëvepron me njësitë zbatuese, Entin Kombëtar të Banesave, Autoritetin Rrugor Shqiptar, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elekëtrike, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, ministritë e linjës, si dhe me çdo institucion tjetër publik përgjegjës, u konstatua që MSHR ka bërë të mundur koordinimin përgjegjësive të NJVV dhe Autoriteteve përgjegjëse nëpërmjet inspektimeve dhe inaugurimeve në terren, marrëveshjeve me donatorët si dhe me anë të takimeve online me kryetarët e bashkive në datat: 20.03.2020, 20.04.2020, 16.06.2020, 21.07.2020 dhe 27.07.2020.<br><br>Sipas subjektit të audituar takimet me Kryetarët e Bashkive janë bërë online për shkak të pandemisë, lidhur me situatat të lartpërmendura.<br><br>Nga sa më sipër, konstatohet se përveç procedurës së përcaktuar në Aktin normativ nr.9 për NJVV, 5 takimeve online dhe inaugurimeve, **nuk ka të dokumentuar ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për ministritë dhe institucionet e tjera, si dhe pjesërisht për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose që kanë mbetur të pastrehë, si pasojë e tërmetit.** |
| **Kriteri:** | - Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò neni 17, pika 3 dhe 4;<br>- VKM nr.11, datë 10.01.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, germa ñdò dhe ñdhò, e pikës 1 të kreut II. |
| **Ndikimi:** | Mangësi në ofrimin e trajtimit të shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose që kanë mbetur të pastrehë, si pasojë e tërmetit. |
| **Shkaku** | Mungesa e përvojës në trajtimin e situatave të fatkeqësisë natyrore, si dhe situata komplekëse në kushtet e emergjencës civile kombëtare. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **3.1 Rekomandimi:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm, për ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për ministritë dhe institucionet e tjera, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose që kanë mbetur të pastrehë, si pasojë e tërmetit. |

➢ Për germën ñeò të VKM-së lidhur me **ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për strukturat e posaçme, të ngritura me ligj apo vendim, për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti.**

| | |
|---|---|
| **4. Titulli i gjetjes:** | Ministri i Shtetit nuk rezulton të ketë bërë ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për strukturat e posaçme, të ngritura me ligj apo vendim, për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti. |
| **Situata** | Informacioni lidhur me ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për strukturat e posaçme, të ngritura me ligj apo vendim, për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti, është bërë nëpërmjet inspektimeve në terren.<br>Disa nga inspektimet në terren:<br>- 11 janar 2020, inspektime në Laç, Kurbin - Një lagje e re në vend të pallatet të vjetra, me infrastrukturë nëntokësore e mbitokësore model, ku të gjithë banorët që humbën shtëpitë do të kthehen në banesa shumë më të mira;<br>- 2 shkurt 2020, inspektim punimesh në Thumanë, ku vazhdon puna me pallatet e reja që do të fillojnë njëri pas tjetrit;<br>- Në datë 8 prill 2020 është bërë inspektimi në zonën e Thumanës, e përcaktuar si Zonë e Re për Zhvillim, ku do të akomodohen në banesa të reja të gjithë ata që humbën shtëpitë e tyre nga tërmeti i datës 26 nëntor;<br>- 22 maj 2020, inspektime në Bubq, Krujë;<br>- 20 qershor 2020, inspektim i punimeve për Rindërtimin e shkollës 9-vjecare dhe kopështit ñNjazi Mastoriò në Sukth;<br>- 11 korrik 2020, inspektim në Durrës - Shkolla "Shaqe Mazreku";<br>- 5 gusht 2020, inspektim në kantierin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare Hasan Koçi në Shkozet, Durrës;<br>- 31 gusht 2020, inspektim punimesh në Baldushk, Tiranë;<br>- 5 shtator 2020, inspektim në Rrogozhinë - Në kantierin e shkollës 9-vjeçare "Gosë";<br>- 12 shtator 2020, inspektim në shkollën 9-vjeçare Ahmetaq në Vorë;<br>- 4 tetor 2020, inspektim punimesh në Shkollën nëntëvjeçare "Njazi Mastori" në Sukth, Durrës;<br>- 4 nëntor 2020, inspektim në kantierin e shkollës nëntëvjeçare ñDan Bajrami" në Gjorem;<br>- 20 nëntor 2020, inspektim banesash në Njësinë Administrative Farkë, Tiranë;<br>- 12 dhjetor 2020, inspektim në shkollën nëntëvjeçare ñBedrie Bebeziqiò.<br>Inspektimet e kryera më sipër **nuk rezultojnë të kenë të bëjnë me ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për strukturat e posaçme, të ngritura me ligj apo vendim, për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti.** |
| **Kriteri:** | VKM nr.11, datë 10.01.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, germa ñeò pikës 1 të kreut II. |
| **Ndikimi:** | Strukturat e posaçme kanë vepruar në mungesë të ndjekjes së përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti. |
| **Shkaku** | Situata e komplikuar e emergjencës civile kombëtare e shkaktuar nga tërmeti, mangësi në kuptimin dhe zbatimin e detyrave të ngarkuara, si dhe mungesa e përvojës qeverisëse për situata të tilla fatkeqësie. |
| **Rëndësia:** | E mesme |
| **4.1 Rekomandimi:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të vepruar |

| | |
|---|---|
| | dhe dokumentuar aktivitetet për ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për strukturat e posaçme, të ngritura me ligj apo vendim, për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti. |

**Për pikën 2,** të VKM-së: si përfaqësues i Këshillit të Ministrave, kontakton dhe bashkërendon me organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit**, për germën "a" lidhur me "Prezantimin e gjendjes dhe të dëmeve të shkaktuara"** është cilësuar si në vijim:
Më 6 dhjetor 2019, Qeveria e Shqipërisë ka kërkuar mbështetje nga Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore për të ndërmarrë një Vlerësim të plotë dhe gjithëpërfshirës të Nevojave të Pas-Katastrofës (PDNA) për të identifikuar dëmet, humbjet dhe nevojat e rimëkëmbjes që vijnë nga tërmetet. Partnerët trepalësh ofruan mbështetje financiare dhe teknike për të kryer vlerësimin përveç burimeve që qeveria vuri në dispozicion. Procesi i vlerësimit filloi më 16 dhjetor 2019 dhe përfundoi me 30 janar 2020, duke zgjatur gati shtatë javë. Raporti u përgatit nga ekspertë të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Kombeve të Bashkuara. Metodologjia e vlerësimit përfshinte mbledhjen e të dhënave sekondare të disponueshme dhe informacionit primar nga burime të ndryshme qeveritare dhe private, të cilat u verifikuan, dhe kur ishte e mundur, u verifikuan në terren përmes vizitave në terren. Përveç kësaj, janë kryer sondazhe të ndryshme të strukturuara: një konstatim i ndërtesës, një sondazh biznesi, një sondazh i jetesës - drejtuar njerëzve të zhvendosur në hotele dhe çadra - dhe një sondazh i familjes për popullatën e prekur, referuar si Anketa mbi Dëmet e Familjeve për shkak të Tërmeti, detajuar si më poshtë
*Akt Konstatimi për vlerësimin e shkallës së dëmtimit të godinave:* sistem *ad-hoc* i ngritur duke përfshirë 3 baza të dhënash: a) Sistemi Kombëtar i Adresave (Adresari), b) Sistemi i faturimit i OSHEE, dhe c) Ortofoto:
-*Vrojtimi i Bizneseve* mbi asetet, stokun dhe xhiro si pasojë e tërmetit, kryer nga INSTAT;
-*Vrojtimi mbi Dëmtimet në Familje si Pasojë e Tërmetit* në 3 qarqe, kryer nga INSTAT dhe PNUD;
-*Vrojtimi i hoteleve* për personat e strehuar në hotele, kryer nga PNUD
-*Vrojtimi i familjeve* për familjet e strehuara në tenda, kryer nga PNUD
Të dhënat fillestare (baseline) të marra nga INSTAT, DPT, BSH dhe Ministritë e Linjës
Raporti ñAlbania Post-Disaster Needs Assessmentò (PDNA Volume A dhe Volume B), i cili konsiderohet edhe si Programi i Përgjithshëm i Rindërtimit, është hartuar në zbatim të pikës 4-5, të nenit 14 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò. PDNA mblodhi vlerësimin e efekteve - dëmeve dhe humbjeve - të katastrofës. Dëmet dhe humbjet nganjëherë ndryshojnë ndjeshëm midis sektorëve, për shkak të specifikës së llogaritjeve të tyre përkatëse. Ndikimi i tyre në nivelin makro-ekonomik dhe të zhvillimit njerëzor u analizua gjithashtu. Së fundmi, janë bërë vlerësime të kërkesave financiare të nevojshme për të ndërmarrë rindërtimin dhe rimëkëmbjen.

*Tabela nr. 3* Dëmet dhe humbjet sipas sektorëve dhe nënsektorëve

(*në Euro*)

| Sektorët dhe Nënsektorët | Dëmet | Humbjet | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Arsimi | 63.59 | 8.76 | 72.35 |
| Shëndetësia | 8.02 | 1.91 | 9.94 |
| Strehimi | 662.30 | 34.00 | 696.30 |
| Infrastruktura | 30.41 | 3.01 | 33.42 |
| Infrastruktura Komunitare | 6.06 | 0.16 | 6.22 |
| Rrugët | 4.83 | 0.43 | 5.26 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ujësjellës Kanalizime | 0.35 | 0.00 | 0.35 |
| Komunikimi | 0.92 | 0.16 | 1.08 |
| Ndërtesat Publike | 10.07 | 2.26 | 12.33 |
| Energjia | 8.18 | 0.00 | 8.18 |
| Prodhimi | 70.82 | 79.66 | 150.48 |
| Biznesi dhe Punësimi | 47.48 | 5.47 | 52.95 |
| Turizmi | 16.71 | 73.53 | 90.24 |
| Trashëgimia Kulturore | 5.31 | 0.44 | 5.75 |
| Bujqësia | 1.32 | 0.22 | 1.54 |
| Mbrojtja Sociale | - | 0.62 | 0.62 |
| Mbrojtja Civile | 8.75 | 13.22 | 21.97 |
| Gjithsej | 843.89 | 141.18 | 985.07 |

*Burimi:* Ministri i Shtetit për Rindërtimin

86% e efekteve (dëme dhe humbje) janë private dhe 14% publike.
Në muajin shkurt raporti është prezantuar në Konferencën e Donatorëve ñBashkë për Shqipërinëò, organizuar nga Komisioni Evropian në Bruksel, më 17 shkurt 2020.

Për germën ñbò dhe ñcò të pikës 2 të VKM-së **lidhur me përgatitjen dhe propozimin e projekteve, të përgjithshme e të veçanta, si pjesë e programeve të procesit të rindërtimit dhe detajimin e nevojave dhe paraqitjen e kërkesave për donacione financiare dhe mbështetje të specializuar njerëzore**:

| **5. Titulli i gjetjes:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar përgatitjen dhe propozimin e projekteve të përgjithshme e të veçanta, që të ishin pjesë e programeve të procesit të rindërtimit, si dhe nuk ka të dokumentuar kërkesa për mbështetje të specializuar njerëzore |
|---|---|
| **Situata** | Procesi me Donatorët: Në 6 dhjetor 2019 qeveria shqiptare iu drejtua për mbështetje Bankës Botërore, Komisionit Evropian dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të bërë një vlerësim të dëmit financiar dhe nevojave për financim në kuadër të rimëkëmbjes pas tërmetit. Në muajin shkurt raporti u prezantua në Konferencën e Donatorëve ñBashkë për Shqipërinëò, organizuar nga Komisioni Evropian në Bruksel, më 17 shkurt 2020. Në Konferencë, morën pjesë 50 vende partnere, përfshirë donatorët bilateralë, multilateralë dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Në total në Konferencë u angazhuan për Shqipërinë 1.15 milionë euro në favor të Rindërtimit, nga të cilat 295 milionë euro grante, 853 milionë euro kredi të butë dhe 3.4 milionë euro kontribute në natyrë. Janë negociuar përgjatë muajve në vijim të Konferencës së Donatorëve nga Ministri i Shtetit për Rindërtim 20 marrëveshje granti, për financimin e projekteve konkrete në sektorin e edukimit, strehimit, infrastrukturës publike apo granteve të Rikonstruksionit. Ndër projektet më të mëdha janë ndërtimi i 524 apartamenteve në Kurbin nga qeveria turke, ndërtimi i 2000 apartamenteve në Durrës nga Emiratet e Bashkuara Arabe, ndërtimi i 22 shkollave në fazën e parë dhe rreth 40 në fazën e dytë nga Komisioni Evropian etj. Përfshirë edhe angazhimet e Organizatave jo-Fitimprurëse shqiptare, në total vlera e granteve të angazhuara dhe konkretizuara me marrëveshje arrin në mbi 270 milionë euro. Një sërë marrëveshjesh të tjera granti janë në fazën e hartimit.<br>Konferenca e Donatorëve - 17 shkurt 2020. Në Bruksel u zhvillua |

| | |
|---|---|
| | Konferenca e Donatorëve, në fokus të të cilës ishte mbledhja e fondeve për të ndihmuar Shqipërinë në procesin e rindërtimit pas tërmetit të fuqishëm të 26 nëntorit 2019. Bashkimi Evropian ka dhënë mbi 100 milionë euro. Ishte presidentja e Komisionit Evropian, Ursula Von der Leyen, e cila në fjalën hapëse të konferencës bëri me dije se kjo shifër do të alokohet nga buxheti i Bashkimit Evropian për Shqipërinë. Në përfundim të konferencës pjesëmarrësit kanë deklaruar secili kontributin që ofrojnë për Shqipërinë, ku shuma totale arriti në 1.15 miliardë euro.<br>Gjithashtu donacione ka pasur edhe nga fondacione shqiptare të për të cilat ka pasur vendimmarrje në Komisionin Shtetëror për Rindërtimin dhe në Këshillin e Ministrave.<br><br>Marrëveshje me donatorët, që kalojnë nëpërmjet buxhetit të shtetit, rezultojnë të nënshkruara me marrëveshje gjatë periudhës nën auditim: 204,941,104 Euro, 17,465,120 lekë dhe 76,500,000 USD.<br>Përveç donacioneve, Shqipëria ka marrë kredi të buta nga Italia me vlerën 90 milion lekë në sektorin e Emergjencave Civile, si dhe nga EIB në vlerën 100 milion lekë, për objekte publike/strehim social.<br>**Nga sa më sipër konstatohet se nga ana e Ministrit të Shtetit nuk ka të dokumentuar të jenë përgatitur dhe propozuar projekte, të përgjithshme e të veçanta, që të ishin pjesë e programeve të procesit të rindërtimit, si dhe nuk ka të dokumentuar kërkesa për mbështetje të specializuar njerëzore.** |
| **Kriteri:** | VKM nr.11, datë 10.01.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, germa ñbò dhe ñcò të pikës 2 të kreut II. |
| **Ndikimi:** | Mangësi në përfundimin në një afat sa më të shkurtër të eliminimit të pasojave nëpërmjet projekteve dhe kërkesave për mbështetje të specializuar. |
| **Shkaku** | Situata e komplikuar e emergjencës civile kombëtare e shkaktuar nga tërmeti, mangësi në kuptimin dhe zbatimin e detyrave të ngarkuara, si dhe mungesa e përvojës qeverisëse për situata të tilla fatkeqësie. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **5.1 Rekomandimi:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të vepruar në kohë në lidhje me përgatitjen dhe propozimin e projekteve, të përgjithshme e të veçanta, që të jenë pjesë e programeve të procesit të rindërtimit, si dhe kërkesë për mbështetje të specializuar njerëzore. |

- Lidhur me germën ñçò: **informimin e secilit prej tyre për mënyrën e përdorimit dhe të eficiencës së arritur për çdo donacion apo mbështetje tjetër të ofruar prej tyre.**

| | |
|---|---|
| **6. Titulli i gjetjes:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar informacione për mënyrën e përdorimit dhe eficiencën e arritur për çdo donacion apo mbështetje të ofruar nga organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit. |
| **Situata** | Mënyra e përdorimit dhe eficenca e arritur për çdo donacion, si edhe përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve janë të parashikuara në marrëveshjet e nënshkruara mes palëve. Nëpërmjet komunikimeve në mënyrë elekëtronike, janë bërë raportime të ecurisë së procesit të rindërtimit nga Donatorët. Gjithashtu janë bërë prezantime në lidhje me ecurinë e |

| | |
|---|---|
| | procesit me Donatorët. Një nga modelet e prezantimeve lidhur me Programin e Rindërtimit me donatorët, e mbajtur në Janar të 2021 në Bruksel, e cila shpjegon të gjithë situatën e Rindërtimit lidhur me shtëpitë, arsimin, infrastrukturës publike, akomodimit të familjeve të prekura etj.<br>Nga cilësimet e mësipërme, konstatohet se, **Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar informacione për mënyrën e përdorimit dhe eficiencën e arritur për çdo donacion apo mbështetje të ofruar.** |
| **Kriteri:** | VKM nr.11, datë 10.01.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, germa ñçò e pikës 2 të kreut II. |
| **Ndikimi:** | Mungesë transparence në përdorimin me eficiencë të donacioneve dhe mbështetjes së ofruar. |
| **Shkaku** | Situata e komplikuar e emergjencës civile kombëtare e shkaktuar nga tërmeti, si dhe mangësi në kuptimin dhe zbatimin e detyrave të ngarkuara. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **6.1 Rekomandimi:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të informuar për mënyrën e përdorimit dhe eficiencën e arritur për çdo donacion apo mbështetje të ofruar nga organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit. |

- Për pikën 3, të VKM-së, ku cilësohet se MSHR ñ**Përgatit dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave projektakte ligjore e nënligjore. Nxit, bashkërendon dhe jep mendim për projektaktet që propozohen nga ministrat, të cilat trajtojnë, ndër të tjera, edhe çështje me interes ose brenda fushës së përgjegjësisë së tij**ò.

Brenda fushës së tij të përgjegjësisë Ministri i Shtetit për Rindërtim ka propozuar dhe paraqitur në Këshillin e Ministrave mbi 236 VKM. Gjithashtu, nëpërmjet sistemit e-akte, është kërkuar mendim për rreth 40 akte, për të cilat Ministri i Shtetit për Rindërtimin ka dhënë dakordësinë në parim. Më poshtë janë listuar disa prej tyre:

- Është kërkuar mendim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për Projektvendimin *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si edhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore"", datë 9.9.2020*
- Është kërkuar mendim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për projektvendimin ñ*Për miratimin e kategorisë së ndërtesave që përjashtohen nga Ligji nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave", datë 23.2.2021;*
- Është kërkuar mendim nga Zv. Kryeministri për projektvendimin *"Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore" "Sistemi i menaxhimit të informacionit E-Akte", datë 16.10.2020.*
- Me shkresën nr. 2110/1, datë 22.04.2020 i dërgohet MFE mendim për projekt akt normativ për disa ndryshime dhe shtesa për ligjin e nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar.
- Me shkresën nr. 722/1 , datë 31.01.2020, dërgohet mendim për një projekt-vendim, MFE. ñPër kushtet, rregullat dhe dokumentet, që shoqërojnë kërkesën për dhënien e lejes së ndërtimit për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë natyrore, për përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.ò

- Kërkesë për përcaktimin  e zonave për rindërtim, shkresa nr. 1 prot., datë 06.01.2020, drejtuar kryetarit të bashkisë Tiranë, Kurbin, Durrës, Lezhe, Rreshën, Kamez, Shjak, Kavajë, Krujë, Vorë.
- Për marrjen e masave në lidhje me procedurat e shpronësimit dhe \ose shkëmbimit në kuadër të procedurave të rindërtimit. Shkresa nr.289, prot., datë 17.01.2020 drejtuar MIE-së.
- Me shkresën nr.723, datë 31.01.2020 për përcaktimin e AKSHI, si njësi zbatuese, me anë të Vendimit nr.2, datë 20.01.2020, KSHR ka vendosur marrjen e masave për ngritjen e Portalit unik qeveritar nga AKSHI, në zbatim të nenit 38, të Ligjit 97/2019 ñPër miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.012.2019 të KM, ñPër përballimin e fatkeqësisë natyroreò
- Kërkese për rialokim fondesh për bashkitë e prekura, drejtuar MFE-së me shkresën nr.6431, datë 26.12.2019, Për kryerjen e inspektimeve dhe vlerësimeve të thelluara nga inxhinierë të cilët janë specialitete të fushës, arkitektë dhe konstruktorë.
- Me shkresën nr.1431, datë 28.02.2020 i përcillet draft-urdhri Kryeministrit, ñPër Ngritjen e grupit ndëristitucional të punës për tërheqjen e donacioneve në kuadër ë procesit të rindërtimitò.
- Kërkesë për vlerësimin dhe dhënien e miratimit për listën e përditësuar të objekteve arsimore në kuadër të procesit të rindërtimit, drejtuar Institutit të Ndërtimit, me shkresën nr1942/1, datë 03.04.2020
- Me shkresën nr. 2110/1, datë 22.04.2020 i dërgohet MFE mendim për projekt akt normativ për disa ndryshime dhe shtesa për ligjin e nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar
- Përcillet për njohje dhe zbatim marrëveshja e bashkëpunimit ,me shkresën nr. 2534/2, datë 15.05.2020 lidhur ndërmjet MSHR dhe Shoqërisë Gener 2 SHPK, ñPër kontributin në natyrë, në zonën e re për zhvillim në Thumanë.ò Shkresë drejtuar FSHZH, Bashkisë Krujë dhe AKMC.
- Për trajtim dhe kompetencë, drejtuar MASR, me shkresën nr.4397/1, datë 16.09.2020, për vlerësimin e kërkesës për përfshirjen e objektit arsimor shkolla 9-vjecare óFillore Teneò, e ndodhur në Rrëshen, bazuar në politikat e hartuara dhe miratuara nga MASR.
- Me shkresën nr.4797, datë 21.09.2020, përcillet marrëveshja e bashkëpunimit e firmosur nga MSHR, ndërmjet KM dhe Fondit të Katarit për Zhvillim, për financimin e rikonstruksionit të dy shkollave dhe një kopshti në Bashkinë Tiranë.

• Për pikën 4, të VKM-së ñ**Përfaqëson Këshillin e Ministrave në marrëdhëniet e informimit të publikut për çështjet brenda fushës së tij të përgjegjësisë**ò. i gjithë informacioni i deklaruar është i publikuar në funksion të parimit të transparencës, në portalin unik qeveritar www.rindertimi.gov.al në seksionin Multimedia/Fotogaleri/Videogaleri.

**Për kreun III, Ministri i Shtetit për Rindërtimin, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, ka këto kompetenca:**

1. Merr pjesë në mbledhjet e Komitetit të Emergjencave Civile.
2. Thërret për raportim dhe ngarkon me detyra strukturat e mbrojtjes civile.
3. Krijon grupet e punës dhe organizon veprimtarinë për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit.
4. Bashkërendon me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit.
5. Drejton dhe koordinon, në nivel qendror, strukturat operacionale për përballimin e pasojave dhe zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit.

6. Informon vazhdimisht dhe në kohë Kryeministrin, kur është rasti, edhe Këshillin e Ministrave, për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit e të përdorimit të burimeve materiale e njerëzore.

7. Kontakton në vijimësi dhe, për çështje të veçanta, me organizatat ndërkombëtare dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, për garantimin e ekspertizës së hartimit dhe për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit.

| | |
|---|---|
| **7. Titulli i gjetjes:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar ushtrimin e kompetencave në lidhje me raportimin dhe ngarkimin me detyra të strukturave të mbrojtjes civile; krijimin e grupeve të punës dhe organizmin e veprimtarive për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit; bashkërendimin e punës me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit; si dhe drejtimin dhe koordinimin, në nivel qendror, të strukturave operacionale për përballimin e pasojave dhe zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit |
| **Situata** | Nga informacionet e marra nëpërmjet emailit zyrtar, nga subjekti i audituar cilësohet se në zbatim të VKM Nr. 11, datë 10.1.2020, ñ*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtimin",* objekti i fushës së përgjegjësisë së MSHR, ndahet në kompetenca dhe detyrime. Nga ana e tyre theksohet se duhet marrë në konsideratë se pikat e mësipërme të parashikuara në Kreun III të këtij vendimi janë kompetenca dhe jo domosdoshmërisht detyrime, të cilat në varësi të dinamikës së procesit dhe nevojës në sektorë të veçantë, mund të konsiderohen për tû aplikuar.<br><br>Për sa i përket pikës 6 janë bërë raportime në mënyrë periodike për informimin në lidhje me ecurinë e procesit të rindërtimit nga të 11 bashkitë e prekura nga tërmeti i datës 26 nëntor. Këto raportime janë kryer në mënyrë elekëtronike, për të cilat ka pasur raportime periodike për Kryeministrin, për të gjithë procesin e rindërtimit përfshirë edhe negocimi apo monitorimin e procesit me donatorët.<br>Nga informacioni i mësipërm konstatohet se, **Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar ushtrimin e kompetencave në lidhje me raportimin dhe ngarkimin me detyra të strukturave të mbrojtjes civile; krijimin e grupeve të punës dhe organizmin e veprimtarive për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit; bashkërendimin e punës me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit; si dhe drejtimin dhe koordinimin, në nivel qendror, të strukturave operacionale për përballimin e pasojave dhe zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit.** |
| **Kriteri:** | VKM nr.11, datë 10.01.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, kreu III. |
| **Ndikimi:** | Vonesa dhe mungesë cilësie në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit. |
| **Shkaku** | Situata e komplikuar e emergjencës civile kombëtare e shkaktuar nga tërmeti, si dhe mangësi në kuptimin dhe ushtrimin e kompetencave të ngarkuara. |

| | |
|---|---|
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **7.1 Rekomandimi:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të ushtrojë dhe të dokumentojë kompetencat në lidhje me raportimin dhe ngarkimin me detyra të strukturave të mbrojtjes civile; krijimin e grupeve të punës dhe organizmin e veprimtarive për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit; bashkërendimin e punës me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit; si dhe drejtimin dhe koordinimin, në nivel qendror, të strukturave operacionale për përballimin e pasojave dhe zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit. |

## II. Për çështjen e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19

Me VKM nr. Nr.228, datë 18.3.2020 ñPër një shtesë në Vendimin nr.11, datë 10.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtiminò **Ministri i Shtetit për Rindërtimin është përgjegjës për koordinimin dhe drejtimin e punës, ndërmjet ministrive dhe institucioneve, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19.**

| | |
|---|---|
| **8. Titulli i gjetjes:** | Ministrit i Shtetit për Rindërtimin në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Ministrave: - nuk ka të dokumentuar aktivitetin për koordinimin, drejtimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 dhe për pasojë mungon një plan i tillë;<br>- nuk ka të dokumentuar evidentimin e burimeve të brendshme, njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore;<br>- nuk ka të dokumentuar veprimtarinë për koordinimin dhe drejtimin e strukturave e të njësive, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave, për zbatimin e planit të përballimit të situatës ekonomike, të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;<br>- nuk ka të dokumentuar detajimin e nevojave për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;<br>- nuk ka të dokumentuar veprimtarinë për koordinimin dhe drejtimin e punës si dhe rekomandimin e institucioneve për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim në Këshillin e Ministrave të projektakteve, ligjore e nënligjore, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;<br>- nuk ka të dokumentuar rastet e thirrjes për raportim të strukturave të cilat kanë lidhje me situatën ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;<br>- nuk ka të dokumentuar krijimin dhe drejtimin e grupeve të punës dhe organizimin e veprimtarive për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;<br>- nuk ka të dokumentuar veprimtarinë për bashkërendimin me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive në funksion të realizimit të planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19. |
| **Situata** | Në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Ministrave, është përgjegjës për:<br>a) koordinimin, drejtimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19; |

| | |
|---|---|
| | b) evidentimin e burimeve të brendshme, financiare dhe njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore, dhe propozimin për miratim në Këshillin e Ministrave të akteve përkatëse, për përdorimin e këtyre burimeve;<br>c) evidentimin e burimeve financiare të jashtme dhe përcaktimin e mënyrës së përthithjes së tyre, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 dhe propozimin për miratim në Këshillin e Ministrave të akteve përkatëse, për përdorimin e këtyre burimeve;<br>ç) koordinimin dhe drejtimin e strukturave e të njësive, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave, për zbatimin e planit të përballimit të situatës ekonomike, të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;<br>d) prezantimin e gjendjes dhe të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;<br>dh) përgatitjen dhe propozimin e projekteve, të përgjithshme e të veçanta, si pjesë të planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;<br>e) detajimin e nevojave për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;<br>ë) koordinimin dhe drejtimin e punës si dhe rekomandimin e institucioneve për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim në Këshillin e Ministrave të projektakteve, ligjore e nënligjore, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;<br>f) nxitjen, bashkërendimin dhe dhënien e mendimit për projektaktet që propozohen nga ministritë, të cilat trajtojnë, ndër të tjera, edhe çështje me interes ose brenda fushës së përgjegjësisë së tij;<br>g) thirrjen për raportim të strukturave të cilat kanë lidhje me situatën ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;<br>gj) krijimin dhe drejtimin e grupeve të punës dhe organizimin e veprimtarive për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;<br>h) bashkërendimin me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive në funksion të realizimit të planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;<br>i) informimin, vazhdimisht dhe në kohë, të Kryeministrit, kur është rasti, edhe Këshillin e Ministrave, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID19.<br><br>Në lidhje me çështjet e mësipërme, nga subjekti i audituar është bërë me dije se Ministri i Shtetit për Rindërtimin ***ka patur rol koordinues për përballimin e efekteve financiare dhe në lidhje me marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të Covid-19 ka qenë bashkëfirmosës***. Për këtë proces janë vënë në dispozicion aktet normative dhe relacionet shpjeguese për miratimin e marrëveshjeve te vaksinave, ku kërkohet nga ana e tyre që informacioni të konsiderohet i ezauruar.<br><br>*Sipas të dhënave të mësipërme, konstatohet se nëpërmjet 6 vendimeve të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar janë evidentuar dhe vënë në dispozicion ndihmë financiare për të punësuarit dhe ish të punësuarit 13,931,086,000 lekë, në pjesën më të madhe nga zëri "Kontingjenca për paketën sociale anti-COVID", miratuar në buxhetin e shtetit, për vitin 2020.* |

| | |
|---|---|
| | *Gjithashtu, janë miratuar dhe tre marrëveshje huaja me vlerë të përgjithshme 207,000,000 euro, si më poshtë:*<br>- Ligj nr. 70/2020 Për miratimin e huamarrjes prej 139,300,000 SDR që Fondi Monetar Ndyrkombytar i akordon Shqipërisë nypyrmjet Instrumentit ty Financimit ty Shpejty (RFI), datë 28.05.2020;<br>- Ligj nr. 144/2020 Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin për Reagimin ndaj Emergjencës COVID-19 në Shqipëri, miratuar më 03.12.2020;<br>- Ligj nr. 157/2020 Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent për huamarrësin, dhe Bashkimit Evropian, si huadhënës, për ndihmën makrofinanciare për Shqipërinë, 17.12.2020.<br>*Duhet theksuar se në periudhën e audituar, nuk ka të dhëna në lidhje me fillimin e lëvrimit të këtyre shumave sipas destinacionit përkatës.* |
| **Kriteri:** | VKM nr. Nr.228, datë 18.3.2020 ñPër një shtesë në Vendimin nr.11, datë 10.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtiminò |
| **Ndikimi:** | Mangësi në trajtimin dhe menaxhimin e situatës ekonomike gjatë pandemisë Covid -19. |
| **Shkaku** | Rrethi i gjerë i problematikave të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, duke përfshirë dhe ato për përballimin e situatës së pandemisë |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **8.1 Rekomandimi:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të marrë masat e nevojshme për koordinimin, drejtimin dhe ndjekjen e veprimtarisë për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19, duke i paraprirë me krijimin dhe drejtimin e grupeve të punës dhe organizimin e veprimtarive për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar, me evidentimin e burimeve të brendshme, njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore; detajimin e nevojave për përballimin e situatës ekonomike dhe më pas thirrjen për raportim të strukturave të cilat kanë lidhje me situatën ekonomike, si dhe sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive në funksion të realizimit të planit të përballimit të situatës ekonomike. |

- **Lidhur me marrëveshjet e vaksinave:**

| | |
|---|---|
| **9. Titulli i gjetjes:** | Mungesa e vënies në dispozicion të marrëveshjeve për furnizimin e vaksinave në periudhën e audituar 01.01.2020 deri më 30.04.2021, nuk i ka mundësuar grupit të auditimit të KLSH, shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre, dhe në këtë kuadër të aktivitetit të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin në cilësinë e ministrit përgjegjës të fushës, si dhe njërit nga tre institucionet bashkëfirmosëse të tyre. |
| **Situata** | Nga dokumentat e tjerë **lidhur me Marrëveshjet e Vaksinave**, informacion i kërkuar nga grupi i KLSH-së, me komunikimet e njëpasnjëshme me subjektin, subjekti vuri në dispozicion aktet ligjore, sasinë dhe çmimin (sipas subjektit) në formë tabelare si dhe disa relacione lidhur me ñMiratimin e tekstit të Marrëveshjeve për prodhimin dhe furnizimin me vaksinaò |

Për periudhën objekt auditimi u shqyrtua dokumentacioni lidhur me vaksinat:
1- ñDokumentiò lidhur me Vaksinën ñCovaxò, sipas Ligjit nr.134/2020 ñPër ratifikimin e marrëveshjes së angazhimit ndërmjet KM së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga MSHMS, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturë globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX FACILITY), miratuar më datë 29.10.2020, për sasinë 1,140,000 doza dhe vlerë gjithsej 5,534,000 USD;
2- ñDokumentiò lidhur me Vaksinën ñPhizer Exportò, Akti Normativ nr.3, datë 18.01.2021 ñPër miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ñPër prodhimin dhe furnizimin ndërmjet pfizer export b.v. dhe MSHMS, MSHR dhe ISHP. Bashkëlidhur relacion për Aktin normativ ñPër miratimin e tekstit të Marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet pfizer export b.v. dhe MSHMS, MSHR dhe ISHP, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave anti-covid-19 në Republikën e Shqipërisë si dhe përdorimin e tyre në popullatëò, me sasinë 499,590 doza dhe vlerën 12 dollarë për dozë;
3- ñDokumentiò lidhur me Vaksinën ñKeymenò, Akti Normativ nr. 10, datë 24.03.2021 ñPër miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet distributorit të autorizuar ñKeymen ilaç Sanayi ve Ticaretò dhe MSHMS, MSHR dhe ISHP, me sasinë 500,000 doza dhe vlerë 20 dollarë për dozë;
4- ñDokumentiò lidhur me Vaksinën ñSputnikò, Akti Normativ nr.19, datë 16.04.2021 ñPër miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet ñHuman Vacine ñ LLC dhe MSHMS, MSHR dhe ISHP, për sasinë 25,000 doza dhe vlerë 19.9 dollarë për dozë. Si dhe Akti Normativ nr.16, datë 07.04.2021 ñ Për miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet Sputnik V dhe MSHMS, MSHR dhe ISHP, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave anti-covid-19 në Republikën e Shqipërisë si dhe përdorimin e tyre në popullatëò.

***Me gjithë insistimin e grupit të auditimit verbalisht dhe me shkrim nëpërmjet postës elekëtronike për të na vënë në dispozicion marrëveshjet e nënshkruara për furnizimin me vaksina, për të shqyrtuar veprimtarinë e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin në këtë drejtim, nuk na u krijua akses në këto dokumente zyrtare, me pretendimin se janë sekret tregtar dhe janë palë firmosëse, si dhe duhet t'i drejtoheshim Ministrisë së Shëndetësisë.***

Në përgjithësi, në praktikën e procedurës së furnizmit me vaksina konstatohet se në fillim është miratuar Akti Normativ për miratimin e tekstit të marrëveshjes, për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet subjektit përkatës, dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik, dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave anti-covid-19 në Republikën e Shqipërisë, si dhe përdorimin e tyre në popullatë. Në vijim, është miratuar Akti Normativ për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ñPër prodhimin dhe furnizimin ndërmjet subjektit përkatës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publikò dhe më pas është kryer furnizimi me sasinë dhe llojin e rënë dakord.
Gjithashtu, në Aktin Normativ të miratimit të tekstit të marrëveshjes, në një pikë të veçantë të nenit - Përjashtimi nga detyrimet, se: ñMarrëveshja për

| | |
|---|---|
| | prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet subjektit përkatës (p.sh. Pfizer Export BV) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së shprehur në marrëveshje nga subjekti përkatës (p.sh. Pfizer Export BV) nuk do të publikohet në asnjë website të institucioneve apo në Fletoren Zyrtare.<br>Referuar ligjit nr. 96/2021ñPër pronësinë industrialeò, të ndryshuar, nenit 111/a, pika 1: ññSekreti tregtarò është informacioni që përmbush kërkesat e mëposhtme:<br>a) është sekret në kuptimin që në tërësinë e tij ose për sa i përket konfigurimit të saktë dhe kombinimit të pjesëve përbërëse të tij, nuk është gjerësisht i njohur ose lehtësisht i aksesueshëm për personat që përgjithësisht merren me llojin e informacionit në fjalë;<br>b) ka vlerë tregtare, sepse është sekret;<br>c) u është nënshtruar hapave të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit, sipas rrethanave, nga personi që zotëron në mënyrë të ligjshme informacionin për të mbajtur sekretin të fshehtë.ò<br>Në kuptim dhe në zbatim të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 ñPër informacionin e klasifikuar ñSekret shtetërorò, neni 2, ñSekret shteteror" do të thotë informacion i klasifikuar sipas ketij ligji, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të rrezikoje sigurimin kombëtarò.<br>Në ligjin nr.154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 26, pika 1 dhe 2 - Aksesi në dokumentet zyrtare, është përcaktuar: ñ1. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elekëtronike, në bazat elekëtronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore.<br>2. Të gjitha subjektet e audituara janë të detyruara tôi sigurojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit akses në dokumentet zyrtare sipas paragrafit të mësipërm. Në rast të hasjes së pengesave, veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me të drejtat e mësipërme, Kontrolli i Lartë i Shtetit i drejtohet, sipas rastit, organit më të lartë administrativ ose organeve të pushtetit gjyqësor.ò<br><br>Në këto kushte, nga Ministri i Shtetit dhe kabineti i tij është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 26, pika 1 dhe 2, pasi sekreti tregtar nuk përbën rrezik për sigurinë kombëtare, pra është shumë më poshtë se niveli i sekretit shtetëror; nuk ka të cilësuar në aktet normative për vaksinat mosvënien në dispozicion të institucionit të auditimit të jashtëm publik; KLSH ka tagrin ligjor të aksesit në të gjitha dokumentet zyrtare, si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, për më tepër që të gjitha subjektet e audituara janë të detyruara tôi sigurojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit akses në dokumentet zyrtare të cilësuara sa më sipër.<br>Duhet të theksojmë se KLSH, në grupin e auditimit ka pasur anëtarë të pajisur me Certifikatën e Sigurisë së Personelit nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, i cili është Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të |

| | |
|---|---|
| | Sigurisë.<br>**Mungesa e vënies në dispozicion të marrëveshjeve për furnizimin e vaksinave në periudhën e audituar 01.01.2020 deri më 30.04.2021, nuk i mundësoi grupit të auditimit të KLSH, shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre, dhe në këtë kuadër të aktivitetit të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin në cilësinë e ministrit përgjegjës të fushës, si dhe njërit nga tre institucionet bashkëfirmosëse.** |
| **Kriteri:** | - Ligji nr. 96/2021ñPër pronësinë industrialeò, të ndryshuar, nenit 111/a, pika 1;<br>- Ligji nr.8457, datë 11.2.1999 ñPër informacionin e klasifikuar ñSekret shtetëroròò, neni 2;<br>- Ligji nr.154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 26, pika 1 dhe 2;<br>- VKM nr. 228, datë 18.3.2020 ñPër një shtesë në Vendimin nr.11, datë 10.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtiminò |
| **Ndikimi:** | Mungesë transparence në përdorimin e fondeve publike, si dhe në drejtim të bindjes së qytetarëve në nevojën dhe domosdoshmërinë e vaksinimit |
| **Shkaku** | Kuptim dhe zbatimi i gabuar i interpretimit të sekretit tregtar në komunikimin shkresor dhe juridik të subjekteve të përfshira në hartimin, miratimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të furnizimit të vendit tonë me vaksina. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **9.1 Rekomandimi:** | Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të marrë masat e nevojshme që në kuadër të koordinimit dhe drejtimit të punës, si dhe rekomandimit të institucioneve për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim në Këshillin e Ministrave të projektakteve, ligjore e nënligjore, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19, si dhe të transparencës së përdorimit të fondeve publike dhe më gjerë, të kërkojë dhe të sigurojë bërjen publike të të gjitha marrëveshjeve të vaksinave. |

Nga dokumentacioni dhe informacioni i mësipërm i vënë në dispozicion nga stafi i këshilltarëve të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin lidhur me situatën COVID-19, **konstatohet se Ministrit i Shtetit për Rindërtimin në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Ministrave:**

**- nuk ka të dokumentuar aktivitetin për koordinimin, drejtimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 dhe për pasojë mungon një plan i tillë;**

**- nuk ka të dokumentuar evidentimin e burimeve të brendshme, njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore;**

**- nuk ka të dokumentuar veprimtarinë për koordinimin dhe drejtimin e strukturave e të njësive, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave, për zbatimin e planit të përballimit të situatës ekonomike, të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;**

**- nuk ka të dokumentuar detajimin e nevojave për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;**

**- nuk ka të dokumentuar veprimtarinë për koordinimin dhe drejtimin e punës si dhe rekomandimin e institucioneve për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim në Këshillin**

**e Ministrave të projektakteve, ligjore e nënligjore, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;**
**- nuk ka të dokumentuar rastet e thirrjes për raportim të strukturave të cilat kanë lidhje me situatën ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;**
**- nuk ka të dokumentuar krijimin dhe drejtimin e grupeve të punës dhe organizimin e veprimtarive për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;**
**- nuk ka të dokumentuar veprimtarinë për bashkërendimin me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive në funksion të realizimit të planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19.**

## 2.2 Mbi veprimtarinë e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, referuar VKM-së nr. 878, datë 24.12.2019 "Për përbërjen, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit".

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit nr. 529/2, datë 25.05.2021, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni mbi veprimtarinë Komisionit Shtetëror të Rindërtimit përgjatë periudhës së auditimit 01.01.2020 ï 30.04.2020, si më poshtë:

- ***<u>Krijimi dhe përbërja e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit (KSHR)</u>***

Komisioni Shtetëror i Rindërtimit është krijuar me VKM nr. 878, datë 24.12.2019 ñPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò, si një organ ndërministror dhe ka si qëllim kryesor bashkërendimin e punës së ministrive, institucioneve të tjera përgjegjëse, si dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, të ngarkuara nga akti normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, për të gjitha veprimtaritë që lidhen me dhe që ndikojnë në përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Referuar pikës 2, Kreu I, të VKM-së së mësipërme, KSHR koordinon dhe bashkërendon punën për planifikimin e përdorimit ë fondeve të rindërtimit me qëllim përgatitjen e propozimeve që i përcillen për miratim Këshillit të Ministrave.
Referuar pikës 1, Kreu II i VKM nr. 878, datë 24.12.2019, KSHR është organ kolegjial që kryesohet nga ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe ka në përbërje këta anëtarë:

a) Ministrin e Mbrojtjes;
b) Ministrin e Brendshëm;
c) Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
ç) Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
d) Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
dh) Ministrin e Kulturës;
e) Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
ë) Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
f) Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
g) Kryetarin e Bashkisë Tiranë, me kërkesë të tij.

Vendimet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit janë të vlefshme kur sigurohet pjesëmarrja e të paktën 2/3 të anëtarëve.

- ***<u>Veprimtaria e KSHR</u>***

Në pikën 4 të nenit 14 të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019, dhe në pikën 1, të Kreut III të VKM nr. 878, datë 24.12.2019 përcaktohen kompetencat kryesore të Komisionit të Rindërtimit si më poshtë:

a) Harton dhe miraton programin e përgjithshëm të rindërtimit;
b) Bashkërendon veprimtarinë e institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, përfshirë dhe donatorët, në përputhje me programin e përgjithshëm të rindërtimit, si dhe me procesin e rindërtimit;
c) Në konsultim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e zonave të reja për zhvillim;
d) Siguron informimin e publikut dhe transparencën mbi procesin e rindërtimit;
e) Propozon, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, pranë Këshillit të Ministrave, përdorimin e fondit të rindërtimit nga njësitë zbatuese dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, përcaktimin e njësive zbatuese për projektet në kuadër të procesit të rindërtimit;
f) Monitoron periodikisht zbatimin e programit dhe të detyrave të caktuara njësive zbatuese dhe përgatit raporte për Këshillin e Ministrave;

g) Përcjell dhe propozon, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, pranë Këshillit të Ministrave, projektvendimet që kanë të bëjnë me çështjet e adresuara nga njësitë zbatuese.

Në vijim, është trajtuar veprimtaria e KSHR, referuar përcaktimeve të pikës 1, të Kreut III të VKM 878 datë 24.12.2019 (paraqitur më sipër):

**a) Hartimi dhe miratimi i programit të përgjithshëm të rindërtimit.**
Referuar pikës b/ii të nenit 13, të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019, Këshilli i Ministrave miraton propozimet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për programin e përgjithshëm të rindërtimit.
Në germën ñaò të pikës 4, të nenit 14 të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 përcaktohet se, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit harton dhe i propozon Këshillit të Ministrave programin e përgjithshëm të rindërtimit. Në pikën 1, të Kreut III të VKM 878 datë 24.12.2019 përcakton se Komisionit të Rindërtimit harton dhe miraton programin e përgjithshëm të rindërtimit.

Në pikën 2 të Kreut III të VKM 878 datë 24.12.2019 përcaktohet se, Programi i përgjithshëm i rindërtimit hartohet dhe miratohet nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, brenda 2 muajve nga shpallja e tij. Në pikën 3 të kreut të mësipërm përcaktohet se, KSHR mund të kontraktojë ekspertë gjatë hartimit të programit të përgjithshëm të rindërtimit, nëpërmjet procedurave të prokurimit, të parashikuara në kreun VI, të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019.

Në pikën 5 të nenit 14 të Aktit Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 përcaktohet se, Programi i Përgjithshëm i Rindërtimit përmban të paktën të dhëna:
- a) personat që kanë humbur jetën nga fatkeqësia;
- b) familjet e mbetura të pastreha ose të dëmtuara, të renditura sipas kritereve të përparësisë që parashikohen në këtë ligj;
- c) ndërtesat e dëmtuara dhe të rrezikuara, të ndara në publike dhe private;
- ç) kushtet dhe kriteret e përfitimit në përputhje me programet e procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të këtij akti;
- d) objektet e infrastrukturës publike dhe kritike, si dhe veprat e trashëgimisë kulturore, zonat e mbrojtura dhe burimet natyrore të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore;
- dh) vlerën e dëmeve të shkaktuara, për aq sa është e mundur;
- h) masat që rekomandohen të merren në kuadër të programeve të procesit të rindërtimit dhe buxhetet e përafërta, nëse ka.

Në punën e tij, KSHR mbështetet nga Sekretariati Teknik i Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, funksion të cilin e kryen Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Për të shqyrtuar dhe audituar çështjet e mësipërme, grupi i auditimit të KLSH, me anë të e-mailit zyrtar të datës 07.06.2021, drejtuar Sekretariatit Teknnik të KSHR-së, ka kërkuar Programin e Përgjithshëm të Rindërtimit, të miratuar, në zbatim të pikës 4, të Nenit 14 të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 dhe pikës 2 të Kreut III VKM 878 datë 24.12.2019. Në vijim të e-mailit të grupit të auditimit, me e-mailin e datës 08.06.2021 Sekretariati i KSHR, ka përcjellë dokumentet ñAlbania Post-Disaster Needs Assessmentò (PDNA), shkurt 2020, volumi A dhe ñAlbania Post-Disaster Needs Assessmentò shkurt 2020, volumi B. ***Referuar përgjigjes zyrtare të subjektit nën auditim, raportet PDNA volumi A dhe volumi B, konsiderohen Programi i Përgjithshëm i Rindërtimit***. Në vijim me e-mailin e datës 27.07.2021, Sekretariati i KSHR ka përcjellë ñPDNA është në vetvete dokumenti zyrtar i evidentimit dhe vlerësimit të dëmeve e hartuar nga strukturat e specializuara të ekspertëve të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Kombeve të Bashkuara, me koordinimin dhe bashkëpunimin e Qeverise Shqiptare dhe është hartuar në zbatim të pikës 4-5, të nenit 14 të

Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, dhe përbën atë që quhet korniza bazë e Programit të Rindërtimit. Mbi bazën e këtij Raportit si dhe të gjithë procesit të koordinimit dhe vlerësimit të bërë nga Autoritetet Përgjegjëse, janë propozuar, hartuar dhe miratuar e gjithë korniza e vendimmarrjeve të Komisionit Shtetëror për Rindërtimin, për të pasuar me Vendimet e Këshillit të Ministrave, *të cilat nuk janë gjë tjetër veçse Plani i Masave Financiare për përballimin e pasojat e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 dhe përbëjnë atë që quhet Programi i Rindërtimit.*ò

Referuar dokumenteve ñAlbania Post-Disaster Needs Assessmentò, shkurt 2020, volumi A dhe B, këto të fundit janë realizuar nëpërmjet bashkëpunimit të Qeverisë së Shqipërisë dhe partnerëve të saj ndërkombëtarë si, Bashkimi Evropian, agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe Banka Botërore. Duke ju referuar të dhënave që duhet të përmbajë Programi i Rindërtimit, sipas pikës 5 të nenit 14 të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019, në vijim është kryer krahasimi me të dhënat e paraqitura në PDNA volumi A dhe B dhe konstatohet si më poshtë vijon:

Në lidhje me: *a) personat që kanë humbur jetën nga fatkeqësia;*

Në faqen 15, të PDNA Vol. A, jepen të dhëna mbi personat që kanë humbur jetën nga fatkeqësia ñTërmeti shkaktoi 51 viktima, nga të cilët shtatë ishin fëmijë të moshës 0-14 vjeç, 34 ishin midis moshat 15-59, dhe 10 ishin mbi moshën 60 vjeç; 24 vdekje ishin femra dhe 27 meshkuj. Të paktën 913 njerëz u plagosën, përfshirë 255 persona që u plagosën gjatë lëkundjeve të mëpasshmeò.

*b) familjet e mbetura të pastreha ose të dëmtuara, të renditura sipas kritereve të përparësisë që parashikohen në këtë ligj;*

Në pikën, 8 të nenit 18 të Kreut 4 ñProcesi i Rindërtimitò të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 ñProcesi i Rindërtimit dhe Programet e tijò

Kriteret e përparësisë për renditjen e përfituesve janë:

a) familjet që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore;
b) familjet një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
c) familjet që kanë në përbërje personat me aftësi të kufizuara;
d) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit;
e) familjet në skemën e ndihmës ekonomike; dh) të rënët në krye të detyrës.

Lidhur me renditjen e familjeve e mbetura të pastreha ose të dëmtuara, sipas kritereve të përparësisë, në dokumentet PDNA volumi A dhe B, nuk u gjetën të dhëna të tilla. Në faqen 91 të PDNA Volumi A përcaktohet se: ñNjësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) mund të jenë njësi zbatuese. Ata kryejnë këto funksione: Krijojnë, menaxhojnë dhe azhurnojnë bazën e të dhënave të individëve dhe familjeve që kanë humbur familjen dhe / ose kanë mbetur të pastrehë si rezultat i katastrofave natyrore, si dhe plotësimin e nevojave të programeve të rindërtimit.ò

Lidhur me sa më sipër, me anë të e-mailit zyrtar të datës 21.07.2021, grupi i auditimit kërkoi informacion mbi trajtimin në Planin e Përgjithshëm të Rindërtimit, të familjeve të mbetura të pastreha ose të dëmtuara, të renditura sipas kritereve të përparësisë. Në vijim, me anë të e-mailit të datës 28.07.2021 Sekretariati i KSHR përcolli: ñPDNA është në vetvete dokumenti zyrtar i evidentimit dhe vlerësimit të dëmeve e hartuar nga strukturat e specializuara të ekspertëve të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Kombeve të Bashkuara, me koordinimin dhe bashkëpunimin e Qeverise Shqiptare dhe është hartuar në zbatim të pikës 4-5, të nenit 14 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, dhe përbën atë që quhet korniza bazë e Programit të Rindërtimit. Mbi bazën e këtij Raportit si dhe të gjithë procesit të koordinimit dhe vlerësimit të bërë nga Autoritetet Përgjegjëse, janë propozuar, hartuar dhe miratuar e gjithë korniza e vendimmarrjeve të Komisionit Shtetëror për Rindërtimin, për të pasuar me Vendimet e Këshillit të Ministrave , të cilat nuk janë gjë tjetër veçse Plani i Masave Financiare për

përballimin e pasojat e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 dhe përbëjnë atë që quhet Programi i Rindërtimit.
Në lidhje me trajtimin në planin e Përgjithshëm të Rindërtimit të familjeve të mbetura të pastreha ose të dëmtuara, të renditura sipas kritereve të përparësisë, (parashikuar edhe në Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019); kanë dalë në zbatim VKM nr. 904, datë 24.12.2019 ñPër përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa Programe të Procesit të Rindërtimitò dhe VKM nr. 5, datë 6.01.2020 ñPër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet modelò, vendime këto të cilat përcaktojnë:

1. Kushtet, kriteret, kategoritë prioritare, masën e përfitimit, procedurat dhe rregullat për vlerësimin e përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit, të parashikuara në aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò;
2. Rregullat për përfitimin nga programi i granteve të rindërtimit, nëpërmjet miratimit të projekteve model, masën e përfitimit të granteve të rindërtimit të shtëpive individuale të banimit ose të rikonstruksionit të banesave, ndërtesave ose shtëpive individuale të banimit, kushtet, kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për shpërndarjen e granteve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave përkatëseò.

*c)ndërtesat e dëmtuara dhe të rrezikuara, të ndara në publike dhe private;*
Në faqen 7 të PDNA volumi A, përcaktohet se:
***"Arsimi:*** Dëmtimet u raportuan në 321 institucione arsimore në 11 komunat e prekura, që përfaqëson 24% të të gjitha institucioneve arsimore.
Shëndetësia: 36 institucione shëndetësore (8% e totalit në 11 komuna) ishin dëmtuar pjesërisht ose plotësisht, ku 22 janë objekte të kujdesit shëndetësor parësor. Kishte dëme në tre spitale rajonale, nëntë spitale universitare (njësitë), dy spitale komunale, dhjetë qendra shëndetësore dhe 12 posta shëndetësore.
***Strehimi:*** Një total prej 11,490 njësish banimi u kategorizuan si të shkatërruara plotësisht ose të shkatërruara dhe duhet të rindërtohen. Një shtesë prej 83,745 e njësive të banimit u dëmtuan pjesërisht ose lehtë, që kishin nevojë për riparim dhe rindërtimi. Në përgjithësi 18% e njësive totale të strehimit janë prekur.
***Infrastruktura:*** Nga dëmi dhe humbja totale në këtë sektor, e cila arrin në 33.42 milion Euro (4.11 miliardë lekë), një e treta ishte në komunën e Durrësit. Ndërtesat qeveritare dhe infrastruktura e komunitetit u prekën veçanërisht. Ka pasur dëme në dy argjinaturat e lumenjve, 50 shporta gabion, një digë, 42 ndërtesa komunale, një burg dhe 33 ndërtesa zyrash.
***Produktiviteti:*** nënsektori i Trashëgimisë Kulturore, 2 muze kombëtar dhe 3 muze lokalë u klasifikuan si të pasigurt dhe janë ende të mbyllura për publikun, ndërsa 23 monumente dhe site shtesë u klasifikuan si me rrezik të lartë dhe 30 të tjera monumentet si rrezik mesatar. Dëmet në nën-sektorin e Bujqësisë ishin të vogla dhe kishin të bënin me bujqësinë inputet dhe pajisjet. Kishte gjithashtu dëmtime në argjinaturat dhe stacionet e kullimit të ujit në Durrës dhe Lezhë, si dhe në Institutin për Sigurinë e Ushqimit dhe ndërtesën e Veterinarisë.
***Mbrojtja Civile dhe Reduktimi i Rrezikut nga Katastrofat:*** 57 ndërtesa nga Ministria e Mbrojtjes u dëmtuan, 1 stacion për shuarjen e zjarrit duhej shembur, 2 ndërtesa të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ishin pjesërisht të dëmtuara, 8 stacione monitorimi nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit u dëmtuan lehtë, 6 ndërtesa nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit ishin pak dëmtuar gjithashtu, dhe 7 ndërtesa shtesë u dëmtuan pa u riparuarò.
Ndërsa në PDNA volumi B janë trajtuar dëmet dhe humbjet të ndara në publike dhe private, në seksionin e çdo sektorit.

*d) Kushtet dhe kriteret e përfitimit në përputhje me programet e procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të këtij akti*

Mbi kushtet dhe kriteret e përfitimit, Akti normativ nr. 9, parashikon:

- *Në nenin 13,* ñKëshilli i Ministrave miraton kushtet, kriteret, fondin financiar dhe rregullat për përdorimin e tij, organet përgjegjëse dhe procedurat për përballimin e pasojave të veçanta të fatkeqësisë natyroreò;
- *Në nenin 18, pika 7* ñKushtet, kriteret, kategoritë prioritare, procedurat dhe rregullat për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, përfshirë dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministraveò
- *Në nenin 19, pika 7* ñKushtet dhe kriteret e përfitimit në objektet e reja rregullohen me vendim të Këshillit të Ministraveò
- *Në nenin 25, pika 1* ñRregulla për projektet model, masa e përfitimit, kushtet, kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e kërkesave dhe shpërndarjen e grantit parashikohen me vendim të Këshillit të Ministraveò
- *Në nenin 27, pika 2* ñKriteret, kushtet, masa e shpenzimit që kompensohet, procedurat përkatëse dhe autoritetet përgjegjëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministraveò

Lidhur me këtë parashikim, në PDNA volumi A, është referuar VKM Nr. 8 i datës 06.01.2020, ñPër përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përfitimin e sipërfaqeve të ndërtimit në banesën e re ndërtesa nga subjekte të cilët posedonin pronë të ndërtuar në mënyrë të paligjshme.ò, faqe 89.

Lidhur me sa më sipër, në pyetjen e drejtuar nga grupi i auditimit nëpërmjet e-mailit zyrtarë, subjekti ka përcjellë të njëjtën përgjigje si për nënpikën ñfamiljet e mbetura të pastreha ose të dëmtuara, të renditura sipas kritereve të përparësisë që parashikohen në këtë ligjò, trajtuar më lartë.

*e) objektet e infrastrukturës publike dhe kritike, si dhe veprat e trashëgimisë kulturore, zonat e mbrojtura dhe burimet natyrore të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore:*

Sikurse janë paraqitur edhe sipër, në germën ñaò të këtij trajtimi, në PDNA Volumi A, janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur infrastruktura publike dhe kritike, veprat e trashëgimisë natyrore etj. Lidhur me zona e mbrojtura, ñNë zonat e prekura nga tërmeti, ka 352 monumente që përfaqësojnë rreth 16 % të totalit në Shqipëria dhe 41 zona të mbrojtura që përfaqësojnë rreth 20 % të totalit kombëtar. Dy monumente brenda ky rajon përfshihet në listën e Provave të UNESCO-s (Amfiteatri i Durrësit dhe Kalaja e Bashtovës). Në total prej 111 monumenteve u inspektuan në zonën e prekur nga tërmeti nga Instituti i Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore nën koordinimin e Ministrisë së Kulturës. Nga ato të inspektuara, 23 monumente u klasifikuan si me rrezik të lartë, dhe 30 monumentet u klasifikuan si të mesme rreziku pjesa tjetër me risk të ulët. Kështjella e Durrësit, Kalaja e Krujës dhe Kalaja e Prezës janë ndër më të dëmtuarat në monumentet e kulturës.ò fq.49-50. I njëjti informacion jepet edhe në Volumi B të PDNA-së, fq.63-64.

*dh) vlerën e dëmeve të shkaktuara, për aq sa është e mundur:*

***Edukimi:*** Vlera totale e dëmit dhe humbjeve në sektorin e arsimit vlerësohet në 72.35 milion ú (8.9 miliardë lekë). Nga kjo, vlera e dëmit është 63.59 milion ú (7.8 miliardë lekë), ndërsa humbjet janë 8.76 milion ú (1.1 miliard lekë). Nevojat totale për rindërtim dhe rikuperim vlerësohen të jenë 94.83 milion ú (11.67 miliardë lekë).

***Shëndeti:*** Efektet totale vlerësohen në 9.93 milion ú (1.22 miliardë lekë). Humbjet e raportuara arrijnë në 1.91 milion ú (235.03 milion lekë) dhe lidhen kryesisht me shërbimet mjekësore falas gjatë periudhës së urgjencës. Rimëkëmbja që konsideron rehabilitimin e

objekteve pjesërisht ose të dëmtuara rëndë, si dhe masat e uljes së rrezikut dhe rezistencës vlerësohet në 14.54 milion ú.
***Strehimi:*** Efektet totale vlerësohen në 696.3 milion ú (85.68 miliardë lekë), ndërsa rimëkëmbja dhe rindërtimi vlerësohen në 803 milion ú (99.301 milion Lekë) për një periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.
***Infrastruktura:*** Nga dëmi dhe humbja totale në këtë sektor, e cila arrin në 33.42 milion ú (4.11 miliardë lekë), një e treta ishte në komunën e Durrësit. Nevojat e përgjithshme për rindërtim dhe rimëkëmbje u vlerësuan në 60.99 milion ú (7.5 miliardë lekë).
***Prodhuese:*** Efektet totale të vlerësuara për sektorin janë 150.48 milion ú. Nevojat për rimëkëmbje në këtë sektor është në shumën prej 51.83 milion ú (6.4 miliardë lekë), mbi gjysma është në nën-sektorin e biznesit dhe punësimit me 27.84 milion ú (3.4 miliardë lekë), ndjekur nga turizmi me 10.88 milion ú (1.3 miliard lekë).
***Mbrojtja Sociale:*** Dëmet e nuk raportohen në këtë sektor, pasi përfshihet në sektorët më lartë. Totali i nevojave të sektorit vlerësohen në 2.83 milion ú (348.2 milion Lekë).
***Mbrojtja Civile dhe Reduktimi i Rrezikut nga Katastrofat:*** Dëmet u vlerësuan 8.75 milion ú (1,076 milion lekë) dhe 13,21 milion ú (1,625 milion lekë) për humbjet. Nevojat totale për rindërtimi dhe rikuperimi i sektorit u vlerësua në 48.25 milion ú (5.9 miliardë lekë).

**Dëmet dhe Humbjet totale:**
Sipas PDNA Volumi A efekti total i katastrofës në 11 bashki arrin në 985.1 milion ú (121.21 miliardë lekë), nga të cilat 843.9 milion ú (103.84 miliard lekë) përfaqësojnë vlerën e aseteve fizike të shkatërruara dhe 141.2 milion ú (17.37 miliardë lekë) ) i referohen humbjeve.

*Tabela nr.4* Dëmet dhe humbjet në vlerë dhe përqindje, sipas sektorëve

| ***Sektorët*** | ***Nënsektorë*** | ***Dëmet (mln €)*** | ***Dëmi (%)*** | ***Humbje (mln €)*** | ***Efekti Total (mln €)*** | ***Efekti (%)*** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shëndeti | | 8.02 | 1% | 1.91 | 9.93 | 1% |
| Arsimi | | 63.59 | 8% | 8.76 | 72.35 | 7% |
| Strehimi | | 662.3 | 78% | 34 | 696.3 | 71% |
| Prodhimi | | 70.82 | 8% | 79.66 | 150.48 | 15% |
| | *Biznesi dhe punësimi* | *47.48* | | *5.47* | *52.95* | |
| | *Turizmi* | *16.71* | | *73.53* | *90.24* | |
| | *Trashëgimi Kulturore* | *5.31* | | *0.44* | *5.75* | |
| | *Agrikultura* | *1.32* | | *0.22* | *1.54* | |
| Infrastruktura | | 30.41 | 4% | 3.01 | 33.42 | 3% |
| | *Infrastruktura e Komunitetit* | *6.06* | | *0.16* | *6.22* | |
| | *Rrugët* | *4.83* | | *0.43* | *5.26* | |
| | *Uji dhe Kanalizimi* | *0.35* | | *0* | *0.35* | |
| | *Komunikimi* | *0.92* | | *0.16* | *1.08* | |
| | *Ndërtesat Publike* | *10.07* | | *2.26* | *12.33* | |
| | *Energjia* | *8.18* | | *0* | *8.18* | |
| Mbrojtja Sociale | | 0 | 0% | 0.62 | 0.62 | 0% |
| Mbrojtja Civile | | 8.75 | 1% | 13.22 | 21.97 | 2% |
| ***Total*** | | ***843.89*** | ***100%*** | ***141.18*** | ***985.07*** | ***100%*** |

*Burimi:* PDNA volumi A, shkurt 2020, fq.8

Shumica e dëmeve regjistrohen në sektorin e Strehimit (78 %), ndjekur nga sektori Prodhues (8 %) dhe sektori i Arsimit (8 %). ñLidhur me pronësinë e efekteve, në përgjithësi 76.5% janë private dhe 23.5% publike. Sektorët e Strehimit dhe Prodhimit përbëjnë kryesisht infrastrukturë private, ndërsa sektorët e tjerë të mbetur janë kryesisht në pronësi publike.ò I

njëjti model zbatohet edhe për humbjet. Në lidhje me shpërndarjen gjeografike të dëmit dhe humbjes, bashkia e Durrësit ishte më shumë e prekur me 303.8 milion ú (3.74 miliardë lekë) ose 32.4% të dëmit dhe humbjes totale, ndjekur nga bashkia Tiranë me 284.3 milion ú (3.5 miliardë lekë) ose 30%, dhe së treti Kruja me 84.2 milion ú (1.04 miliardë lekë) ose 9%.

*Tabela nr. 5* Dëmet dhe humbjet, sipas bashkive

*(Në milion Euro)*

| *Bashkia* | *Arsimi* | *Shëndeti* | *Strehimi* | *Infrastruktura* | *Prodhimi* | *Mbrojtja sociale* | *Mbrojtja civile* | *Total* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Durrës | 9.75 | 1.5 | 220.78 | 8.95 | 65.15 | 0.06 | 4 | 310.19 |
| Shijak | 2.4 | 0.11 | 52.91 | 1.84 | 5.36 | 0.06 | 2.3 | 64.98 |
| Kruja | 5.04 | 0.34 | 73.01 | 0.53 | 5.67 | 0.06 | 1.5 | 86.15 |
| Lezha | 2.91 | 0.27 | 22.18 | 1.38 | 6.83 | 0.06 | 2 | 35.63 |
| Mirdita | | | 4.42 | 0.8 | 0.75 | 0.06 | 0.7 | 6.73 |
| Kurbin | 4 | 5.56 | 25.39 | 2.32 | 0.05 | 0.06 | 2.4 | 39.78 |
| Tirana | 46.06 | 2.13 | 214.33 | 15.56 | 21.91 | 0.06 | 3.4 | 303.45 |
| Kamza | 0.06 | | 14.49 | 0.49 | 1.25 | 0.06 | 1.82 | 18.17 |
| Vora | 1.18 | 0.02 | 40.16 | 1 | 5.59 | 0.06 | 1.8 | 49.81 |
| Kavaja | 0.93 | | 28.62 | 0.5 | 37.79 | 0.06 | 1.3 | 69.2 |
| Rrogozhina | | | | 0.05 | 0.14 | 0.02 | 0.75 | 0.96 |
| Total mln ú | *72.33* | *9.93* | *696.29* | *33.42* | *150.49* | *0.62* | *21.97* | *985.05* |

*Burimi:* PDNA volumi A, shkurt 2020, fq.8

*f) masat që rekomandohen të merren në kuadër të programeve të procesit të rindërtimit dhe buxhetet e përafërta, nëse ka:*
Referuar PDNA volumi A, nevojat totale për rimëkëmbje nga tërmeti i nëntorit janë 1,076.15 milion euro (132.4 miliardë lekë) në të gjithë sektorët dhe për 11 bashkitë e prekura.
Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat mbi nevojat, të ndara në afatshkurtë, afatmesëm dhe afatgjatë, sipas sektorëve dhe nënsektorëve, paraqiten si mëposhtë :

*Tabela nr. 6* Të dhënat mbi nevojat, të ndara sipas afateve

*(Në milion euro)*

| Sektoret | Nënsektorët | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë | Total |
|---|---|---|---|---|---|
| Shëndeti | | 9.77 | 4.77 | 0.01 | 14.55 |
| Arsimi | | 53.99 | 39.38 | 1.46 | 94.83 |
| Strehimi | | 430.51 | 371.85 | 0.5 | 802.86 |
| Produktiviteti | | 18.6 | 21.29 | 11.93 | 51.82 |
| | Biznesi dhe punësimi | 10 | 13.80 | 4.05 | 27.85 |
| | Turizmi | 5.95 | 2.99 | 1.93 | 10.87 |
| | Trashëgimi Kulturore | 0.79 | 2.77 | 3.84 | 7.40 |
| | Agrikultura | 1.86 | 1.73 | 2.11 | 5.70 |
| Infrastruktura | | 7.51 | 38.42 | 15.07 | 61.00 |
| | Infrastruktura e Komunitetit | 1.03 | 6.32 | 3.16 | 10.51 |
| | Rrugët | 2.71 | 9.56 | 0.63 | 12.90 |
| | Uji dhe Kanalizimi | 2.66 | 15.93 | 7.97 | 26.56 |
| | Komunikimi | 0.26 | 1.55 | 0.78 | 2.59 |
| | Ndërtesat Publike | 0.75 | 4.48 | 2.24 | 7.47 |
| | Energjia | 0.1 | 0.58 | 0.29 | 0.97 |
| Mbrojtja Sociale | | 1.19 | 0.96 | 0.69 | 2.84 |
| Mbrojtja Civile | | 23.91 | 22.94 | 1.4 | 48.25 |
| *Total* | | *544.29* | *499.61* | *31.06* | *1074.96* |

Burimi: PDNA volumi A, shkurt 2020, fq.10

Në faqen 11 të PDNA volumi A, janë përcaktuar konkluzionet dhe rekomandimet për rimëkëmbjen nga tërmeti, si mposhtë:

ñMundësitë për të financuar rimëkëmbjen janë rialokimet buxhetore, zotimet e donatorëve, huatë ose grantet nga agjencitë shumëpalëshe dhe bilaterale, dhe/ose kontributet nga sektori privat. Strategjia e rimëkëmbjes bazohet në qasjen e orientuar drejt qëndrueshmërisë ñBuild Back Betterò -BBB. Ndërhyrjet BBB kanë për qëllim të forcojnë menaxhimin e rrezikut nga katastrofat, të zvogëlojnë rreziqet dhe dobësitë për katastrofa të mundshme në të ardhmen, si dhe për të katalizuar ekonominë e për të rindërtuar jetesën, etj. Fokusi i shtuar duhet të vendoset në:

- Përdorimin e teknologjive të eficiencës së energjisë në procesin e rindërtimit;
- Menaxhimi i sigurt, i shëndoshë dhe miqësor me mjedisin, i mbetjeve të ngurta dhe të rrezikshme;
- Riciklimi - për aq sa është e mundur - i sasisë së madhe të mbeturinave dhe rrënojave;
- Përdorimi i materialeve të ndërtimit miqësore me mjedisin;
- Shmangia e ndikimeve të mundshme negative në mjedis;
- Përcaktimi i përparësive të barazisë gjinore dhe trajtimit jodiskriminues pasi ato gjenerojnë prosperitet tërësor dhe nuk janë vetëm një faktor i barazisë.ò

Në PDNA vol b, janë parashikuar plane sektoriale të rimëkëmbjes.

Nga auditimi rezultoi se, efekti total i katastrofës së shkaktuar nga tërmeti i nëntorit 2019 në 11 bashki në Republikën e Shiqipërisë arrin në vlerën 985.1 milion ú (121.21 miliardë lekë), nga të cilat 843.9 milion ú (103.84 miliard lekë) përfaqësojnë vlerën e aseteve fizike të shkatërruara dhe 141.2 milion ú (17.37 miliardë lekë) i referohen humbjeve. Ndërsa, nevojat totale për rimëkëmbje nga tërmeti i nëntorit janë përllogaritur në vlerën 1,076.15 milion euro (132.4 miliardë lekë) në të gjithë sektorët dhe për 11 bashkitë e prekura. *Nga analizimi i PDNA volumi A dhe B, rezulton se në përllogaritjen e nevojave totale për rimëkëmbje nga tërmet është marrë në konsideratë dëmi i shkaktuar nga tërmeti dhe humbjet.*
Me e-mailin e datës, 21.07.2021, drejtuar Sekretariatit të KSHR, grupi i auditimit kërkoi informacion mbi çfarë përfaqësojnë përkatesisht dëmi dhe humbjet, të përllogaritura në PDNA, si dhe, a ka një përkufizim për këto terma, apo metodologji të përdorur për përllogaritjen e tyre. Me e-mailin e datë 28.07.2021, Sekretariati KSHR përcolli këtë përgjigje, ñSjellim në vëmendje se nuk ka një definicion apo përkufizim eksplicid të parashikuar në Aktin Normativ nr 9, datë 16.12.2019 , në lidhje me termin ñdëmi i llogariturò dhe ñhumbjet e llogaritura ò , por për analogji juridike sqarojmë se në ligjin nr. 45/2019 ñPër mbrojtjen civileò, i cili është një akt i përafruar edhe me direktivat e BE, për këtë fushë, në pikën 13 të nenin 3 është dhënë definicioni i përkufizimit ñImpakti e fatkeqësisëò i cili y shty efekti total, duke përfshirë efektet negative (p.sh. humbjet ekonomike) dhe efektet pozitive (p.sh. fitimet ekonomike), të një ngjarjeje të rrezikshme ose të një fatkeqësie. Termi përfshin impaktet ekonomike, njerëzore e mjedisore dhe mund të përfshijë vdekje, plagosje, sëmundje e efekte të tjera negative për shëndetin fizik, mendor dhe mirëqenien sociale të njeriutò.
Konstatim: Nga auditimi rezultoi se nuk ka një dokument ñProgrami i Përgjithshëm i Rindërtimitò të miratuar nga KSHR, sipas përcaktimit në pikën 2, të Kreut III të VKM 878, datë 24.12.2019, dhe përcjellë në Këshillin e Ministrave, sipas përcaktimit në shkronjën a të pikës 4, të Nenit 14 të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019. Në gjykimin e subjektit nën auditim, programi i përgjithshëm i rindërtimit përbëhet nga dokumentet PDNA volumi A dhe B hartuar nga strukturat e specializuara të ekspertëve të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Kombeve të Bashkuara, me koordinimin dhe bashkëpunimin e Qeverise Shqiptare dhe vendimet e KSHR të miratuara rast pas rasti dhe pasuar me miratimin nga Këshilli i Ministrave.

| | |
|---|---|
| **1. Titulli i gjetjes:** | KSHR nuk rezulton të ketë të dokumentuar hartimin, miratimin dhe përcjelljen për miratim në Këshillin e Ministrave të Programit të |

| | |
|---|---|
| | përgjithshëm të rindërtimit, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor. |
| | ***1.1*** Komisioni Shtetëror i Rindërtimit është krijuar me VKM nr. 878, datë 24.12.2019 ñPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò, si një organ ndërministror dhe ka si qëllim kryesor bashkërendimin e punës së ministrive, institucioneve të tjera përgjegjëse, si dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, të ngarkuara nga akti normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, për të gjitha veprimtaritë që lidhen me dhe që ndikojnë në përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.<br>Referuar pikës 1, Kreu II i VKM nr. 878, datë 24.12.2019, KSHR është organ kolegjial që kryesohet nga ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe ka në përbërje këta anëtarë:<br>a) Ministrin e Mbrojtjes;<br>b) Ministrin e Brendshëm;<br>c) Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;<br>ç) Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;<br>d) Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;<br>dh) Ministrin e Kulturës;<br>e) Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;<br>ë) Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;<br>f) Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;<br>g) Kryetarin e Bashkisë Tiranë, me kërkesë të tij.<br>Ndër kompetencat kryesore të KSHR është hartimi dhe miratimi Programit të përgjithshëm të rindërtimit, mbi të cilin mbështetet procesi i rindërtimit.<br>Referuar pikës 1 dhe 2, të Kreut III të VKM nr. 878 datë 24.12.2019, Programi i përgjithshëm i rindërtimit hartohet dhe miratohet nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, brenda **2** muajve nga shpallja e tij. Në germën ñaò të pikës 4, të nenit 14 të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 përcaktohet se, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit harton dhe i propozon Këshillit të Ministrave programin e përgjithshëm të rindërtimit.<br>Në pikën 5 të nenit 14 të Aktit Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 përcaktohet se, Programi i Përgjithshëm i Rindërtimit përmban të paktën të dhëna:<br>a) personat që kanë humbur jetën nga fatkeqësia;<br>b) familjet e mbetura të pastreha ose të dëmtuara, të renditura sipas kritereve të përparësisë që parashikohen në këtë ligj;<br>c) ndërtesat e dëmtuara dhe të rrezikuara, të ndara në publike dhe private;<br>ç) kushtet dhe kriteret e përfitimit në përputhje me programet e procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të këtij akti;<br>d) objektet e infrastrukturës publike dhe kritike, si dhe veprat e trashëgimisë kulturore, zonat e mbrojtura dhe burimet natyrore të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore;<br>dh) vlerën e dëmeve të shkaktuara, për aq sa është e mundur;<br>h) masat që rekomandohen të merren në kuadër, të programeve të procesit të rindërtimit dhe buxhetet e përafërta, nëse ka.<br>Nga komunikimi me Sekretariatin e KSHR (struktura mbështetëse e KSHR)[4] grupit të auditimit iu bë me dije se, Programi i përgjithshëm i rindërtimit, për tërmetin e nëntorit të vitit 2019, përbëhet nga:<br>- PDNA[5] (Vlerësimi i nevojave pas tërmetit) volumi A dhe B hartuar nga |

[4] Pika 16, Kreu II, VKM nr. 878 datë 24.12.2019.

ekspertë të Bashkimit Evropian, Bankës Botërore dhe Kombeve të Bashkuara, me koordinimin dhe bashkëpunimin e Qeverise Shqiptare, publikuar në shkurt të vitit 2020,

- Vendimet e KSHR-së, dhe
- VKM-të që miratojnë vendimet e KSHR-së.

***PDNA është dokumenti i vlerësimit të nevojave të tërmetit të nëntorit 2019, i hartuar dhe publikuar nga ekspertë të huaj, dokument i cili, nuk është miratuar nga KSHR, apo përcjellë për miratim në KM, si program i përgjithshëm i rindërtimit. Vendimmarrjet e KSHR dhe miratimi i tyre nga KM, janë aktivitete të parashikuara në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të cilat kryen krahas hartimit dhe miratimit të Programit të përgjithshëm të rindërtimit. Nga analizimi i dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk rezulton i dokumentuar hartim dhe miratimi i Programit të përgjithshëm të rindërtimit nga KSHR, dhe më pas përcjellja e tij për miratim në KM, sipas parashikimeve në pikat 1 dhe 2 të Kreut III të VKM nr. 878 datë 24.12.2019 dhe germën "a" të pikës 4, të nenit 14 të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019.***

***1.2*** Referuar pikë 2, të nenit 29, të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 pjesë e programit të rindërtimit janë edhe programet sociale të çdo ministrie linjë, të miratuara me udhëzim të ministrit përkatës brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e aktit normativ nr. 9. Referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 31 të Aktit normativ nr. 9, pjesë e Programit të Përgjithshëm të Rindërtimit janë edhe:

Planet e masave për rikuperimin, mbrojtjen dhe parandalimin e dëmeve eventuale në fushën e mjedisit, turizmit dhe kulturës.

Planet e rikuperimit dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor,

të miratuara me udhëzime të ministrave respektiv, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e Aktit normativ nr. 9.

Në dokumentin e Vlerësimit të nevojave të nëntorit 2019, PDNA volumi B, janë paraqitur strategjitë sektoriale të rikuperimit, pjesë e të cilave janë edhe planet e rikuperimit. Sipas PDNA vol A (fq.10) dhe volumi B (në kapitullin përkatës të çdo sektori paraqitur të dhënat përkatëse), nevojat për rikonstruksionin dhe rikuperimin paraqiten si mposhtë:

*(Në milion euro)*

| Sektorët | Nënsektorët | Afatshkurtër | Afatmesëm | Afatgjatë | Total |
|---|---|---|---|---|---|
| Shëndeti | | 9.77 | 4.77 | 0.01 | 14.55 |
| Arsimi | | 53.99 | 39.38 | 1.46 | 94.83 |
| Strehimi | | 430.51 | 371.85 | 0.5 | 802.86 |
| Produktiviteti | | 18.6 | 21.29 | 11.93 | 51.82 |
| | Biznesi dhe punësimi | 10 | 13.80 | 4.05 | 27.85 |
| | Turizmi | 5.95 | 2.99 | 1.93 | 10.87 |
| | Trashëgimi Kulturore | 0.79 | 2.77 | 3.84 | 7.40 |
| | Agrikultura | 1.86 | 1.73 | 2.11 | 5.70 |
| Infrastruktura | | 7.51 | 38.42 | 15.07 | 61.00 |
| | Infrastruktura e | 1.03 | 6.32 | 3.16 | 10.51 |

[5] Albania Post-Disaster Needs Assessment

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Komunitetit | | | | |
| | Rrugët | 2.71 | 9.56 | 0.63 | 12.90 |
| | Uji dhe Kanalizimi | 2.66 | 15.93 | 7.97 | 26.56 |
| | Komunikimi | 0.26 | 1.55 | 0.78 | 2.59 |
| | Ndërtesat Publike | 0.75 | 4.48 | 2.24 | 7.47 |
| | Energjia | 0.1 | 0.58 | 0.29 | 0.97 |
| Mbrojtja Sociale | | 1.19 | 0.96 | 0.69 | 2.84 |
| Mbrojtja Civile | | 23.91 | 22.94 | 1.4 | 48.25 |
| *Total* | | *544.29* | *499.61* | *31.06* | *1074. 96* |

Referua PDNA volumi B (fq.17), për identifikimin e nevojave janë marrë në konsideratë humbjet e përllogaritura (sikurse është trajtuar më lartë, efekti total i tërmetit të nëntorit 2019 ishte 985.07 milion euro, prej të cilave 843.89 milion euro dëmi dhe 141.18 milion euro humbje).

***Nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk rezulton të jetë e dokumentuar përfshirja në Programin e Përgjithshëm të Rindërtimit e programeve sociale të pas tërmetit të çdo ministrie linjë, planeve të masave për rikuperimin, mbrojtjen dhe parandalimin e dëmeve eventuale në fushën e mjedisit, turizmit dhe kulturës dhe planeve të rikuperimit dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor, të miratuara (secili prej planeve) me udhëzime të ministrave respektiv, në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 29 dhe pikës 1 & 2 të nenit 31 të Aktit normativ nr. 9. Nga analizimi i dokumentacionit, si dhe komunikimi me Sekretariatin e KSHR nuk sigurohet qartësi se çfarë përfaqësojnë humbjet e përllogaritura të tërmetit të nëntorit 2019, mbi të cilin janë përllogaritur nevojat (fonde) për strategjinë e rikuperimit nga tërmeti, në PDNA.***

| | |
|---|---|
| **Kriteri:** | - Aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò.<br>VKM nr. 878, datë 24.12.2019, ñPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të komisionit shtetëror të rindërtimitò |
| **Ndikimi:** | Mungesa hartimit dhe miratimit të programit të përgjithshëm të rindërtimit, nuk siguron një planifikim efektiv çka shkakton zgjatjen e periudhës së rehabilitimit, nuk evidenton përgjegjësinë, ul transparencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve për këtë qëllim etj. |
| **Shkaku** | Mungesa e një konceptimi të qartë të çështjes së programeve të procesit të rindërtimit, mungesa e përvojës në menaxhimin e situatave të tilla, si dhe situata komplekëse në kushtet e emergjencës civile kombëtare. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **1.1 Rekomandimi:** | KSHR të marrë masat e nevojshme për hartimin, miratimin dhe përcjelljen për miratim në KM të Programit të përgjithshëm të rindërtimit, si dhe dokumentimin e këtij procesi, me qëllim rritje e efektivitetit të përdorimit të fondeve të tërmetit të nëntorit 2019. |
| **1.2 Rekomandimi:** | KSHR të marr masat e nevojshme për përfshirjen në Programin e përgjithshëm të rindërtimit, të programeve sociale të çdo ministrie linje, planeve të masave për rikuperimin, mbrojtjen dhe parandalimin e dëmeve eventuale në fushën e mjedisit, turizmit dhe kulturës dhe planeve të rikuperimit dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor, me qëllim sigurimin e planifikimit efektiv të procesit të rindërtimit. |

| 1.3 Rekomandimi : | KSHR të ndërmarrë masat e nevojshme që në Programin e përgjithshëm te rindërtimit, të jenë të mirëpërcaktuara përkufizimet dhe mënyrat e përllogaritjes së dëmet të shkaktuara dhe humbjet e shkaktuara nga tërmeti i nëntorit 2019, me qëllim ofrimin e sigurisë në përllogaritjen e nevojave për realizimin e planeve të rimëkëmbjes pas tërmetit. |
|---|---|

**b) Bashkërendon veprimtarinë e institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, përfshirë dhe donatorët, në përputhje me programin e përgjithshëm të rindërtimit, si dhe me procesin e rindërtimit;**

Sikurse është trajtuar edhe në vijim, KSHR për periudhën nën auditim, ka miratuar 87 vendime mbi bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore, subjekteve private dhe donatorëve me qëllim përballimin e fatkeqësisë natyrore.

**c) Në konsultim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e zonave të reja për zhvillim;**

Lidhur me këtë kompetencë të KSHR, të dhënat për zonat e reja paraqiten në tabelën e mëposhtme:

*Tabela nr. 7* Të dhënat mbi shpalljen e zonave të reja për zhvillim

| *Vendimi i KSHR* | *Bashkia* | *Zona e re e shpallur* | *Te dhena mbi zonen** | *Komente*** |
|---|---|---|---|---|
| KSHR Nr. 2 | Kurbin | Lac 1/1 | | |
| | Krujë | Njësia Administrative Thumanë, bashkia Krujë | ndërtimin e banesave për 440 familje, sipas strukturës: 1-2 anëtarë: 38 familje në njësi individuale dhe 67 në banesa kolekëtive; - 3-4 anëtarë: 86 familje në njësi individuale dhe 115 në banesa kolekëtive; 4+ anëtarë: 86 familje në njësi individuale dhe 48 në banesa kolekëtive. | |
| | Shijak | Njësia Administrative Shijak, bashkia Shijak | ndërtimin e banesave për 1,142 familje, sipas strukturës: 1-2 anëtarë: 27 familje në njësi individuale dhe 540 në banesa kolekëtive; - 3-4 anëtarë: 68 familje në njësi individuale dhe 149 në banesa kolekëtive; 4+ anëtarë: 61 familje në njësi individuale dhe 297 në banesa kolekëtive. | |
| KSHR Nr. 3 | Kurbin | Lac 1/2, bashkia Kurbin | 145+ familje: 40 familje: 1-2 anëtarë<br>65 familje: 3-4 anëtarë<br>40 familje: mbi 4 anëtarë<br>50 njësi shërbimi<br>parkime (nëntokë) | |
| | Krujë | Bubq Zona 1, Krujë | 141+ familje:<br>Në banesa kolekëtive: min. 15 familje<br>8 familje: 1-2 anëtarë<br>5 familje: 3-4 anëtarë<br>2 familje: mbi 4 anëtarë<br>Në banesa individuale: min. 126 familje<br>15 familje: 1-2 anëtarë<br>49 familje: 3-4 anëtarë<br>62 familje: mbi 4 anëtar | |
| | | Fushë Krujë Zona 1, bashkia Krujë | 218 + familje:<br>Në banesa kolekëtive: min. 71 familje<br>19 familje: 1-2 anëtarë<br>35 familje: 3-4 anëtarë<br>17 familje: mbi 4 anëtarë<br>njësi shërbimi + parkime (nëntokë)<br>Në banesa kolekëtive: min. 147 familje<br>17 familje: 1-2 anëtarë<br>57 familje: 3-4 anëtarë<br>73 familje: mbi 4 anëtarë | Ndryshon me KSHR Nr.63 Nr. Apartamenteve : 120 apartamente<br>a) 32 apartamente 1+1<br>b) 64 apartamente 2+1<br>c) 24 apartamente 3+1 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Zona 1, bashkia Vorë | 358+ familje:<br>117 familje: 1-2 anëtarë<br>178 familje: 3-4 anëtarë<br>106 familje: mbi 4 anëtarë<br>***propozohet që edhe 50 familjet e dëmtuara në banesa individuale, të akomodohen në banesa kolekëtive. | Ndryshon me KSHR Nr.63 Nr. Apartamenteve : 120 apartamente<br>a) 32 apartamente 1+1<br>b) 64 apartamente 2+1<br>c) 24 apartamente 3+1 Ndryshojnë koordinatat e ZRZH me KSHR Nr. 84, duke përfshirë koordinatat e zonës si edhe koordinatat e nënzonave të cilat<br>nuk do të preken nga zhvillimi i detyruar |
| | Durrës | UMB, Zona 1, bashkia Durrës | Kapaciteti mbajtës: 2,250 familje | Shfuqizuar me KSHR Nr. 78 dhe VKM Nr. 147, datë 10.3.2021 |
| | Kavajë | Zona 1, bashkia Kavajë | 317+ familje:<br>83 familje: 1-2 anëtarë<br>207 familje: 3-4 anëtarë<br>27 familje: mbi 4 anëtarë<br>*propozohet që edhe 53 familjet e dëmtuara në banesa individuale, të akomodohen në banesa<br>kolekëtive. | Ndryshon nevoja për strehim me KSHR Nr. 84 : 1-2 anëtarë 89 familje 3-4 anëtarë - 36 familje Mbi 4 anëtarë 36 familje |
| | Tirane | Zona 4&8,zona 5 Maji, bashkia Tiranë | Kapaciteti mbajtës: 1,500 familje<br>Familjet e pastreha: 830 familje<br>sip. Zone: 21,78 ha<br>sip. Rindërtimi: 12,05 ha, 44,9% | |
| | | UBT | Banesa kolekëtive Kapaciteti mbajtës: 2,068 familje<br>Familjet e pastreha: 220 familje sip. Zone: 60,30 ha sip. Rindërtimi: 6,39 ha, 10,6% - Të miratojë si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, Zona Universiteti Bujqësor i Tiranës , Njësia Administrative11, Bashkia Tiranë, Zonë të Re për Zhvillim | |
| | | Njësia Administrative 6, Zona e Kombinatit, bashkia Tiranë | Banesa kolekëtive Kapaciteti mbajtës: 4,500 familje Familjet e pastreha: 1,190 familje sip. Zone: 71,00 ha sip. Rindërtimi: 18,74 ha, 26,4% | Ndryshojnë koordinatat dhe harta e ZRZH me KSHR Nr. 76, me një sipërfaqe nga 146<br>(njëqind e dyzetë e gjashtë) ha në sipërfaqen 89 ( tetëdhjetë e nëntë) ha |
| | | Njësia Administrative 1, Autotraktori, bashkia Tiranë | Banesa kolekëtive Kapaciteti mbajtës: 780 familje Familjet e pastreha: 350 familje sip. Zone: 24,20 ha sip. Rindërtimi: 10,86 ha, 44,9% | |
| | | Njësia Administrative Baldushk | Banesa individuale Kapaciteti mbajtës i zonës: 20 familje<br>Familjet e pastreha: 115 familje | |
| | | Njësia Administrative Vaqarr | Banesa Individuale Kapaciteti mbajtës i zonës: 27 familje Familjet e pastreha: 87 familje sip. Zone: 0,76 ha | |
| | | Njësia Administrative Zall Herr | Banesa Individuale<br>Kapaciteti mbajtës i zonës: 50 familje Familjet e pastreha: 178 familje Sip. Zone: 3,3 ha Qender administrative Qender komunitare | |
| | | Njësia Administrative Ndroq | Banesa individuale - Kapaciteti mbajtës i zonës: 40 familje Familjet e pastreha: 126 familje sip. Zone: 1,9 ha | |
| | | Njësia Administrative Pezë | Banesa Individuale -<br>Kapaciteti mbajtës i zonës: 30 familje Familjet e pastreha: 167 familje sip. Zone: 1,8 ha -<br>Rruge: 285 m - Ure: 30-35m | Ndryshuar koordinatat dhe harta e ZRZH me KSHR Nr. 61, Rruga, ñ16 Shtatoriò, ñSeletò, K-34-100-(71-C), zk, 2951 njësia strukturore(PE/38)<br>Sip. Zone 1.48 ( një pikë dyzetë e tetë) ha<br>Banesa Individuale<br>Kapaciteti mbajtës I zonës 30 familje<br>Qendër Komunitare<br>HapsRekrative dhe Sportive<br>Rrugë 514 m |
| KSHR Nr. 4 | Lezhë | Zona 1 & 2, Njësia Administrative Lezhë, bashkia Lezhë | Për rindërtimin e, 4 banesave kolekëtive (B2, B3, B5, B71) në ZONËN 1 dhe 7 banesave kolekëtive (B13, B58, G1, G7, G17, G21, G23) në ZONËN 2, mbi sheshet e mëparshme, duke përshtatur kushtet e zhvillimit me qëllim akomodimin e 182+ familjeve. 128 familjet në banesa individuale, do të rindërtohen në sheshet e mëparshme | Ndryshuar nevojat për strehim me KSHR Nr. 64, Nevojat për njësi akomoduese në Zona 1, Zonën e Re për Zhvillim, bashkia<br>Lezhë, bëhen :<br>· 38 Apartamente 1+1<br>· 38 Apartamente 2+1<br>· 20 Apartamente 3+1<br>b) Nevojat për njësi akomoduese në Zona 2, Zonën e Re për Zhvillim, bashkia<br>Lezhë, bëhen<br>· 24 Apartamente 1+1<br>· 40 Apartamente 2+1 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | · 16 Apartamente 3+1 |
| | Krujë | Zona 1 Njësia Administrative Krujë, bashkia Krujë | 186+ familjeve:<br>81+ familje: 1-2 anëtarë<br>73+ familje: 3-4 anëtarë<br>32+ familje: mbi 4 anëtarë me njësi shërbimi dhe parkime (nëntokë) | |
| | Vorë | Zona 1, Njësia Administrative Marikaj, bashkia Vorë | 68+ familjeve:<br>24+ familje: 1-2 anëtarë<br>27+ familje: 3-4 anëtarë<br>17+ familje: mbi 4 anëtarë | |
| | Durrës | Zona 2&3, Njësia Administrative Durrës, bashkia Durrës | | Shfuqizuar me KSHR Nr. 90 dhe VKM Nr. 362, datë 16.6.2021 dhe VKM Nr. 361, datë 16.6.2021 |
| | Kavajë | Zona 1, Njësia Administrative Golem, bashkia Kavajë | Për rindërtimin e banesave kolekëtive në terrenet e dëmtuara, mbi sheshet e mëparshme, duke përshtatur kushtet e zhvillimit me qëllim strehimin e 40 familjeve. | |
| KSHR Nr.5 | Durrës | Zona 4 Njësia Administrative Durrës, bashkia Durrës | Banesa kolekëtive:<br>Kapaciteti mbajtës: për t'u përcaktuar nga Plani i Detyruar Vendor;<br>Familjet e pastreha në Durrës: 2,250 familje; Sip. Zone: 190 ha;<br>Sip. Rindërtimi (prona shtet): 95 ha | |
| | Durrës | Zona Arkeologjike, bashkia Durrës | 4 struktura banimi kolekëtive, DS5 10 struktura banimi kolekëtive,<br>DS4 27 struktura banimi kolekëtive<br>DS3 8 banesa individuale,<br>DS5 21 banesa individuale,<br>DS4 18 banesa individuale,<br>DS3 Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetesor, DS3 Shërbimi Informativ, DS3 | |
| KSHR Nr. 22 | Kamëz | ZRZH Valias, bashkia Kamëz | ndërtimin e 270 njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për akomodimin e familjeve të dëmtuara nga tërmeti në territorin e bashkisë, b. rindërtimin e objekteve arsimore shkollë dhe kopësht, c. ndërtimin e një qendre administrative, d. për rehabilitimin e terreneve sportive dhe hapësirave publike. | Ndryshon me KSHR Nr. 79 |
| | Mirditë | ZRZH Rrëshen, bashkia Mirditë | ndërtimin e 120 njësive individuale të banimit, sipas projekteve model të hartuara nga Enti kombëtar i Banesave, për akomodimin e 120 familjeve të dëmtuara nga tërmeti në territorin e kësaj njësie, b. ndërtimin e një qendre komunitare. | |
| KSHR Nr. 31 | Durrës | ZRZH, Lalëz, Njësia Administrative Ishëm, bashkia Durrës | ndërtimin e 44 njësive individuale të banimit, sipas projekteve model të hartuara nga Enti kombëtar i Banesave, për akomodimin e 44 familjeve të dëmtuara nga tërmeti në territorin e kësaj njësie, b. ndërtimin e një qëndre komunitare. | |
| | Durrës | ZRZH Njësia Administrative Manëz, bashkia Durrës | Ndërtimin e 8 njësive të banimit në ndërtesa (pallat), përkatësisht 224 banesa (1+1-48; 2+1-128; 3+1-48) Ndërtimin e mjediseve te shërbimit (publike dhe tregtare) | |

*Burimi:* Vendimet e KSHR dhe VKM, përpunuar nga Sekretariati i KSHR për grupin e auditimit

Në mënyrë më të detajuar, të dhënat për zonat e reja të shpallura, janë paraqitur në trajtimin që grupi i auditimit ka bërë për vendimet e KSHR, miratuar gjatë periudhës nën auditim.

**ç) Siguron informimin e publikut dhe transparencën mbi procesin e rindërtimit;**

Në faqen zyrtare (https://rindertimi.gov.al/) ñMinistri i Shtetit për Rindërtiminò gjenden vendimet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe VKM e miratuara, me qëllim zhvillimin e procesit të rimëkëmbjes nga tërmeti i nëntorit 2019, ligjet dhe aktet normative të miratuara për këtë qëllim, zonat e reja të shpallura, programet e rindërtimit, etj.

d) **Propozon, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rindërtimin, pranë Këshillit të Ministrave, përdorimin e fondit të rindërtimit nga njësitë zbatuese dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, përcaktimin e njësive zbatuese për projektet në kuadër të procesit të rindërtimit;**
Referuar Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò Kreu IV, neni 18: *Procesi i rindërtimit dhe programet e tij*

1. Procesi i rindërtimit është një proces i integruar zhvillimi i përbërë nga disa programe, në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të shëndetit pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, që përcaktohen në këtë nen.
2. Programi i zhvillimit të objekteve të reja që përbëhet nga këto nënprograme:
    - a) Zhvillimi i objekteve të reja dhe i zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike përkatëse, si dhe rikonstruksioni i ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe të infrastrukturës publike nga autoritetet shtetërore;
    - b) Zhvillimi i objekteve të reja dhe zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike përkatëse, si dhe rikonstruksioni i ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe i infrastrukturës publike, nga autoritetet shtetërore nga donatorët;
    - c) Rindërtimi i ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truallë;
    - ç) Programi i bashkëpunimit për ndërtime në bashkëpunim me sektorin privat.
3. Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike kur nuk është pjesë e programeve të tjera të parashikuara në këtë ligj, dhe të infrastrukturës kritike është programi me anë të të cilit me financim nga fondi i rindërtimit apo nga donatorët ndërtohen ose rikonstruktohen objekte të infrastrukturës publike dhe kritike nga njësitë zbatuese.
4. Programi i krijimit të fondit të banesave përbëhet nga:
    - a) Programi i blerjes së banesave të reja në treg të lirë;
    - b) Programi i banesave të dhuruara nga subjektet private.
5. Programi i granteve të rindërtimit përbëhet nga:
    - a) Granti për rindërtimin ose rikonstruksionin e banesave të dëmtuara;
    - b) Pagesa e qirasë për familjet e mbetura të pastreha nga fatkeqësia natyrore;
    - c) Kompensimi i shpenzimeve të subjekteve të sektorit privat që ofrojnë struktura akomoduese për familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore.
6. Programi i masave të rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike që përbëhet nga këto nënprograme:
    - a) Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësia natyrore;
    - b) Masat për rimëkëmbjen sociale;
    - c) Masat për rimëkëmbjen ekonomike;
    - ç) Masat rikuperuese dhe parandaluese.

**Viti 2020**
*A) Ndryshimet e buxhetit për rindërtimin.*
ÅReferuar nenit 7 të ligjit Nr.88/2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò: Fondi i Rindërtimit prej 20 miliardë lekë, i cili përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, përbëhet nga:
- Grante 7 miliardë lekë;
- Shpenzime të buxhetit të shtetit 13 miliardë lekë.

ÅReferuar nenit 2 të Aktit Nr. 28 datë 02.07.2020, ñPër disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 ñPër Buxhetin e Vitit 2020ò, të ndryshuar:
Fondi i Rindertimit ndryshohet dhe bëhet ñ... 34 miliardë lekë...ò si vijon:

- Grante 3 miliardë lekë.
- Shpenzime të buxhetit të shtetit 31 miliardë lekë.ò.

ÅReferuar nenit 7 të Aktit Normativ nr. 34, datë 16.12.2020 ñPër disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 ñPër Buxhetin e Vitit 2020ò, të ndryshuarñ

Fondi i Rindërtimit ndryshohet dhe bëhet ñ... 32 miliardë lekësh...ò si më poshtë:

- Grante 3 miliardë lekë.
- Shpenzime të buxhetit të shtetit 29 miliardë lekë.

*B) Detajimi i buxhetit për vitin 2020:*

Për ñProgramin e Zhvillimit të Objekteve të Rejaò, janë alokuar fonde në masën 14,692,006,123 lekë prej të cilave 14,148,335,190.32 lekë nga buxheti i shteti dhe 543,670,932.68 lekë donacione (të derdhura në buxhetin e shtetit). Në total angazhimet e këtij programi janë miratuar me 26 vendime të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe 29 VKM.

*Tabela nr. 8* Programi i zhvillimit të objekteve të reja

| *Njësia Zbatuese* | *Buxheti i shtetit* | *Donacione që kanë kaluar nga B.SH* | *Total (në lekë)* |
|---|---|---|---|
| *FSHZH* | 8,544,129,482.76 | | 8,544,129,483 |
| *ABP* | | 55,000,000.00 | 55,000,000 |
| *AKTP* | 137,420,000.00 | | 137,420,000 |
| *Bashkia Durrës* | 409,081,016.00 | | 409,081,016 |
| *Bashkia Kamëz* | | 19,323,960.00 | 19,323,960 |
| *Bashkia Kavajë* | | 43,000,000.00 | 43,000,000 |
| *Bashkia Krujë* | 297,475,175.50 | 72,377,718.40 | 369,852,894 |
| *Bashkia Kurbin* | 321,697,219.60 | 296,969,254.28 | 618,666,474 |
| *Bashkia Lezhë* | 170,240,659.00 | 57,000,000.00 | 227,240,659 |
| *Bashkia Tiranë* | 3,986,774,979.46 | | 3,986,774,979 |
| *Enti I banesave* | 44,889,589.00 | | 44,889,589 |
| *IKTK* | 236,627,069.00 | | 236,627,069 |
| *Total* | *14,148,335,190.32* | *543,670,932.68* | *14,692,006,123* |

*Burimi:* Sekretariati KSHR, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Për Programin e Zhvillimit të Objekteve të Reja dhe nënprogramet e tij, janë alokuar ***14,692,006,123 lekë*** nga Fondi i Rindërtimit, detajuar si më poshtë:

- Banesa Individuale (rindërtim i banesave individuale dhe ndërtim apo rikonstruksion i infrastrukturës në lidhje me këto banesa, brenda dhe jashtë Zonat e Reja për Zhvillim) - KSHR Nr. 42, -VKM Nr. 759, dt. 23.09.2020 dhe VKM Nr. 643, dt. 03.08.2020, në masën 3,757,881,137 lekë, me Njësi Zbatuese FSHZH(2,492,978,390 lekë) dhe Bashkinë Tiranë (1,264,902,747 lekë).
- Rindërtimi i Njësive të banimit në ndërtesa (pallat) / Banesa Kolekëtive (Zonat e Reja për Zhvillim) ï KSHR Nr. 38, - VKM Nr.588 dt.22.07.2020 dhe KSHR Nr. 60, - VKM Nr. 587 dt. 22.7.2020, në masën 1,925,444,214 lekë, me njësi Zbatuese FSHZH.
- Rindërtim i banesave kolekëtive dhe ndërtesave Publike, në masën1,136,002,934 lekë në Zonat e Reja për Zhvillimï KSHR Nr. 41 & 42, VKM Nr. 645 dt. 3.8.2020, me njësi Zbatuese Bashkinë Tiranë.
- Objektet Arsimore (në Zonat e Reja dhe Rindërtim në të njëjtin Truall), në masën 5,748,503,509.82 lekë, me njësi Zbatuese:
  - FSHZH- 4,125,706,878.76 lekë me KSHR Nr. 38, VKM Nr. 212 dt.11.03.2020
  - Bashkia Tiranë ï 1,326,264,954.46 lekë me KSHR Nr. 40, VKM Nr. 212 dt.11.03.2020 dhe KSHR Nr. 68, VKM Nr. 1134 dt. 24.12.2020.

- Bashkia Lezhë- 76,300,000 lekë me KSHR Nr. 58 VKM Nr. 910 dt. 18.11.2020 (donacione të derdhura në buxhet në masën 31,000,000 lekë) dhe KSHR Nr. 66, VKM Nr. 1047 dt. 16.12.2020 (buxheti i shtetit në masën 45,300,000 lekë)
- Bashkia Krujë - 20,629,537 lekë (buxheti I shtetit) me KSHR nr. 67 dhe VKM nr. 1145, dt 24.12.2020
- Bashkia Kurbin - 199,602,139.60 lekëe (buxheti I shtetit) me KSHR nr 53, VKM nr. 828, dt 12.10.2020.

- Institucionet Publike, në masën 422,011,434.28 lekë, me njësi zbatuese:
    - Bashkia Kurbin, në masën 296,969,254.28 lekë (donacion të derdhura në buxhet), me KSHR nr. 53, VKM nr. 887, dt 4.11.2020
    - Bashkia Lezhë, në masën 26,000,000 lekë (donacion i derdhur nbë buxhetin e shtetit), me KSHR nr. 65, VKM nr. 1034, dt 21.12.2020.
    - ABP, në masën 55,000,000 lekë, (donacion i derdhur në buxhetin e shtetit), me KSHR nr 62, VKM 980, dt 2.12.2020
    - Bashkia Krujë, në masën 44,042,180.00 (buxheti i shtetit) KSHR nr 67, VKM nr 1144.
- Shpronësimet, në masën 325,061,641.50 lekë (me buxhet shteti) me njësi zbatuese:
    - EKB, në masën 44,889,589 lekë, me KSHR nr 25, me VKM nr 499, dt 24.06.2020
    - Bashkia Krujë në masën 232,803,458.50 lekë, me KSHR nr. 28, 45 dhe 52, me VKM nr. 528 dt 24.6.2020, nr. 666 dt 27.08.2020, nr. 790 dt 7.10.2020
    - Bashkia Tiranë në masën 47,368,594 lekë, me KSHR nr 57, dt. 10.11.2020

- Trashëgimia kulturore, në masën 236,627,069 lekë (me buxhet shteti), me njësi zbatuese
    - IKTK me KSHR nr 9, VKM nr 213, dt 7.10.2020

- Shembje objektesh dhe transportim i mbeturinave , në masën 306,630,977.40 lekë, me njësi zbatuese:
    - Bashkia Kurbin në masën 65,164,800 lekë (me buxhet shteti) me KSHR nr. 49, VKM nr. 731 dt 16.09.2020
    - Bashkia Durrës në masën 76,455,000 lekë (me buxhet shteti), me KSHR nr. 49, VKM nr. 731 dt 16.09.2020
    - Bashkia Lezhë në masën 49,633,459 lekë (me buxhet shteti), me KSHR nr. 49, VKM nr. 731 dt. 16.09.2020
    - Bashkia Kavajë në masën 43,000,000 lekë (donacion i derdhur në buxhetin e shtetit) me KSHR nr. 50, VKM nr. 977 dt. 2.12.2020
    - Bashkia Krujë në masën 72,377,718.40 lekë (donacion i derdhur në buxhetin e shtetit), me KSHR nr. 61, VKM nr. 977 dt. 2.12.2020
- Hartimi i projekteve, në masën 521,546,206 lekë, me njësi zbatuese:
    - Bashkia Durrës në masën 282,626,016 lekë (me buxhet shteti), me KSHR nr. 35 dhe KSHR nr. 50, VKM nr. 644 dt. 3.8.2020 dhe VKM NR.775 dt.30.09.2020
    - Bashkia Lezhë në masën 75,307,200 lekë (me buxhet shteti), me KSHR nr37 dhe KSHR nr. 69, VKM nr. 644 dt. 3.8.2020 dhe VKM nr. 1136 dt. 24.12.2020
    - Bashkia Tiranë në masën 87,358,750 lekë (me buxhet shteti) me KSHR nr. 43, VKM 650 dt. 13.8.2020
    - Bashkia Kurbin në masën 56,930,280 lekë (me buxhet shteti), me KSHR nr. 43, VKM 650 dt 13.8.2020
    - Bashkia Kamëz në masën 19,323,960 lekë (donacion I derdhur në buxhetin e shtetit), me KSHR nr. 55, VKM nr 979 dt 2.12.2020

- Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore (PDyV), në masën 262,297,000 lekë (me buxhet shteti), me njësi zbatuese:
  - AKPT, në masën 137,420,000 lekë, me VKM nr 9 dt 10.01.2020
  - Bashkia Tiranë, në masën 124,877,000 lekë, me VKM nr 9 dt 10.01.2020
- Hidrovori, Durrës, në masën 50,000,000 lekë, me njësi zbatuese:
  - Bashkia Durrës, në masën 50,000,000 lekë (me buxhet shteti), me KSHR nr 50, me VKM NR.775 dt.30.09.2020

Për ñ*Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike*ò, janë alokuar fonde në masën **2,015,001,438 lekë,** nga buxheti i shtetit, me njësi përfituese FSHZH, Bashkia Tiranë, dhe ARSH, detajuar në tabelën e mëposhtme. Në total angazhimet e këtij programi janë miratuar me 2 vendime të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe 2 VKM.

*Tabela nr. 9* Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike

| *Njësia zbatuese* | *Buxheti i shtetit* | *Donacione që kanë kaluar nga B.SH* | *Total (në lekë)* |
|---|---|---|---|
| FSHZH | 1,363,461,542 | | 1,363,461,542 |
| Bashkia Tiranë | 500,000,000 | | 500,000,000 |
| ARRSh | 151,539,896 | | 151,539,896 |
| Total | 2,015,001,438.00 | - | 2,015,001,438 |

*Burimi:* Sekretariati KSHR, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Për programin ndërtimit të infrastrukturës publike janë alokuar në **total 2,015,001,438 lekë** nga fondi i Rindërtimit, të detajuar si më poshtë:

- Infrastrukturë Publike në masën 1,863,461,542, me njësi zbatuese:
  - FSHZH, në masën 1,363,461,542 lekë (me buxhet shteti), me KSHR nr. 51, VKM Nr. 761 dt.23.09.2020;
  - Bashkia Tiranë, në masën 500,000,000 lekë (me buxhet shteti), me KSHR nr 51, VKM Nr. 761 dt.23.09.2020.
- Vepra arti, në masën 151,539,896 lekë, me njësi zbatuese:
  - ARRSH, në masën 151,539,896 lekë (me buxhet shteti), me KSHR nr. 29, VKM Nr. 525 dt.01.07.2020

➢ Për ñ*Programi i granteve të rindërtimit*ò, janë alokuar fonde në masën **10,944,672,788.38 lekë,** prej të cilave 9,221,905,854.38 lekë nga buxheti i shtetit dhe 1,722,766,934 lekë donacione të derdhura në buxhet, me njësi zbatuese: Bashkia Durrës, Bashkia Kamëz, Bashkia Kavajë, Bashkia Krujë, Bashkia Kurbin, Bashkia Lezhë, Bashkia Mirditë, Bashkia Rrogozhinë, Bashkija Shijak, Bashkia Tiranë, Bashkia Vorë, Ministria e Mjedisit (akomodimi I përkohshëm), detajuar në tabelën e mëposhtme. Në total angazhimet e këtij programi janë miratuar me 21 vendime të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe 16 VKM.

*Tabela nr. 10* Programi i granteve të rindërtimit

| *Njësia Zbatuese* | *Buxheti i shtetit* | *Donacionet që kanë kaluar nga B.SH* | *Total (në lekë)* |
|---|---|---|---|
| Bashkia Durrës | 4,512,190,743 | 128,595,274 | 4,640,786,017 |
| Bashkia Kamëz | | 340,220,000 | 340,220,000 |
| Bashkia Kavajë | 18,250,000 | 385,500,000 | 403,750,000 |
| Bashkia Krujë | 758,850,000 | | 758,850,000 |
| Bashkia Kurbin | 927,544,728 | | 927,544,728 |
| Bashkia Lezhë | 416,689,540 | 398,741,633 | 815,431,173 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bashkia Mirditë | | 29,820,000 | 29,820,000 |
| Bashkia Rrogozhinë | | 110,900,000 | 110,900,000 |
| Bashkija Shijak | 1,155,505,843 | 108,540,027 | 1,264,045,870 |
| Bashkia Tiranë | 1,232,875,000 | | 1,232,875,000 |
| Bashkia Vorë | | 220,450,000 | 220,450,000 |
| Ministria e Mjedisit (akomodimi I përkohshëm) | 200,000,000 | | 200,000,000 |
| *Total* | *9,221,905,854* | *1,722,766,934* | *10,944,672,788* |

*Burimi:* Sekretariati KSHR, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Për Programin e Granteve të Rindërtimit dhe nënprogramet e tij janë 10,944,672,788.38 lekë nga Fondi i Rindërtimit, detajuar si më poshtë:

- Grante Rindërtimi dhe Rikonstruksioni, në masën 10,744,672,788.38 lekë, nga të cilat:
  - 9,021,905,854.38 lekëe nga buxheti i shtetit
  - 1,722,766,934 lekë donacione të derdhura në buxhetin e shtetit
- Akomodim i përkohshëm, në masën 200,000,000 lekë nga buxheti i shtetit

➢ Për ñ*Programi i krijimit të fondit të ndërtesave*ò, janë alokuar fonde nga buxheti i shtetit në masën ***46,872,008.00* lekë,** me njësi zbatuese Bashkinë Kamëz dhe Bashkinë Durrës, detajuar në tabelën e mëposhtme. Në total angazhimet e këtij programi janë miratuar me 2 vendime të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe 2 VKM

*Tabela nr. 11* Programi i krijimit të fondit të ndërtesave

| Njësia Zbatuese | *Buxheti i shtetit* | *Donacione që kanë kaluar nga B.SH* | *Total (në lekë)* |
|---|---|---|---|
| Bashkia Kamëz | 18,263,702.00 | - | 18,263,702.00 |
| Bashkia Durrës | 28,608,306.00 | - | 28,608,306.00 |
| Total | 46,872,008.00 | - | 46,872,008.00 |

*Burimi:* Sekretariati KSHR, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Krijimit të fondit të Banesave i është alokuar fondi në masën **46,872,008 lekë.** Ky program në zbatim të nenit 24 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, për nevoja të strehimit të familjeve të prekura nga fatkeqësia natyrore, Enti Kombëtar i Banesave, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave dhe/ose njësitë e vetëqeverisjes vendore, krijon fondin e banesave të nevojshme për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore, që konsiston në banesat e blera me fonde nga fondi i rindërtimit në tregun e lirë, si dhe nga banesat e dhuruara nga subjektet e treta në favor të shtetit, me qëllim përballimin e fatkeqësive natyrore. Ky program është i ndarë në nënprograme ku konsiston në blerjen e 9 (nëntë) apartamenteve, për familjet e viktimave. Janë blerë 5 apartamente në bashkinë Kamëz dhe 4 në bashkinë Durrës përkatësisht në vlerën 18,263,702 lekë dhe 28,608,306 lekë ï VKM Nr. 543 dt. 09.07.2020 dhe VKM Nr.687 dt.02.09.2020.

➢ Me fondin e rindërtimit, krahas programeve të mësipërme, janë financuar edhe *Ngritja e portalit unik qeveritar të procesit të rindërtimit, në masën* **19,440,360** lekë me njësi zbatuese AKSHI (KSHR Nr.2, VKM nr. 103 dt. 05.02.2020) dhe ñVlerësim Dëmiò, në rastet e ekspertizave të thelluara, **në vlerën 360,000,000 lekë,** me njësi zbatuese MIE dhe Bashkia Tiranë (VKM nr.10, 10.01.2020).

*Tabela nr. 12* Ngritja e portalit

| *Njësia Zbatuese* | *Buxheti i shtetit* | *Donacione që kanë kaluar nga B.SH* | *Total (në lekë)* |
|---|---|---|---|
| AKSHI | 19,440,360 | | 19,440,360 |

| Vlerësim Dëmi | | | |
|---|---|---|---|
| MIE | 160,000,000 | | 160,000,000 |
| Bashkia Tiranë | 200,000,000 | | 200,000,000 |
| Totali | 360,000,000 | - | 360,000,000 |

*Burimi:* Sekretariati KSHR, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

*Tabela e përmbledhur e fondeve të alokuara sipas programeve, të ndara në njësi zbatuese, përfituese të buxhetit të shtetit ose te donacioneve të derdhura në buxhetin e shtetit, për vitin 2020:*

*Tabela nr. 13* Programi i zhvillimit të objekteve të reja

| *Njësia zbatuese* | *Buxheti i shtetit* | *Donacione që kanë kaluar nga B.SH* | *Total (në lekë)* |
|---|---|---|---|
| *FSHZH* | 8,544,129,482.76 | | 8,544,129,483 |
| *ABP* | | 55,000,000.00 | 55,000,000 |
| *AKTP* | 137,420,000.00 | | 137,420,000 |
| *Bashkia Durrës* | 409,081,016.00 | | 409,081,016 |
| *Bashkia Kamëz* | | 19,323,960.00 | 19,323,960 |
| *Bashkia Kavajë* | | 43,000,000.00 | 43,000,000 |
| *Bashkia Krujë* | 297,475,175.50 | 72,377,718.40 | 369,852,894 |
| *Bashkia Kurbin* | 321,697,219.60 | 296,969,254.28 | 618,666,474 |
| *Bashkia Lezhë* | 170,240,659.00 | 57,000,000.00 | 227,240,659 |
| *Bashkia Tiranë* | 3,986,774,979.46 | | 3,986,774,979 |
| *Enti i banesave* | 44,889,589.00 | | 44,889,589 |
| *IKTK* | 236,627,069.00 | | 236,627,069 |
| *Total* | *14,148,335,190.32* | *543,670,932.68* | *14,692,006,123.00* |
| *Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike* | | | |
| *FSHZH* | 1,363,461,542.00 | | 1,363,461,542 |
| *Bashkia Tiranë* | 500,000,000.00 | | 500,000,000 |
| *ARRSH* | 151,539,896.00 | | 151,539,896 |
| *Total* | *2,015,001,438.00* | | *2,015,001,438.00* |
| *Programi i granteve të rindërtimit* | | | |
| *Bashkia Durrës* | 4,512,190,743.00 | 128,595,274.00 | 4,640,786,017.00 |
| *Bashkia Kamëz* | | 340,220,000.00 | 340,220,000.00 |
| *Bashkia Kavajë* | 18,250,000.00 | 385,500,000.00 | 403,750,000.00 |
| *Bashkia Krujë* | 758,850,000.00 | | 758,850,000.00 |
| *Bashkia Kurbin* | 927,544,728.38 | | 927,544,728.38 |
| *Bashkia Lezhë* | 416,689,540.00 | 398,741,633.00 | 815,431,173.00 |
| *Bashkia Mirditë* | | 29,820,000.00 | 29,820,000.00 |
| *Bashkia Rrogozhinë* | | 110,900,000.00 | 110,900,000.00 |
| *Bashkia Shijak* | 1,155,505,843.00 | 108,540,027.00 | 1,264,045,870.00 |
| *Bashkia Tiranë* | 1,232,875,000.00 | | 1,232,875,000.00 |
| *Bashkia Vorë* | | 220,450,000.00 | 220,450,000.00 |
| *Ministria e Mjedisit (akomodimi i përkohshëm)* | 200,000,000.00 | | 200,000,000.00 |
| *Total* | *9,221,905,854.38* | *1,722,766,934.00* | *10,944,672,788.38* |
| *Programi i krijimit të fondit të ndërtesave* | | | |
| *Bashkia Kamëz* | 18,263,702.00 | - | 18,263,702.00 |
| *Bashkia Durres* | 28,608,306.00 | - | 28,608,306.00 |
| *Total* | *46,872,008.00* | | *46,872,008.00* |
| *Ngritja e portalit* | | | |
| *AKSHI* | 19,440,360.00 | | 19,440,360.00 |
| *Vlerësim Dëmi* | | | |

| | | | |
*Për sa më sipër, sipas llogaritjeve të bëra nga strukturat përgjegjëse të këtij institucioni, kërkojmë mbështetjen tuaj financiare në shumën 2.2 milionë euro*ò.

Për objektin QSHAMT, është kryer aktekspertizë e thelluar të kryer nga Instituti i Ndërtimit, ku janë shprehur se: ñ*Vlera e përforcimit të objektit 2-katësh të administratës është 76% e vlerës së ndërtimit të objektit nga e para. Referuar nenit 34 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, rekomandojmë që ky objekt të prishet dhe të ndërtohet një ndërtesë e re...*ò.

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk kishte një projekt preventiv punimesh, për të justifikuar vlerën e kërkuar të financimit nga ana e MB.

**5. Dosjet e praktikave shoqëruese të Vendimeve nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara në kundërshtim me Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për arkivat*" dhe "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".**

| | |
|---|---|
| **4. Titulli i gjetjes:** | Mbi veprimtarinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit |
| **Situata:** | Dosjet e praktikave shoqëruese të Vendimeve nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara. |
| **Kriteri:** | VKM nr. 878, datë 24.12.2019 ñ*Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit*ò;<br>Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 ñ*Për arkivat*ò dhe ñ*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*ò. |
| **Ndikimi/Efekti** | Mungesa e arkivimit dhe inventarizimit të dokumentacionit e praktikave mbi të cilat bazohet vendim-marrja e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit përbën risk të lartë për humbjen ose tjetërsimin e tij. |
| **Rëndësia** | E lartë |
| **4.1 Rekomandime** | AKMC, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, të marrë masa të kryejë arkivimin e dosjeve të vitit 2020 dhe inventarizimin e secilës praktikë, sipas kërkesave të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi. |

6. **Referuar VKM nr. 878, datë 24.12.2019 "*Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit*":**

Kreu IV ñ*Sekretariati Teknik i Komisionit Shtetëror të Rindërtimit*ò:
ñ*3. AKMC-ja, përveç detyrave të përcaktuara në aktin normativ nr.9, datë 6.12.2019, ka këto përgjegjësi:*
*b) merr masa për të njoftuar dhe organizuar mbledhjet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit*ò.
Kreu II ñ*Përbërja dhe funksionimi*ò:
ñ*11. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u vihen në dispozicion anëtarëve të Komisionit, jo më vonë se 2 ditë nga data e mbledhjes*ò.

Ne dosjet e praktikave të audituara, nuk kishte dokumentacion vërtetues për kryerjen e njoftimit dhe dërgimit të materialeve, sipas parashikimit në VKM. Në dosje gjendej një shkresë ñNjoftimò, pa numër protokolli, që nuk plotëson kriteret e dokumenteve dalëse, të përcaktuara në ñNormat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò.
Nëpërmjet e-mail zyrtar të Sekretariatit Teknik, anëtarëve u janë dërguar materialet, mbi bazën e të cilëve do të merreshin Vendimet dhe u kërkohej të shprehnin dakordësinë, por ky e-mail u është dërguar në shumicën e rasteve ditën në të cilën zhvillohej mbledhja dhe merrej vendimi.
Çdo rast është trajtuar specifikisht në Aneksin nr. 1.

ñ*6. Votimi bëhet i hapur në prezencë të sekretarit të Komisionit, i cili mban procesverbal dhe regjistron votat e anëtarëve të Komisionit.*
*8. Vendimet dhe procesverbalet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Vendimet duhet të jenë të argumentuara dhe, në çdo rast, vota "kundër" duhet të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes".*
Në dosjet e praktikave të audituara, procesverbalet e mbajtur nuk pasqyronin vota kundër. Në disa raste është konstatuar që, në vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve të KSHR, nuk kishin nënshkruar të gjithë anëtarët, trajtuar rast pas rasti në Aneksin nr. 1, por në asnjë rast

nuk kanë qenë më pak se 2/3 e anëtarëve, që do të cënonte vlefshmërinë e vendimit, sipas përcaktimeve në VKM.

| **5. Titulli i gjetjes:** | Mbi veprimtarinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit |
|---|---|
| **Situata:** | ***Në dosjet e praktikave të audituara, nuk kishte dokumentacion vërtetues për kryerjen e njoftimit dhe dërgimit të materialeve, sipas parashikimit në VKM. Në dosje gjendej një shkresë "Njoftim", pa numër protokolli, që nuk plotëson kriteret e dokumenteve dalëse, të përcaktuara në "Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë".***<br>Nëpërmjet e-mail zyrtar të Sekretariatit Teknik, anëtarëve u janë dërguar materialet, mbi bazën e të cilëve do të merreshin Vendimet dhe u kërkohej të shprehnin dakordësinë, por ky e-mail u është dërguar në shumicën e rasteve ditën në të cilën zhvillohej mbledhja dhe merrej vendimi.<br>Në dosjet e praktikave të audituara, procesverbalet e mbajtur nuk pasqyronin vota kundër. Në disa raste është konstatuar që, në vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve të KSHR, nuk kishin nënshkruar të gjithë anëtarët, trajtuar rast pas rasti në Aneksin nr. 1, por në asnjë rast nuk kanë qenë më pak se 2/3 e anëtarëve, që do të cënonte vlefshmërinë e vendimit, sipas përcaktimeve në VKM.<br>Çdo rast është trajtuar specifikisht në Aneksin nr. 1. |
| **Kriteri:** | VKM nr. 878, datë 24.12.2019 ñ*Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit*ò |
| **Ndikimi/Efekti** | Njoftimi dhe vënia në dispozicion e materialeve që do të trajtohen, 2 ditë para zhvillimit të mbledhjes, sikurse përcaktohet në VKM, garanton dhënien e mundësisë anëtarëve për të marrë informacionin e nevojshëm mbi vendimmarrjen që do të zhvillojnë.<br>Gjithashtu, votat kundër, sikurse përcaktohet në VKM, duhet në çdo rast të pasqyrohen në procesverbal. |
| **Rëndësia** | E lartë |
| **5.1 Rekomandimi** | AKMC, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, të marrë masa që të dokumentojë zbatimin e detyrimeve dhe përgjegjësive, në lidhje me njoftimin dhe tôu vërë në dispozicion materialet anëtarëve 2 ditë para zhvillimit të mbledhjes, të pasqyrojë votën kundër, si dhe të sigurojë nënshkrimin e vendimeve dhe procesverbaleve të mbledhjeve. |

**7. Referuar VKM nr.26, datë 15.1.2020 "*Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara*":**

ñ*1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore do të kryejnë akt-ekspertizë të thelluar për të gjitha objektet për të cilat kërkohet një rivlerësim më i thelluar, mbështetur në akt-konstatimet ose akt-vlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo të grupeve përkatëse të inspektimit.*

*2. Akt-ekspertiza e thelluar i vihet në dispozicion Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës. Instituti i Ndërtimit jep opinionin e tij, i cili mbizotëron mbi akt-ekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse*ò.

Referuar nenit 15 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñ*Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore*ò:
ñ*1. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) mbledh, menaxhon, përpunon dhe analizon të gjitha aktet e vlerësimit paraprak, akt-ekspertizat e thelluara dhe çdo të dhënë tjetër mbi pasojat e fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësive të tjera, që i përcillen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet e tjera shtetërore.*
*2. AKMC-ja edhe kryesisht mund verifikojë aktet e vlerësimit paraprak, akt-ekspertizat e thelluara, si dhe të dhënat e tjera të përcjella nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet e tjera shtetërore, si dhe mund të kërkojë informacione shtesë mbi këto të dhëna nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo autoritetet e tjera shtetërore ose drejtpërdrejt nga subjektet e interesuara*ò.
Në dosjet e praktikave të audituara është konstatuar se, në shumicën e rasteve, njësitë e qeverisjes vendore dhe autoritetet përgjegjëse kanë paraqitur pranë KSHR akt-ekspertiza të thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit, në tejkalim të kompetencave të caktuara në VKM e sipërcituar, e cila i jep Institutit të Ndërtimit tagrin për të kryer akt-inspektime dhe akt-vlerësime paraprake, si dhe oponencën teknike mbi akt-ekspertizat e thelluara.

| **6. Titulli i gjetjes:** | Mbi veprimtarinë e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit |
|---|---|
| **Situata:** | ***Në dosjet e praktikave të audituara është konstatuar se, në shumicën e rasteve, njësitë e qeverisjes vendore dhe autoritetet përgjegjëse kanë paraqitur pranë KSHR akt-ekspertiza të thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit, në tejkalim të kompetencave të caktuara në VKM e sipërcituar, e cila i jep Institutit të Ndërtimit tagrin për të kryer akt-inspektime dhe akt-vlerësime paraprake, si dhe oponencën teknike mbi akt-ekspertizat e thelluara.***<br><br>Referuar VKM nr.26, datë 15.1.2020 ñ*Për kryerjen e ak-tekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara*ò:<br>ñ*1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore do të kryejnë akt-ekspertizë të thelluar për të gjitha objektet për të cilat kërkohet një rivlerësim më i thelluar, mbështetur në akt-konstatimet ose akt-vlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo të grupeve përkatëse të inspektimit.*<br>*2. Akt-ekspertiza e thelluar i vihet në dispozicion Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës. Instituti i Ndërtimit jep opinionin e tij, i cili mbizotëron mbi akt-ekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse*ò.<br><br>Referuar nenit 15 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñ*Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore*ò:<br>ñ*1. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) mbledh, menaxhon, përpunon dhe analizon të gjitha aktet e vlerësimit paraprak, akt-ekspertizat e thelluara dhe çdo të dhënë tjetër mbi pasojat e fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësive të tjera, që i përcillen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet e tjera shtetërore.*<br>*2. AKMC-ja edhe kryesisht mund verifikojë aktet e vlerësimit paraprak, akt-ekspertizat e thelluara, si dhe të dhënat e tjera të përcjella nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet e tjera shtetërore, si dhe mund të kërkojë informacione shtesë mbi këto të dhëna nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo autoritetet e tjera shtetërore ose drejtpërdrejt* |

| | |
|---|---|
| | *nga subjektet e interesuara*ò.<br>Në praktikat e vëna në dispozicion, nuk ka asnjë gjurmë të përfshirjes së AKMC në këtë proces, sipas përgjegjësive që i burojnë nga Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019.<br><br>VKM nr.878, datë 24.12.2019 *"Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit"* vendos, si më poshtë:<br>*"Kreu I "Dispozita të Përgjithshme"*<br>*1. Ngritjen dhe organizimin e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, si një organ ndërministror për bashkërendimin e punës së ministrive, institucioneve të tjera përgjegjëse si dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, të ngarkuara nga akti normativ nr.9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", për të gjitha veprimtaritë që lidhen me dhe që ndikojnë në përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.*<br>*2. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit koordinon dhe bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse, të ngarkuara nga akti normativ nr.9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", për planifikimin e përdorimit të fondit të rindërtimit në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit, me qëllim përgatitjen e propozimeve që i përcillen për miratim Këshillit të Ministrave."*<br>Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, në cilësinë e organit ndërministror përgjegjës për bashkërendimin e punës së institucioneve, si dhe koordinimin dhe bashkëpunimin me autoritetet përgjegjëse të ngarkuara nga akti normativ nr. 9, datë 16.12.2019 duhet ta kishte evidentuar këtë parregullsi procedurale, duke koordinuar punën me AKMC, si institucion përgjegjës për mbledhjen, menaxhimin, analizimin, si dhe, kryesisht, edhe verifikimin e akteve të vlerësimit paraprak, akt-ekspertizave të thelluara, si dhe të dhënat e tjera të përcjella nga autoritetet përgjegjëse. |
| **Kriteri:** | VKM nr. 878, datë 24.12.2019 ñ*Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit*ò;<br>VKM nr.26, datë 15.1.2020 ñ*Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara*ò;<br>Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñ*Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore*ò |
| **Ndikimi/Efekti** | Mungesa e bashkërendimit të punës ka sjellë që në shumicën e rasteve, autoritetet përgjegjëse të kryejnë aktekspertizën e thelluar pranë Institutit të Ndërtimit, ndërkohë që VKM parashikon që Instituti i Ndërtimit do të kryejë oponencën teknike mbi aktekspertizat që do tŭi paraqiten. |
| **Rëndësia** | E lartë |
| **6.1Rekomandime** | Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, të kërkojë nga Sekretariati Teknik që të gjitha praktikat që shoqërojnë vendim-marrjen të jenë të strukturuara dhe të miratuara sipas përgjegjësive institucionale, me qëllim që të sigurohet funksionim normal në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. |

**1. Nga auditimi rezultoi se disa projekte janë pranuar, miratuar me Vendim të KSHR dhe dërguar për miratim, jo në respektim të procedurave të përcaktuara në VKM për përfitimin nga grantet e rindërtimit, si më poshtë:**

**1**. Me Vendimin nr. 29, datë 15.06.2020, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit vendosi të propozojë Këshillit të Ministrave miratimin e fondit prej ***151,539,896 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e pesëqind e tridhjetë e nëntëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë)* lekë pa TVSH**, për rindërtimin e Urës së Tapizës, bazuar në preventivin e dërguar nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por pa një Akt-ekspertizë të thelluar, sipas përcaktimit në VKM nr. 25, datë 15.01.2020 ñ*Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara*ò, si më poshtë:

ñ*1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore do të kryejnë akt-ekspertizë të thelluar për të gjitha objektet për të cilat kërkohet një rivlerësim më i thelluar, mbështetur në akt-konstatimet ose akt-vlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo të grupeve përkatëse të inspektimit.*

*2. Akt-ekspertiza e thelluar i vihet në dispozicion Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës. Instituti i Ndërtimit jep opinionin e tij, i cili mbizotëron mbi akt-ekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse.*ò

Në shkresën që Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë i dërgon Ministrit të Shtetit për Rindërtim, citohet se: ñ*Ky objekt pësoi dëmtime në tërmetin e datës 26.11.2019, për shkak edhe të amortizimit të tij të mëparshëm*ò.

**2**. Me Vendimin nr. 67, datë 01.12.2020, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit vendosi të propozojë Këshillit të Ministrave miratimin e fondit prej ***275,000,000 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë milion)* lekë**, për rindërtimin e Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit (QSHAMT).

Me shkresën nr. 58/2 prot., datë 31.03.2020, Drejtori i Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit i dërgon Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme kërkesën për financim për ndërtimin e strukturës së re të QSHAMT, sikurse citohet: ñ*...nëpërmjet një relacioni tekniko-administrativ të hartuar nga një grup pune", propozon dy opsione:*

3. *Opsioni optimal – 2,100,000 euro;*
4. *Opsioni minimalist – 1,300,000 euro (bashkëlidhur analiza e kostove për të dy opsionet).*

*Në përllogaritjet e mësipërme nuk janë përfshirë:*

- *TVSH;*
- *Fondi rezervë (normalisht mbahet nën 5%);*
- *Taksat e urbanizimit dhe të lejes;*

*Tarifa e projektimit/ transferimit të pasurisë së luajtshme të QSHAMT*ò.

Me shkresën nr. 2680/1 prot., datë 04.05.2020, Sekretari i Përgjithshëm i MB i dërgon Ministrit të Shtetit për Rindërtim kërkesën për financim fondi për ndërtimin e strukturës së re të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, ku shprehej se:

ñ*Kjo ndërtesë, vlerësuar në procesverbalin e mbajtur nga komisionet respektive marrëse dhe dorëzuese të pronës, ngritur me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 575, datë 12.11.2019, jo e përshtatshme për funksionin aktual të kësaj strukture, si dhe tepër e amortizuar, pasi është ndërtesë e përdorur prej vitesh, si dhe dëmet e shkaktuara nga tërmeti e kanë shkatërruar plotësisht objektin.*

*...*

*Për sa më sipër, sipas llogaritjeve të bëra nga strukturat përgjegjëse të këtij institucioni, kërkojmë mbështetjen tuaj financiare në shumën 2.2 milionë euro*ò.

Për objektin QSHAMT, është kryer akt-ekspertizë e thelluar të kryer nga Instituti i Ndërtimit, ku janë shprehur se: ñ*Vlera e përforcimit të objektit 2-katësh të administratës është 76% e*

*vlerës së ndërtimit të objektit nga e para. Referuar nenit 34 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, rekomandojmë që ky objekt të prishet dhe të ndërtohet një ndërtesë e re...*ò.
Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk kishte një projekt preventiv punimesh, për të justifikuar vlerën e kërkuar të financimit nga ana e MB.

| **7. Titulli i gjetjes:** | Mbi veprimtarinë e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi rezultoi se disa projekte janë pranuar, miratuar me Vendim të KSHR dhe dërguar për miratim, jo në respektim të procedurave të përcaktuara në VKM për përfitimin nga grantet e rindërtimit, si më poshtë:<br>**1**. Me Vendimin nr. 29, datë 15.06.2020, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit vendosi tõi propozojë Këshillit të Ministrave miratimin e fondit prej ***151,539,896* lekë pa TVSH**, për rindërtimin e Urës së Tapizës, bazuar në preventivin e dërguar nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por pa një Akt-ekspertizë të thelluar, sipas përcaktimit në VKM nr. 25, datë 15.01.2020.<br>Në shkresën që Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë i dërgon Ministrit të Shtetit për Rindërtim, citohet se: ñ*Ky objekt pësoi dëmtime në tërmetin e datës 26.11.2019, për shkak edhe të amortizimit të tij të mëparshëm*ò.<br><br>**2**. Me Vendimin nr. 67, datë 01.12.2020, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit vendosi tõi propozojë Këshillit të Ministrave miratimin e fondit prej ***275,000,000* lekë**, për rindërtimin e Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit (QSHAMT).<br>Me shkresën nr. 58/2 prot., datë 31.03.2020, Drejtori i Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit i dërgon Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme kërkesën për financim për ndërtimin e strukturës së re të QSHAMT, bazuar në një relacion tekniko-administrativ, të hartuar nga një grup pune, i cili nuk gjendet bashkëlidhur shkresës, duke paraqitur dy opsione, si më poshtë:<br>5. *Opsioni optimal – 2,100,000 euro;*<br>6. *Opsioni minimalist – 1,300,000 euro (bashkëlidhur analiza e kostove për të dy opsionet).*<br>Me shkresën nr. 2680/1 prot., datë 04.05.2020, Sekretari i Përgjithshëm i MB i dërgon Ministrit të Shtetit për Rindërtim kërkesën për financim fondi për ndërtimin e strukturës së re të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, ku shprehej se ndërtesa ishte tepër e amortizuar, pasi është përdorur prej vitesh, si dhe dëmet e shkaktuara nga tërmeti e kanë shkatërruar plotësisht, duke kërkuar mbështetjen financiare në shumën 2.2 milionë euro.<br>Për objektin QSHAMT, është kryer akt-ekspertizë e thelluar të kryer nga Instituti i Ndërtimit, ku janë shprehur se: ñ*Vlera e përforcimit të objektit 2-katësh të administratës është 76% e vlerës së ndërtimit të objektit nga e para. Referuar nenit 34 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, rekomandojmë që ky objekt të prishet dhe të ndërtohet një ndërtesë e re...*ò.<br>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk kishte një projekt preventiv punimesh, për të justifikuar vlerën e kërkuar të financimit nga ana e MB. |
| **Kriteri:** | VKM nr. 25, datë 15.01.2020 ñ*Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar* |

| | |
|---|---|
| | *në ndërtesat e dëmtuara*ò |
| **Ndikimi/Efekti** | Autoritetet përgjegjëse të sipërcituara kanë kërkuar fond nga rindërtimi për objekte publike që nuk lidhen drejtpërdrejt me procesin e rindërtimit pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019, pasi *kanë qenë të amortizuara*, sikurse citohet në shkresat respektive, me të cilat ata u janë drejtuar Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.<br>Komisioni Shtetëror i Rindërtimit ka miratuar alokimin e fondit për dy projektet, edhe pse:<br>• Projekti ñUra e Tapizësò nuk disponon akt-ekspertizën e thelluar;<br>• Projekti i ñQSHAMTò nuk ka bashkëlidhur një preventiv punimesh, ku të bazohet vlera e kërkuar dhe e miratuar nga ana e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit. |
| **Rëndësia** | E lartë |
| **7.1 Rekomandime** | Komisioni Shtetëror i Rindërtimit të shqyrtojë, të analizojë dhe të marrë vendime në lidhje me miratimin e fondeve vetëm për projekte që janë pasojë e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, me qëllim sigurimin e rimëkëmbjes ekonomike sa më të shpejtë dhe efektive, në respektim dhe të kritereve ligjore, nënligjore dhe rregullative përkatëse. |

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga Auditimi:** Nuk demonstrohet dokumentacion në lidhje me veprimtarinë e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin mbi ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarisë ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara.
Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, kreu II, pika 1, germa ñaò.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 16-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**1.1 Rekomandimi:** Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të plotësuar me dokumentacion aktivitetet mbi ndjekjen dhe bashkërendimin e veprimtarisë ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara.

***Brenda vitit 2021***

**2. Gjetje nga Auditimi:** Stafi i Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, aktivitetin për evidentimin e burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore, dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit, e ka reduktuar thjeshtë dhe vetëm në informacione mbi ecurinë e procesit dhe atë kryesisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat nuk kanë rezultuar në evidenca të burimeve që disponojnë institucionet dhe për pasojë as në përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre.
Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, kreu II, pika 1, germa ñcò.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 21-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**2.1 Rekomandimi:** Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të plotësuar evidentimin e burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore, dhe përcaktimin e mënyrës së përdorimit të tyre për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit.

***Brenda vitit 2021***

**3. Gjetje nga Auditimi:** Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për ministritë dhe institucionet e tjera, si dhe pjesërisht për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose që kanë mbetur të pastrehë, si pasojë e tërmetit.
Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, kreu II, pika 1, germa ñdò.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**3.1 Rekomandimi:** Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm, për ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për ministritë dhe institucionet e tjera, për trajtimin e shtetasve që kanë humbur familjarët dhe/ose që kanë mbetur të pastrehë, si pasojë e tërmetit.

***Brenda vitit 2021***

**4. Gjetje nga Auditimi:** Ministri i Shtetit nuk rezulton të ketë bërë ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për strukturat e posaçme, të ngritura me ligj apo vendim, për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti.
Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, kreu II, pika 1, germa ñeò.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 24-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**4.1 Rekomandimi:** Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të vepruar dhe dokumentuar aktivitetet për ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për strukturat e posaçme, të ngritura me ligj apo vendim, për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti.

***Brenda vitit 2021***

**5. Gjetje nga Auditimi:** Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar përgatitjen dhe propozimin e projekteve të përgjithshme e të veçanta, që të ishin pjesë e programeve të procesit të rindërtimit, si dhe nuk ka të dokumentuar kërkesa për mbështetje të specializuar njerëzore.
Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, kreu II, pika 2, germa ñbò.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 27-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**5.1 Rekomandimi:** Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të vepruar në kohë në lidhje me përgatitjen dhe propozimin e projekteve, të përgjithshme e të veçanta, që të jenë pjesë e programeve të procesit të rindërtimit, si dhe kërkesë për mbështetje të specializuar njerëzore.

***Brenda vitit 2021***

**6. Gjetje nga Auditimi:** Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar informacione për mënyrën e përdorimit dhe eficiencën e arritur për çdo donacion apo mbështetje të ofruar nga organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit.
Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, kreu II, pika 2, germa ñçò.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**6.1 Rekomandimi:** Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të aktivizojë kabinetin e tij për të informuar për mënyrën e përdorimit dhe eficiencën e arritur për çdo donacion apo mbështetje të ofruar nga organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit.

***Brenda vitit 2021***

**7. Gjetje nga Auditimi:** Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar ushtrimin e kompetencave në lidhje me raportimin dhe ngarkimin me detyra të strukturave të mbrojtjes civile; krijimin e grupeve të punës dhe organizmin e veprimtarive për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit; bashkërendimin e punës me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit; si dhe drejtimin dhe koordinimin, në nivel qendror, të strukturave operacionale për përballimin e pasojave dhe zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit.

Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 11, datë 10.1.2020 ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtiminò, kreu III, pikat 2, 3, 4 dhe 5.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 31-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**<u>7.1 Rekomandimi:</u>** Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të ushtrojë dhe të dokumentojë kompetencat në lidhje me raportimin dhe ngarkimin me detyra të strukturave të mbrojtjes civile; krijimin e grupeve të punës dhe organizmin e veprimtarive për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit; bashkërendimin e punës me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit; si dhe drejtimin dhe koordinimin, në nivel qendror, të strukturave operacionale për përballimin e pasojave dhe zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit.

***Në vijimësi***

**8. Gjetje nga Auditimi:** Ministrit i Shtetit për Rindërtimin në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Ministrave: - nuk ka të dokumentuar aktivitetin për koordinimin, drejtimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19 dhe për pasojë mungon një plan i tillë;

- nuk ka të dokumentuar evidentimin e burimeve të brendshme, njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore;
- nuk ka të dokumentuar veprimtarinë për koordinimin dhe drejtimin e strukturave e të njësive, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave, për zbatimin e planit të përballimit të situatës ekonomike, të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;
- nuk ka të dokumentuar detajimin e nevojave për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;
- nuk ka të dokumentuar veprimtarinë për koordinimin dhe drejtimin e punës si dhe rekomandimin e institucioneve për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim në Këshillin e Ministrave të projekt-akteve, ligjore e nënligjore, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;
- nuk ka të dokumentuar rastet e thirrjes për raportim të strukturave të cilat kanë lidhje me situatën ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19;
- nuk ka të dokumentuar krijimin dhe drejtimin e grupeve të punës dhe organizimin e veprimtarive për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19;
- nuk ka të dokumentuar veprimtarinë për bashkërendimin me ministritë dhe institucionet shtetërore për sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive në funksion të realizimit të planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19.

Sa më sipër nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 228, datë 18.3.2020 ñPër një shtesë në vendimin nr.11, datë 10.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtiminò, pika 1, kreu II/1, germat ñaò, ñbò, ñcò, ñçò, ñdhò, ñeò, ñgò, ñgjò dhe ñhò,

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 32-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**<u>8.1 Rekomandimi:</u>** Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të marrë masat e nevojshme për koordinimin, drejtimin dhe ndjekjen e veprimtarisë për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar nga infeksioni COVID-19, duke i paraprirë me krijimin dhe drejtimin e grupeve të punës dhe organizimin e veprimtarive për hartimin e planit të përballimit të situatës ekonomike të shkaktuar, me evidentimin e burimeve të brendshme, njerëzore, që disponojnë institucionet, publike e shtetërore; detajimin e nevojave për përballimin e situatës ekonomike dhe më pas thirrjen për raportim të strukturave të cilat kanë

lidhje me situatën ekonomike, si dhe sigurimin e të dhënave të nevojshme dhe përcjelljen e porosive në funksion të realizimit të planit të përballimit të situatës ekonomike.

***Brenda vitit 2021***

**9. Gjetje nga Auditimi:** Mungesa e vënies në dispozicion të marrëveshjeve për furnizimin e vaksinave në periudhën e audituar 01.01.2020 deri më 30.04.2021, nuk i ka mundësuar grupit të auditimit të KLSH, shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre, dhe në këtë kuadër të aktivitetit të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin në cilësinë e ministrit përgjegjës të fushës, si dhe njërit nga tre institucionet bashkëfirmosëse të tyre.
Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 96/2021ñPër pronësinë industrialeò, të ndryshuar, nenit 111/a, pika 1; ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 ñPër informacionin e klasifikuar ñSekret shtetëroròò, neni 2; ligjin nr.154/2014 ñPër organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 26, pika 1 dhe 2; si dhe nuk është vepruar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr. 228, datë 18.3.2020 ñPër një shtesë në vendimin nr.11, datë 10.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rindërtiminò, pika 1, kreu II/1, germa ñaò.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 35-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**<u>9.1 Rekomandimi:</u>** Ministri i Shtetit për Rindërtimin, të marrë masat e nevojshme që në kuadër të koordinimit dhe drejtimit të punës, si dhe rekomandimit të institucioneve për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim në Këshillin e Ministrave të projekt-akteve, ligjore e nënligjore, për përballimin e situatës ekonomike të shkaktuar nga COVID-19, si dhe të transparencës së përdorimit të fondeve publike dhe më gjerë, të kërkojë dhe të sigurojë bërjen publike të të gjitha marrëveshjeve të vaksinave.

***Brenda muajit tetor 2021***

**10. Gjetje nga auditimit:** Nga auditimi, nuk rezulton i dokumentuar hartimi dhe miratimi i Programit të përgjithshëm të rindërtimit nga KSHR, dhe më pas përcjellja e tij për miratim në KM, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 të Kreut III të VKM nr. 878 datë 24.12.2019 dhe germën ñaò të pikës 4, të nenit 14 të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019.
Nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk rezulton të jetë e dokumentuar përfshirja në Programin e Përgjithshëm të Rindërtimit e programeve sociale të pas tërmetit të çdo ministrie linjë, planeve të masave për rikuperimin, mbrojtjen dhe parandalimin e dëmeve eventuale në fushën e mjedisit, turizmit dhe kulturës dhe planeve të rikuperimit dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor, të miratuara (secili prej planeve) me udhëzime të ministrave respektive, në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 29 dhe pikës 1 dhe 2 të nenit 31 të Aktit Normativ nr. 9.
Nga analizimi i dokumentacionit, si dhe komunikimi me Sekretariatin e KSHR nuk sigurohet qartësi se çfarë përfaqësojnë humbjet e përllogaritura të tërmetit të nëntorit 2019, mbi të cilin janë përllogaritur nevojat (fonde) për strategjinë e rikuperimit të paraqitur në PDNA.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 46-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**<u>10.1 Rekomandimi:</u>** KSHR të marrë masat e nevojshme për hartimin, miratimin dhe përcjelljen për miratim në KM të Programit të përgjithshëm të rindërtimit, si dhe dokumentimin e këtij procesi, me qëllim rritje e efektivitetit të përdorimit të fondeve të tërmetit të nëntorit 2019.

***Brenda vitit 2021***

**<u>10.2 Rekomandimi:</u>** KSHR të marr masat e nevojshme për përfshirjen në Programin e përgjithshëm të rindërtimit, të programeve sociale të çdo ministrie linje, planeve të masave për rikuperimin, mbrojtjen dhe parandalimin e dëmeve eventuale në fushën e mjedisit, turizmit dhe kulturës dhe planeve të rikuperimit dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor, me qëllim sigurimin e planifikimit efektiv të procesit të rindërtimit.

***Brenda vitit 2021***

**<u>10.3 Rekomandimi:</u>** KSHR të ndërmarrë masat e nevojshme që në Programin e përgjithshëm te rindërtimit, të jenë të mirëpërcaktuara përkufizimet dhe mënyrat e përllogaritjes së dëmet të shkaktuara dhe humbjet e shkaktuara nga tërmeti i nëntorit 2019, me qëllim ofrimin e sigurisë në përllogaritjen e nevojave për realizimin e planeve të rimëkëmbjes pas tërmetit.

***Brenda vitit 2021***

**11. Gjetje nga Auditimi:** Sekretariati i KSHR nuk përcolli informacion mbi kontributet në natyrë, por e drejtoi grupin e auditimit për marrjen e këtij informacioni në AKMC, si institucioni përgjegjës për marrjen në dorëzim të kontributeve në natyrë.
Sa më sipër, nuk sigurohet transparencë mbi kontributet në natyre, në kundërshtim me pikën 1, kreu III, të VKM nr. 878, datë 24.12.2019, si dhe është vepruar në kundërshtim edhe me ligjin nr.154/2014 ñPër organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 26, pika 1 dhe 2.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 63-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**<u>11.1 Rekomandimi:</u>** KSHR të kërkojë nga AKMC-së, informacion mbi kontributet në natyrë, dhe në rast të marrjes në dorëzim nga kjo e fundit të sendeve apo materialeve ndërtimore, punë apo shërbime në funksion të procesit të rindërtimit, ato të publikohen në faqen e rindërtimit, me qëllim sigurimin e transparencës mbi procesin e rindërtimit, si dhe të përfshijë në raportet e monitorimit që përgatit për KM-në edhe informacione mbi kontributet në natyrë, me qëllim raportimin e plotë të vijimësisë së procesit të rindërtimit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**12. Gjetje nga Auditimi:** Nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk rezulton të jenë të dokumentuara monitorimet periodike të zbatimit të programit dhe detyrave të caktuara të njësive zbatuese të kryera nga KSHR, dhe raportet e përgatitur nga ky i fundit (KSHR) për KM. Nga auditimi rezultoi se gjatë periudhës nën auditim janë kryer 5 raportime nga bashkitë e prekura nga tërmeti, të kryera gjatë 4-mjorit të parë të vitit 2020, dhe 1 raporti në vitin 2021, si dhe inspektime dhe inaugurime nga Ministri i shtetit për rindërtimin.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 71-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**<u>12.1 Rekomandimi:</u>** KSHR të dokumentojë monitorimin periodike të zbatimit të programit dhe detyrave të caktuara të njësive zbatuese, si dhe të hartojë raporte për KM, me qëllim ndjekjen e vazhduar të procesit të monitorimit dhe ndërmarrjen në kohë të masave për përmirësim.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**13. Gjetje nga Auditimi:** Dosjet e praktikave shoqëruese të Vendimeve nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara në kundërshtim me Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 ñ*Për arkivat*ò dhe ñ*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*ò.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 68-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**<u>13.1 Rekomandimi:</u>** AKMC, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, të marrë masa të kryejë arkivimin e dosjeve të vitit 2020 dhe inventarizimin e secilës praktikë, sipas kërkesave të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi.

***Brenda vitit 2021***

**14. Gjetje nga Auditimi:** Sekretariati Teknik i Komisionit Shtetëror të Rindërtimit gjatë veprimtarisë së tij, nuk ka dokumentacion vërtetues për kryerjen e njoftimit dhe dërgimit të materialeve, pa numër protokolli, materialet e dërguara nëpërmjet email-it janë bërë të njohura ditën e mbledhjes në shumicën e rasteve, procesverbalet e mbajtura nuk pasqyrojnë votën

kundër, vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve të KSHR nuk janë nënshkruar të gjithë anëtarët etj., duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 878, datë 24.12.2019 ñPër përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimitò.
